

UNIVERSITETI
“ALEKSANDER MOISIU”, Durrës

FAKULTETI I BIZNESIT

**Programi i Doktoraturës
“Administrim Publik”**

**PERFORMANCA E INSTITUCIONEVE PËRFITUESE SI
FAKTOR NË EFEKTIVITETIN E NDIHMËS SË HUAJ NË
SHQIPËRI**

FLORENSA HAXHI

Udhëheqësi Shkencor

Prof. Dr. KRISTAQ KUME

Copyright
i
Florensa Haxhi
2016

Udhëheqësi i Florensa Haxhi vërteton se ky është një version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**PERFORMANCA E INSTITUCIONEVE PËRFITUESE SI FAKTOR NË
EFEKTIVITETIN E NDIHMËS SË HUAJ NË SHQIPËRI**

Prof. Dr. Kristaq Kume

**PERFORMANCA E INSTITUCIONEVE PËRFITUESE SI FAKTOR NË
EFEKTIVITETIN E NDIHMËS SË HUAJ NË SHQIPËRI**

Përgatitur nga MBA, Florensa Haxhi

**Disertacion i paraqitur në
Fakulteti i Biznesit
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
në përputhje të plotë
me kërkesat
për gradën “Doktor”**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Shtator, 2016**

Dedikim

‘Këtë punim ia dedikoj vajzës time të dashur Nikol dhe djalit tim që do lindë së shpejti!’

MIRËNJOHJE

Gjatë punës për këtë studim më kanë ndihmuar shumë persona, pa kontributin dhe ndihmën e të cilëve nuk do kisha arritur ta përfundoja me sukses.

Mirënjohjet e mia të vecanta shkojnë për udhëheqësin tim Prof. Dr. Kristaq Kume, për udhëzimet, këshillat e papërtuara, dhe durimin e treguar. E falenderoj për dashamirësinë dhe profesionalitetin e treguar në çdo moment që e kisha nevojë.

Gjithashtu, falënderoj nënën time, Liriana, dhe bashkëshortin tim, Nensi, të cilët me mbështetjen e tyre morale më ndihmuan dhe më dhanë kurajo për të balancuar jetën familjare, punën, dhe ambicjet e mia akademike, si dhe kanë mirëkuptuar gjithnjë mungesat e mia.

Së fundmi, falënderoj kolegen dhe shoqen time, Alpina Qirjazi, e cila më ka dhënë një ndihmë të madhe në gjetjen e materialeve, dhënien e mendimeve profesionale dhe ka nxitur e përkrahur idetë e mia.

Florensa Haxhi

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat. Tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë në bazën e kësaj teze në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. _____, datë_____

Durrës, më _____

Firma _____

PËRMBLEDHJE

Ky punim fokusohet në efektivitetin e ndihmës së huaj dhe në rolin e saj në zhvillimin e vendit dhe më specifikisht të fushave ku ajo është përqëndruar, kryesisht gjatë periudhës 2005-2015. Dokumenti analizon në mënyrë të detajuar performancën e institucioneve përfituese dhe si ndikon kjo performancë në efektivitetin e ndihmës në përgjithësi. Gjithashtu, studimi, në përfundim të tij identifikon disa mënyra sipas të cilave mund të përmirësohet menaxhimi i ndihmës së huaj në Shqipëri, me qëllim rritjen e efektivitetit të saj në sektorët kyc dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.

Ndihma e huaj ka një impakt të ndjeshëm në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB). Totali i ndihmës së huaj nga 2000 deri në 2005 ka qenë relativisht i qëndrueshëm midis 300 milion euro dhe 350 milion euro në vit ose rreth 4% e PBB dhe 11% e totalit të shpenzimeve publike. Ndersa më pas ka pësuar një rënie në rreth 2% të PBB në vitin 2015. Në vitin 2000, grantet përbënin 68% të ndihmës së huaj por kjo përqindje ka pësuar rënie ndërkohë që përqindja e kredive është rritur duke i tejkaluar grantet për herë të parë në 2006. Në vitin 2015 grantet përbënin vetëm 23% të ndihmës së huaj, ndërsa kreditë 77%. Donatorët që japin kontributin më të madh duke mbuluar rreth 79% të vlerës së projekteve në vazhdim, janë Banka Botërore, Bashkimi Europian, Gjermania, Banka Islamike për Zhvillim, Italia, BERZH, dhe Banka Europiane e Investimeve.

Financimi i huaj në Shqipëri, sipas vlerës së financimit për projektet aktualisht në zbatim është përqëndruar kryesisht tek: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, e ndjekur nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ministria e Financave. Shpërndarja sektoriale e ndihmës së huaj ka pësuar ndryshime nga viti në vit, por nga vlerësimet dhe analizat që janë bërë, vihet re se ajo ka qenë në përputhje me prioritetet e shprehura në dokumentet strategjike të zhvillimit të vendit si dhe në programin e qeverisë. Kështu, sektorët të cilët aktualisht përfitojnë pjesën më të madhe të fondeve të angazhuara janë: transporti, energjia, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, infrastruktura rurale, financat publike dhe bujqësia. Vlen të përmendet se niveli i mbështetjes nga ana e donatorëve nuk ka qenë i njëjtë, dhe kjo ka bërë të vështirë planifikimin e investimeve. Për këtë arsye është i domosdoshëm përmirësimi i orientimit dhe menaxhimit të ndihmës së huaj.

Nga ana tjetër, qeveria aktuale po tenton të mbajë në një limit të menaxhueshëm nivelin e kredive, kjo për shkak të kufizimit të borxhit publik, si anagzhim i marrë dhe në kuadër të marrëveshjes me FMN. Si rezultat, niveli i financimit të huaj (kreditë e buta) për vitet në vijim është ulur ndjeshëm, megjithëse ndihma e huaj (sidomos grantet dhe kreditë e buta) ka një avantazh relativ krahasuar me kredinë tregtare, në veçanti për investimet afatgjata dhe për mbështetjen e institucioneve dhe zhvillimit njerëzor të cilat kombinojnë investimin dhe ndihmën teknike.

Nga analiza e të dhënave parësore të mbledhura nga pyetsorët e përgatitur në kuadër të këtij studimi, rezulton se efektiviteti i ndihmës së huaj ndikohet nga një sërë faktorësh si vonesa në ratifikimin e marrëveshjeve me donatorët, vonesa apo problematika të hasura gjatë fazës së prokurimit, mungesë e kapaciteteve njerëzore e materiale për zbatimin e suksesshëm të projektit, mosreflektim i financimit të huaj në buxhetin e shtetit, etj. Për tejkalimin e këtyre problematikave dhe vonesave, në përfundim të punimit jepen disa rekomandime që lidhen kryesisht me nevojën për hartimin e procedurave të përmirësuar për manaxhimin e ndihmës së huaj duke e rritur rolin udhëheqës të vendit, sigurimi e qëndrueshmërisë institucionale, mbështetje dhe bashkëpunim nga donatorët për të rritur efektivitetin e ndihmës së huaj, përdorimi i mënyrave alternative të financimit të huaj si mbështetja buxhetore, etj.

Fjalët kyçe: *Financim i huaj, donatorë, ndihmë për zhvillim, Shqipëria, performancë, efektivitet i ndihmës së huaj*

SUMMARY

This paper focuses on the effectiveness of foreign aid and its role in the development of the country, and more specifically in those sectors in which it is mainly focused, over the period 2005-2015. The document analyzes in a detailed way the performance of the beneficiary institutions and how this performance impacts aid effectiveness in general. In addition, this study concludes by presenting a list of methods which could be used to improve the management of external assistance in order to increase the aid effectiveness in key sectors and the economy in general.

Foreign aid has a significant impact on the Gross Domestic Product (GDP). Total foreign aid from 2000 to 2005 has been relatively stable at between 300 million euros and 350 million euros per year, or about 4% of GDP and 11% of total public expenditure. While subsequently it dropped to around 2% of GDP in 2015. In the year 2000, grants accounted for 68% of foreign aid, but this percentage has been declining while the percentage of loans has been increasing by exceeding grants for the first time in 2006. In 2015, grants accounted for only 23% of the total foreign aid, while loans for 77%. The donors who offer the largest contribution covering about 79% of the total value of ongoing projects, are the World Bank, European Union, Germany, the Islamic Development Bank, Italy, the EBRD and the European Investment Bank.

The foreign financing in Albania, according to the value of ongoing projects is focused mainly in the Ministry of Transport and Infrastructure, followed by the Ministry of Energy and Industry, the Albanian Development Fund and the Ministry of Finance. The sectorial distribution of foreign aid has changed from year to year, which has made it difficult for the government to plan its investments. But, according to the assessments conducted, the foreign assistance has been oriented towards the priorities expressed in the strategic development documents of the country and in the government program. The sectors that currently benefit most of the foreign ongoing funds are: transport, energy, water supply and sanitation, rural infrastructure, public finance and agriculture. The level of donors' assistance has not been the same through the years, and this has made it difficult to plan future investments. Therefore it is of crucial importance that the orientation and management of foreign aid is improved.

On the other hand, the current government is trying to maintain a manageable limit of the loans, due to the limitation of public debt, as a commitment under the agreement with IMF. As a result, in the near future, it is expected that the level of foreign assistance (soft loans) will be reduced, despite the fact that foreign aid (especially grants and soft loans) has a comparative advantage compared to trade credit, especially for long-term investments and for supporting institutions and human development that combine investment and technical assistance.

Following a thorough analysis of the information gathered by the questionnaires, prepared for the purpose of this study, it is concluded that the effectiveness of foreign aid is affected by a series of factors, such as delays during the ratification of government agreements with the donors, delays or problems encountered during the procurement phase, absence of human or material capacities necessary to successfully implement the project, foreign financing not reflected in the government budget, etc. In order to overcome these difficulties and delays, the paper concludes with some recommendations on the need for improved design of procedures for the management of foreign aid in order to boost the country's leadership, increasing institutional sustainability and capacities, donor support and cooperation in order to increase aid effectiveness, the use of alternative ways of foreign financing such as budget support, etc.

Key words: *foreign assistance, donors, development aid, Albania, performance, aid effectiveness*

PËRMBAJTJA

1. Kapitulli 1 - Hyrja.....	1
1.1 Qëllimi i Kërkimit.....	1
1.2 Korniza Teorike.....	1
1.3 Metodologjia.....	11
1.3.1. Objektivat e Kerkimit.....	11
1.3.1. Hipotezat e Kerkimit.....	11
1.3.3. Instrumentat matës të kërkimit.....	12
2. Kapitulli 2 - Tendencat e Ndhmës së Huaj.....	14
2.1 Situata aktuale dhe tendencat e ndihmës së huaj (krahasime ne rajon).....	14
2.2 Sistemi i planifikimit të integruar, strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim.....	15
2.3 Instrumentat ndërkombëtarë për matjen e efektivitetit të ndihmës së huaj.....	17
2.4 Përbërja e ndihmës së huaj.....	20
2.5 Impakti i financimeve të huaja ne zhvillimin ekonomik të vendit.....	27
3. Kapitulli 3 - Impakti i Ndhmës së huaj në sektorët kyc.....	30
3.1 Biznesi / Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme	30
3.2 Transporti....	35
3.3 Bujqësia.....	38
4. Kapitulli 4 - Analiza e rezultateve - Efektiviteti i Ndhmës së Huaj	43
4.1 Rezultatet nga analiza e të dhënave parësore	43
4.2 Vërtetimi i Hipotezave të Ngritura	51
4.3. Performanca e insitucioneve përfituese - Analiza e të dhënave dytësore.....	64
-MTI.....	67
-MEI.....	72

-MMSR.....	76
-MM.....	79
-MBZHRAU.....	83
-MZHETTS.....	86
-MPB.....	88
-MK.....	90
-MZHU.....	92
-FSHZH.....	94
-MAS.....	97
-MSH.....	100
-INSTAT.....	102
-MF.....	104
-MD.....	108
-MIAP.....	110
-MCV.....	112
4.4 Analiza SWOT	114
5. Kapitulli 5 - Konkluzione dhe Rekomandime.....	116
Bibliografia -Referencat	125
Aneks - Pyetsor i përdorur për mbledhjen e të dhënave	131

Shkurtimet

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BEI	Banka E uropiane e Investimeve
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CARDS	Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës
CFCU	Njësia Qëndrore Financiare e Kontraktimit
DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim
DFID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
EURALIUS	Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GEF	Shërbim i Mjedisit Global
GMIP	Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave
GRECO	Këshilli i Europës Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
GTZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunimin Teknik
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFN	Institutet Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPA	Instrumenti i Para-aderimit
KE	Komisioni European
LCDP	Programi i Zhvillimit të Komuniteteve Lokale
MFP	Manaxhimi i Financimeve Publike
MIPD	Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumë Vjeçar
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
NATO	Organizata e Marrëveshjes së Atlantikut Verior
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
ODA	Ndihma Zyrtare e Zhvillimit – Official Development Aid
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PAMECA	Misioni i Asistencës së Policisë i Komunitetit European për Shqipërinë
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PBP	Përjasje me Bazë Programi
PBS	Përjasje me Bazë Sektori
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare

PEIR	Rishikimi i Shpenzimeve Publike dhe Institucionale
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PPR	Programi i Rishikimit të Politikës
PVH	Plani i Veprimit për Harmonizimin
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SPPS	Mbështetje për Sistemet e Prokurimit Publik
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
SWGs	Grupet Sektoriale të Punës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV/SIDA
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komisioni i Nivelit të Lartë për Refugjatët për Kombet e Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët nga Kombet e Bashkuara
UNIDO	Organizata e kombeve të Bashkuara për Industrinë dhe Zhvillimin
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Ministritë, departamente, institucione dhe agjenci të tjera qeveritare

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DZHFNH	Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj
INSTAT	Instituti i Statistikës
ITAP	Instituti i Trainimit të Administratës Publike
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KM	Këshilli i Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MADA	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MCV	Ministri për Cështjet Vendore
MD	Ministria e Drejtësisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MF	Ministria e Financave
MIAP	Ministri i për Inovacionin dhe Administratën publike

MIE	Ministria e Integritit Evropian
MM	Ministria e Mjedisit
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MK	Ministria e Kulturës

Kapitulli i parë

HYRJA

1.1 Qëllimi i kërkimit

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është identifikimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në rritjen e efektivitetit të ndihmës së huaj.

Dokumenti synon të kryejë një analizë të thelluar të financimeve të huaja të përfituara ndër vite nga Shqipëria, të masë impaktin e kësaj ndihme në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi si dhe në disa nga sektorët kyç në vecanti. Pjesë thelbësore e këtij punimi është analiza e performancës së institucioneve përfituese kryesisht lidhur me kapacitetin e tyre përthithës të këtyre fondeve, si dhe përcaktimi i faktorëve dhe problematikave të hasura të cilat kanë cuar në uljen e nivelit përthithës të fondeve dhe si rrjedhim në reduktimin e impaktit të tyre në sektorët e ekonomisë.

Punimi synon të analizojë rezultatet dhe gjetjet nga pyetësorët e mbledhur si dhe nga intervistat e kyera dhe të arrijë në disa konkluzione të përgjithshme lidhur me llojin e problematikave dhe faktorëve kryesorë që ndikojnë në nivelin e ulët disbursues të institucioneve. Kjo analizë do të shërbejë dhe për listimin e disa rekomandimeve për rritjen e efektivitetit të financimeve të huaja dhe rrjedhimisht peshën që zë ndihma e huaj në zhvillimin ekonomik të vendit.

Per qëllimet e këtij studimi është përgatitur një pyetësor në mënyrë të tillë që të përmbushen objektivat dhe hipotezat e studimit. Më konkretisht, analiza e të dhënave ka si synim dhënien e përgjigjeve të pyetjeve kërkimore, si: 1) Cila është ecuria dhe trendi i NH në të shkuarën dhe në çfarë mase ka ndikuar ajo në zhvillimin e sektorëve të ekonomisë dhe në zhvillimin e vendit në tërësi?; 2) Sa ndikon performanca e institucioneve përfituese të NH në efektivitetin e saj?; 3) Ndikojnë faktorë si: autoriteti menaxhues i projekteve, përdorimi i sistemeve vendore të menaxhimit financiar dhe të prokurimit, financimi i bazuar në projekte e jo në portofole/programe, instrumentat për zbatimin e projekteve, dhe planifikimi financiar jorealit i tavaneve buxhetore në efektivitetin e NH?; 4) A është “Mbështetja Buxhetore” përgjigja e duhur për rritjen e efektivitetit të Ndhimes së Huaj?.

Studimi ka për qëllim kryesor të vërtetojë nëse ekziston ndonjë lidhje statistikore midis performancës së institucioneve përfituese të NH dhe efektivitetit të Ndhimes së Huaj. Objektivat e studimit përcaktohen në detaj më poshtë në seksionin 1.3 – Objektivat e Kërkimit dhe Hipotezat .

Pyetësori i përgatitur iu drejtua ministrive të linjes dhe më konkretisht drejtorive të projekteve në institucionet përfituese. Gjithashtu intervista të strukturuar u kryen me drejtorinë e borxhit, buxhetit, dhe thesarit tek Ministria e Financës, Drejtorinë e Investimeve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, APP, me Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhimes së Huaj, në funksionin e Koordinatorit të Ndhimës së Huaj.

1.2 Korniza teorike

Ndihma Huaj (NH) me definicion ka percaktime të ndryshme. Sipas Econmicsdiscussion.net, NH është një transferim ndërkombtar i kapitaleve, mallrave, apo shërbimeve nga vendi / organizata ndërkombëtare që cilësohet si “donator” apo thjesht “donor”, tek një vend/popull tjetër marrës i saj, i cilësuar si ‘pritësi’, e dhënë mbi bazën e arritjes së një përfitimi të dyanshëm nga palët ndërvepruese.

NH cilesohet dhe thjesht si asistence financiare, e dhënë nga një vend i botës së zhvilluar në adresë të një vendi tjetër më pak të zhvilluar (low development country-LDC) (Britanica.com).

NH konsiderohet dhe ajo ndihme ku nëpërmjet saj arrihet të realizohet një lehtësim apo rehabilitim ekonomik, teknologjik, ushtarak etj, me qëllim stabilizimin ekonomik ose realizimin e një mbrojtje të përbashket, mes donatorëve dhe vendëve pritëse (dictionary.com).

NH mund të paraqitet në forma të ndryshme sic vijon:

- Lehtësim/falje borxhesh për të arritur që vendi më pak i zhvilluar të kursejë në pagesat vjetore të interesave, duke iu lënë kështu këtyre vendeve me shume burime për të kryer investime të brendshme.
- Ndihmë direkte, dmth në ushqime, para, apo pajisje të kujdesit shëndetsor
- Ndihmë indirekte, si financim për ndertim infrastructure dhe rrjeti të komunikimit.
- Financime të lira, si skema financimi për mikrofinancat; hua të perballueshme nga sipermarrjet lokale.
- Ndihma të pakushtëzuara (të palidhura), te cilat përfshijnë ndihma të dhëna pa atashuar prane tyre ndonjë mase prerrekuizite.
- Ndihma bilaterale, të cilat përfshijnë ndihma të dhëna drejtpërsëdrejti nga një vend donator i caktuar në adresë të një vendi tjetër pritës pa ndërmjetësim.
- Ndihma multilaterale, të cilat përfshijnë ndihma të ofruara nga donatorët drejt një organizate ndërkombëtare, e cila bën më pas alokimet në adresë të vendeve të ndryshme pritëse. P.sh si Banka Botërore, Bashkimi Europian, etj.

NH mund të realizojë shumë funksione si:

- Sinjal diplomatik për një aprovim të caktuar.
- Forcim aleance ushtarake¹
- Shpërblim ndaj një qeverie për sjellje të dëshiruar.
- Për të zgjeruar influencën kulturore të donatorit.
- Për të ofruar infrastrukturen e nevojshme të kerkuar nga donatori për shfrytëzim të resurseve në vendin pritës.
- Për të patur akses të tjerë të llojit komercial.
- Për qëllime humanitare, altruistike, stabiliteti, prosperiteti & paqeje në rajon dhe me gjere.

¹USA që nga v.1958 nuk e raporton ndihmen ushtarake si pjesë të NH

Gjeresisht pranohet nga Komiteti i Asistences per Zhvillim i OECD (DAC), se ndihma e huaj zyrtarisht konsiderohet si asistencë për zhvillim, kur plotëson tre elementet si më poshtë:

- 1) Trajtohet nga sektorët qeveritarë të vendit prites (qeveri apo agjensi qeveritare).
- 2) Objektivi kryesor i asistencës së huaj është zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqenies së vendit prites.
- 3) Huatë apo koncesionet financiare permbajnë terma lehtesuese në favor të vendeve pritesë.

Me definicion NH (ODA) nuk i perfshin donacionet private.

Ne vitin 2015, Komiteti i Asistences per Zhvillim i OECD (DAC) pati nje buxhet ne total prej 132×10^9 \$².

Vendet pritesë të NH të Rajonit te Ballkanit Perendimor kane marrë gjatë vitit 2013³:

Shqiperia	:	298.38 x10 ⁶ \$	dmth	103.629 USD/kapita	(2,893,005 banore)
Maqedonia	:	251.6x10 ⁶ \$	dmth	121.594 USD/kapita.....	(2,069,172 banore)
Mali Zi	:	127.6x10 ⁶ \$	dmth	204.629 USD /kapita.....	(622,099 banore)
Bosnje-Hercegovina	:	550.04x10 ⁶ \$	dmth	143.830 USD/kapita.....	(3,825,334 banore)
Sebia	:	783.2x10 ⁶ \$	dmth	110.124 USD /kapita.....	(7,111,973 banore)

Sot ekzistojne dy shkolla apo dy kampe mendimi persa i perket faktit se si donatoret do të duhej të ofronin NH :

- i) “Shtytja madhe”, ose qasja e pershtatshme strukturore (big push)
- ii) Qasje sipas “Nevojave bazike” –ushqime,edukim,shendetesi,strehim,furnizim me uje te pishem, higjenë (basic needs-propozim i ish presidentit te BB R. McNamara v.1970).

Nese do te ktheheshim pak në retrospektivë historike, “Plani Marshall” ishte ai instrument baze bilateral i qeverisë së Shteteve të Bashkuara, për te rindertuar Europen Perendimore te pas Luftes së II Botërore, i cili nxitte Presidentin e SHBA-së, Harry Truman, të deklaronte se ‘NH eshte trashgimia qe unë lë pas. Nese une do te kujtohem ndonjehere, me siguri do te jene programet e mia të NH “ (USAID). Sot ka, sipas AidData, së paku 42 donatorë bilateral dhe 45 agjensi rajonale dhe

² Donator me i madh ne vlere absolute eshte EU me 86.06×10^9 \$; shperndarje e ketij buxheti ne vendet me kryesore te EU eshte : UK (perpara brexit) me 17.88×10^9 \$, Gjermani me 14.06×10^9 \$, Franca me 11.38×10^9 \$. pasuar nga USA me 31.55×10^9 \$ dhe Japonia me 11.99×10^9 \$. Por ne perqindje te PBB (GNI) te vendeve te tyre kemi : EU me 0.47 % , USA me 0.17 % , dmth larg nivelit te vendosur ne vitin 1970, nga vendet e pasura te UN, ku ndihme zyrtare nderkombtare vjetore per zhvillim per vendet ne zhvillim do te duhej te ishte ne nivelin e 0.70 % te PBB te vendeve te tyre. Vetem Suedia ka arritur dhe tejkualuar tashma, kete nivel, ne vleren 1.40 % te PBB te vendit saj me 7.09×10^9 \$ ne vitin 2015, pasuar nga Norvegjin me 1.05 % te PBB te saj, me 4.28×10^9 \$; Luxemburg me 0.93 % te PBB te vet, me 0.36×10^9 \$; Danimark me 0.85 % te PBB, me 2.57×10^9 \$; Netherland me 0.76 % te PBB vete, me 5.81×10^9 \$; UK me 0.71 % te PBB, me 18.7×10^9 \$, qe eshte dhe vendi fundit i Europes kontributi te cilit e arrin nivelit e caktuar nga UN. (Burimi: ODA publikuar nga OECD)

³ Burimi eshte ODA te matur sipas definicionit mbi ndihmen nderkombetare te OECD, me dy nentipet e ndihmes :

- I) Asistenca zyrtare per zhvillim (ODA)
- II) Ndihma zyrtare e marrë - disbursuar (OA)

Burimi: Banka Boterore

multilaterale (si p.sh BB dhe FMN) që ofrojnë NH të regullta mbi një bazë të regullt (Tierney et al. 2011). Janë shpenzuar në formën e NH për gjatë periodes nga viti 1947 deri në vitin 2009 rreth 4.2×10^9 \$ (me vlerën e USD të vitit 2000), fonde të cilat kanë financuar zbatimin e 100,000 projekteve. Kjo do të thotë që mesatarisht janë shpenzuar rreth 80 milion USD çdo vit.

Nga viti 1973 deri në vitin 2008 angazhimet për ofrim të NH janë katërfishuar. Pra, si kompozimi dhe angazhimet e donatorve ndaj zhvillimeve të huaja, kanë ndryshuar dramatikisht në kohë, si pasojë e rritjes së utilitarizimit të NH si një instrument ky i politikës së jashtme. Si rezultat, në ditët sotme është hapur një debat i madh nëse:

- I) NH është efektive në gjenerimin e një rritje ekonomike të vendeve pritëse, dhe në rritjen e efekteve të tjera zhvillimore pozitive?
- II) Cilat janë vendet që do të duhej t'u ofrohej NH? Cfarë strategjie zhvillimi do të duhej të ndiqnin donatorët dhe vendet pritëse të NH?

Në dekadën e fundit janë bërë mjaft studime kërkimore dhe është ngritur një debat kontraversial midis politikbërësve, medias dhe publikut. Thembra e Akilit qëndron nëse NH do të duhej të kanalizohet direkt për të zhvilluar vendet me të varfëra në botë, apo do të duhej të perdorej për arritje të qëllimeve strategjike të donatorëve. Megjithatë kjo e fundit duket si pa kuptim, Milner & Tingley (2013) kanë konstatuar se ka diferencë të mëdha midis publikut dhe elitave në lidhje me qëllimin final të NH, dhe të kanaleve që kjo NH do të duhej të implementohej. Kjo për faktin se efektiviteti i NH dhe qëllimet finale, janë shumë fort të nderlidhura mes tyre. Kështu p.sh. gjatë viteve 1950 – 1960 dominonte bindja që shkak i moszhvillimit të rajoneve me të varfëra të botes, ishte thjeshtë “hëndeku i krijuar nga investimet e munguara”. Prandaj në atë kohë u ndoq rruga e intensifikimit të investimeve të brendshme në ekonomi dhe infrastrukturë, me synimin arritjen e niveleve të botes së zhvilluar, nepermjet lëvrimit të burimeve financiare në adresë të vendeve pritëse të NH. Pra donatorët kanalizuan resurset e tyre, në shkallë të gjerë, drejt investimeve publike apo programeve shtetërore. Në mbështetje të kësaj ideje, në vitin 1960 u themelua “Akhensia Nderkombtare e Zhvillimit” (IDA), pjesë e grupit të BB, me synimin rritjen e nivelit të granteve për vendet në zhvillim. Gjithashtu u krijuan agjensi të shumta donatorësh të tipit bilaterale. Ky trend vazhdoi deri në vitin 1970 kur “Asambleja Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara” (UNGA) adaptoi propozimin e 0.7 % të PBB (Clemens & Moss – 2005, OECD). Kjo çoi në krijimin e një sistemi për mbledhjen e të dhënave statistikore mbi shpenzimet e NH, me qëllim monitorimin e saj, alokimin e saj, si dhe të ndjekjes së levizjeve të donatorve drejt arritjes së qëllimit të përbashkët të NH. Ky sistem u quajt “Sistemi Raportimit të Kreditorëve” (Creditor Raport System – CRS), i cili ofron një databazë të centralizuar mbi fluksin e NH për 22 vendet anëtare, dhe për shumë agjensi multilaterale. Kjo databazë u kthye kështu dhe në burim për shumë studime akademike kërkimore, por edhe për politikbërësit.

Gjithë ky perpleksitet, midis dy shkollave, bëri që donatorët të konfuzohen për mungesën e një perspektive të qartë rreth ekzistencës së rezultateteve pozitive të pritëshme apo të prekshme të NH. Vetëm vonë, nga fundi i viteve 1970, BB & IMF lancuan politiken e re mbi lëvrime të NH, e quajtur “Përshtatja e Programeve të NH”. Qëllimi i kësaj politike ishte të minimizohej dimensionin i shtetit nepermjet orientimit drejt “Stabilitetit Makroekonomik” të vendeve pritëse të NH. Kjo do të thotë që vendet pritëse kondicionoheshin në disbursimet e NH, në varesi të bërjes së reformave ekonomike të

pershtateshme, qe nxisin ekonominë, si per t'u zhvilluar, ashtu dhe per t'u aftesuar per te kapercyer krizat ekonomike te mundshme⁴. Kjo 'detyronte' vendet pritëse të NH të pershtasin strukturalisht institucionet e tyre, me anë të bërjes se reformave ekonomike, me qëllim stimulimin e ekonomisë dhe zhvillimin ne saj ne mënyre te qendrueshme, e aftë per të kapercyer krizat ekonomike të mundshme. Ky model I ri i levrimit te NH u quajt modeli i "Konsensusit te Washingtonit " (Washington Consensus). Pra qellimi final ishte qe vendet pritese te NH, te perdorin NH sipas qellimit te donatorëve, si dhe ne të njejtën kohë te implementoheshin reformat e duhura te qenesishme per ekonomite lokale. Ne kete menyre donatoret evitojnë tendencen qe kane qeveritë e vendeve pritëse, qe pasi marrin NH, shpesh t'i devijojne burimet e planifikuara lokale nga buxhetet e tyre. Gjithashtu donatorët, në këtë mënyrë kushtezojnë qeveritë pritëse të NH që te implementojne ato projekte qe jane te destinuar per për t'u financuar me NH.

Pas proklamimit te "Konsensit te Washingtonit" lindi debati se cila rruge duhej ndjekur per rritjen e efektivitetit te NH. Keshtu u ravigjzua kalimi nga gjendja dy polare ne atë tre polare, dmth: "Shtytja e Madhe", "Nevojat Baze" dhe qasja e fundit "Pershtatja Strukturore". Ky konfuzion mbi qartësinë e rruges qe duhej ndjekur solli ne skene nje ortek me studime e kerkime shkencore akademike të kësaj natyre. Keshtu, ne vitin 2009, Dougcouliagos & Paldam sintetizuan rezultatet e ketij debati te perbere nga 97 studim-kerkime akademike mbi efektivitetin e NH. Ky sintetizim pasqyroj dy kampe si më poshtë:

- 1) "Kampi i optimistve", qe kerkojne rritje substanciale te nivelit te NH, pasi besojne fort ne efektivitetin qe ka NH ne nxjerrjen nga varferia te vendeve ne zhvillim. Përkrahësit e këtij kampi argumentojne se ekziston nje korelacion i forte mes NH dhe rritjes ekonomike së vendeve pritese te NH (Rosentein & Rodan v.1943, Chenery & Strout v.1966, Sachs v.2004, Hansen & Tarp v.2001, Sachs v.2006).
- 2) "Kampi i pesimistevë", qe nuk besojne se NH ndikon ne uljen e varferise ne vendet pritese te ketyre ndihmave. Ata argumentojne se NH duhet te anashkalojë qeveritë e ketyre vendeve dhe te shperndahet drejtpersedrejt tek populli I thjeshtë, ne sasi te vogla, ose në të kundërt NH, te ndalojë teresisht se dhëni ketyre vendeve. Kjo per shkak te efekteve negative qe NH sjell tek vendet pritese ne raport me IHD, pasi sipas tyre, NH jo vetem deformon ekonomitë e ketyre vendeve, pra potencialisht ngadalson rritjen ekonomike dhe zhvillimin e tyre, por mbi te gjitha ndikon në mbajtjen në pushtet të qeveritarëve të korruptuar. Nje gje e tillë mund të rezultojë më pas në destabilitet ekonomik dhe politik te ketyre vendeve (Easterly 2001, Braeutigam & Knack 2004, Moss et al 2006, Djankov et al 2008, Easterly & Pfuetze v.2008, Knock & Moyo 2009).

Nje arsye tjetër për lindjen e argumenteve pro dhe kundra efektivitetit te NH jane dhe variacionet ne karakteristikat e donatorve te ndryshem. Studjuesit janë të mendimit se prirja e pergjithshme e donatorëve eshte të kushtezojne NH mbi kriterin gjeopolitik, si dhe te interesat të tyre ekonomike (Vreeland 2011, Faye & Nichaus 2012, Bermeo & Leblang 2014). Po keshtu konstatohet se shpesh donatoret qe ofrojne NH, e kushtezojne atë ne shkembim te votave te vendeve pritese te NH pro tyre ne OKB. Si rezultat, shpesh NH diferencohet mbi baza ideologjike, mbi baze te fuqise se parapëlqimit,

⁴ Model ky i aplikuar qe prej v.1950 ne kondicionimin e dhenies se huasë nga BB & IMF per: krizen e naftes, krizen e borxheve, recesionin nderkombetar te v.1970 dhe fillimit 1980 ne vendet e Ameriken Latine.

paragjykimeve të opinionit publik të vendeve të tyre, etj. (Dreher v.2014, Tingley v.2010, Paxton & Knack v.2012, Baker & Fitzgerald v.2012, Nielson & Findley v.2012).

Si përfundim, studimet akademike në shumë raste tregojnë se konsideratat strategjike të donatorve kanë luajtur rol negativ në rritjen ekonomike të botes në zhvillim, duke e bërë NH me pak efektive (Tirone v.2010, Kilby & Dreher v.2010).

Ndihmat e dhena nga forumet multilaterale konsiderohen me pak strategjike në alokimin e tyre (Dietrich v.2013) - ndonjë gjithësesi këto influencohen nga shtetet e fuqishme, apo koalicionet shtetesh, që janë anëtarë të këtyre forumeve - (McLean v.2011, Scheider & Tobin v.2013, Dietrich v.2013 & 2014).

Ndërkaq, edhe vetë vendet pritese të NH, me politikën që kanë ndjekur kanë ndikuar në uljen e efektivitetit të NH, kjo për faktin se këto vende jo gjithmone kanë kapacitete absorbuese efektive (Prunier, 2009, Herbst & Mills, 2009).

Gjithashtu, ka studjues që konkludojnë se NH pasuron vetëm drejtuesit e zyrave në vendet në zhvillim, pasi ata pushtetarë i përdorin NH për të maksimizuar qëndrimin e tyre në pushtet (Jablonski v.2012, Cruz & Schneider v.2014).

Ndërsa studjues të tjerë si Chenery & Strout, pohojnë në studimin e tyre të vitit 1966 “Modeli Dual i Hendekut” (Dual Gap Model), se NH jo vetëm rrit performancën ekonomike të vendeve pritese, por ajo gjeneron rritje ekonomike të miredit, pasi NH shton kursimet e brendshme të vendeve pritese, si dhe volitshmerinë e monedhës së tyre në këmbimet me valutat e huaja. Kjo ndihmon në mbylljen e hendekut “kursim-investim” dhe të hendekut “eksport-import”.

Po në këtë frymë, Carol Lancaster thekson se 25% e NH duhet të jetë grant, në mënyrë që ajo të jetë efektive. Mbeshtetësit në favor të aplikimit të NH, e kanë quajtur atë ‘Levë të Arkimit’ që ndihmon në daljen nga stadi I varferisë I vendeve në zhvillim (p.sh si Koreja Jugut). Midis të tjerave, ata argumentojnë se këto ndihma janë të domosdoshme për ndërtimin e infrastruktures së këtyre vendeve në zhvillim, si dhe për lehtësimin e dhimbjeve që shkaktohen nga fatkeqsitë apo katastrofat natyrore.

Në të njëjtën kohë, kritikët e NH argumentojnë se këto ndihma vetëm sa krijojnë vartësi të këtyre vendeve nga vendet në zhvillim, dhe theksojnë se NH inkurajon keqpërdorimin dhe keqorientimin e tyre .

Por, rasti i Koresë së Jugut, e rrezon poshtë këto ide. Koreja e Jugut është shndërruar nga një vend përfitues, pra pritës i NH për rreth 15 vjet, që pas luftës (1950-53) e në vazhdim, në një vend donator të NH. Ajo, në vitin 1996 u bë anëtare e OECD, dhe në 2009 e “Komitetit të Asistencës për Zhvillim” (DAC). Koreja e Jugut ka përdorur NH të tipeve të ndryshme: të kondicionuar, grante, hua, dhe ka përdorur kryesisht kanalet multilaterale në krahasim me ato bilaterale. Në total NH e disbursuar për K.Jugut, arrijnë vlerën prej 12.7×10^9 \$, për periudhën 1945-1990 (OECD, 2008 :9).

Ky sukses i Koresë së Jugut është spektakolar, duke patur parasysh faktin e të qenit një vend i shkatërruar prej luftës, ku ishin shkatërruar plotësisht pothuajse 50% e infrastruktures urbane, rreth

20% te banesave, migracioni i brendshem drejt periferive te qyteteve te medha kishte arritur rreth 2 milion banorë, gjë që jo vetem ngadalsoi, por rriti ne ekstrem kostot e urbanizimit te këtyre qyteteve. Gjithashtu, vendi shquhet per mungesë të burimeve natyrore, dhe mbizotëronte nje shoqeri e theksuar rurale e cila perpiqej te mbijetonte, me anen e nje bujqesie tepër te prapambetur, ku ne fuqi ishte ende nje sistem skllaverie (bujq qiramarres te ngastrave të arës).

Nje nder drejtimet per manaxhimin efikas te NH ne Koren e Jugut ishte financimi I “Projekteve per rippershtatjen e tokes” (land readjustment projects), ku nje pjese e caktuar e tokes se nje pronari, merrej nga nje zhvillues publik ose privat. Pas zhvillimit te asaj toke nepermjet investimeve te caktuara, ajo shitej me synimin qe te rimbursonte koston e zhvillimit. Ky lloj programi qeveritar, uli barren fiskale te qeverise per urbanizimin e atyre zonave rurale, sepse kostoja perkatese u mbulua tërësisht nga pronaret. Me kete nismë u urbanizuan rreth 16.5 km² siperfaqe ne 23 qytete si Seul, Busan, Daeg dhe Incheon, per nje periudhe kohore 7 vjecare (1952-1959), me fokus rehabilitimin e pas luftes, si dhe ndertimin e rrugeve te reja ne zonat urbane.

Ne 1970, me rekomandim të IMF Koreja Jugut adaptoi “Programin Stabilizues”, qe do te bente te mundur kapercimin e ngadalësimit te rritjes, qe u shkaktua nga hyrja ne recession e partnerve tregtarë te huaj te saj. Kjo do të mundësonte ripagimin e huave te huaja, qe ishin bere nje barre serioze per firmat me borxhe (Chung-Yum Kim – 2006 f.313-314).

Qeveria Koresë së Jugut ka industrializuar ekonominë e vendit nëpërmjet planeve 5 vjecare të cilat ndikuan pozitivisht në rimëkëmbjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Qe nga viti 1991, Korea e Jugut qe e aftë të krijonte ura per ofrimin e NH drejt vendeve ne zhvillim. Si rezultat u krijuan ‘Agjensia e Kooperimit Nderkombtar’ (KOICA), si dhe ‘Korea Exibank’s Economic, Development & Co-operation Fund’ (Kwang Suk Kim v.1994 f.347-348, Choong Young Ahn & Joo-Moon Kim 1995,f.330).

Ne vitin 2011, fluksi i NH të ofruar nga Korea e Jugut ishte rreth \$1,248.32 milion, qe përbën rreth 0.12% te PBB-së së saj. Kjo vlere ka njohur rritje shume me të shpejte në krahasim me antarët e tjere tradicional te DAC, qe kane ngecur, prej vitesh ne vlere te përafërta (Japonia me 0.18 % te PBB-së, USA me 0.20 % te PBB-së)

Nga kjo analizë e NH, kryesisht e 12 viteve të fundit, ne lidhje me ndikimin qe ka NH mbi arritjen ose jo të nje rritje te qendrueshme ekonomike, mund të konkludohet në dy shkolla mendimi si më poshtë:

- I) Ky këndvështrim pranon se NH, thjesht i rrit strukturalisht qeveritë e vendeve pritese, por përfitimet tek te varfërit jane minimale, si dhe con në mungesë investimesh. Ndikimi i NH mbi ekonominë e vendetve pritese nuk varet nga sistemi politiko-ekonomik i instaluar ne to. Pavarsisht natyrës së sistemit (liberalo –demokratik, apo shume represiv), efektet e NH do te mbeteshin neutrale. Gjithsesi, mbetet për t’u përmendur fakti se vendet me regjim liberalo-demokratik (ceteris paribus), kane një shkallë të mortalitetit foshnjor rreth 30% me te ulët, krahasuar me vendet e regjimeve represive. Kjo ka të beje me faktin se, ndonëse elitat politike te ketyre vendeve liberalo-demokratike, vazhdojne të thithin përfitimet kryesore të NH, shtresat e varfëra arrijnë te përfitojnë dicka e si rrjedhim të fuqizohen me shume se në regjimet represive.

- II) Në kontrast me këndvështrimin e parë, grupi tjetër është i mendimit se mjedisi gjeopolitik mbetet qartësisht përcaktuesi kryesor në efektivitetin e NH.

Nderkaq, te dy shkollat e mendimit pajtohen së bashku lidhur me principin e performances se NH. Dmth. nese alokimi i fondeve te NH do te bëhej ne përputhje me mjedisin gjeopolitik që ekziston rreth vendit pritës, atëhere dhe performanca e NH do te ishte më efektive.

Keshtu, studimi i kryer nga P.Guillaumont & L.Chauvet në vitin 2010, f.66-92, e vërteton konkluzionin e sipercituar. Ky studim thekson se performanca e NH, mund të matet duke bere alokime të shumta të fondeve, tek nje vend qe ka nje politikë qeverisëse më të forte se mjedisi gjeopolitik që e rrethon, dhe e kunderta, te alokohen fonde te shumta ne nje vend me qeverisje të brendshme me te dobët sesa ai i mjedisit rrethues gjeopolitik. Konkludohet, ne kete studim, se nese NH është afatshkurtër, në vendet me regjime liberalo-demokratike, ajo mund te ketë ndikim më të lartë ne reduktimin e varferise. Gjithsesi, sipas këtij studimi, NH mund te arrijë nje qellim modest ne reduktimin e varferise, pra mund te ndihmojë disa njerez, per nje kohe te caktuar, por mbetet nje mit i pastër urban, te besuarit se ajo mund te jetë katalizatori I transformimeve te gjëra sociale, apo se NH mund te “blejë” rritje te qendrushme ekonomike. Kjo per faktin se NH operon ne terren te paqendrueshem, si teorikisht dhe empirikisht. Ky mit vetem sa I pengon donatorët e NH ne kryerjen e vlersimeve shkencore (P.Boone -Jornal European Economic Review v.1999 vol.40,f.289-329; Easterly,William-Jornal European of Economic Perspectives v.17,v.2003,f.23-48).

Me performance te NH kuptohet matja empiriko-shkencore e eficencës se investimeve te donatorit në vendin prites. Më konkretisht kjo do te thote njohje e qëllimeve strategjike qe ka synuar te targetojë NH. Disa prej këtyre qëllimeve strategjike radhiten si më poshtë:

- i) Rritje e qendrueshme ekonomike.
- ii) Promovimi i zhvillimit të sektorit privat, si indikator i uljes se varferise.
- iii) Aftesim i te varferve, duke i dhënë atyre mundësinë të marrin pjese ne ndarjen e përfitimeve që rezultojnë nga rritja ekonomike.
- iv) Fuqizimi gjinor nëpërmjet sigurimit që grate te kene zë ne 80% te vendimarrjeve per realizimin e investimeve te NH, punesimin e tyre ne sektoret ku perdoren NH, si dhe nje adresim te forte kunder dhunës ndaj tyre.
- v) Sigurimi i aplikimit të principit “vlerë-per-para” (value-for-money). Ky kriter kerkon qe jo me pak se rreth 85% te investimeve te implementuara te kene arritje pozitive. Pra keto investime te kene arritur efektivitetin dhe eficencen standarte dhe te kene reflektuar nje “vlere te shtuar jetësore te prekshme. Kjo arrihet duke vlerësuar performancën e investimeve ne menyre periodike/vjetore. Nese keto standarte nuk arrihen, pra permiresimet nuk duken, brenda periudhes 1 vjecare, atëhere implementimi investimeve ne sektoret e caktuar do te duhet te anulohet.
- vi) Pakësim gradual i numrit te investimeve të vogla individuale deri ne masen 20% me qëllim reduktimin e kostove dhe kohës që nevojitet per realizimin transaksioneve. Investimet e medha dhe te perqendruara kanë tendencë të jenë më efektive, si dhe kanë kosto më të ulta administrative-manaxheriale se se ato per cdo projekt individual.

- vii) Luftë kundër korrupsionit. Megjense NH zakonisht ofrohet në vende të cilat kanë nivel të lartë korrupsioni, ushtrohet një monitorim/kontroll i rreptë, pergjate gjithë procesit të implementimit të investimit, përfshirë këtu dhe hartimin e strategjive që kanë në thelb të tyre luftën kundër korrupsionit.
- viii) Raportimi periodik mbi matjen e performances, ku të jetë e përfshirë analiza e pikave të siperpermendura.

(Foreign Affairs & Trade – Australia 2014 : dfat.gov.au)

Një ndër mënyrat më të aplikueshme për matjen e performances së NH nga donatorët, është edhe indeksi I ponderimit të të ardhurave për kapita në vendet pritese. Nga pasqyrimi i këtij indeksi rezulton se 4 vendet donator që kanë demonstruar një nivel më të lartë performance në ofrimin e NH janë: Belgjika, Finlanda, Danimarka dhe Norvegjia. (index I 17 DAC antare dhe agjensive multilaterale për periudhën nga v.1969 deri në 1984).

Ndonse ekziston një debat intensiv mbi NH, midis ekonomistëve, politikeberësve, financierëve, etj, I cili ka polarizuar studjuesit e kerkuesit shkencor në mënyrë kontraversiale, deri në vitin 1990 ravijezoheshin vetëm dy grupe të kundërta:

- i) Grupi që konsideron se NH nuk funksionon në misionin e saj fillestar. William Easterly e quan me sarkazëm, dhenien e NH thjeshtë si një iniciativë raciale, dmth si “lemoshe e njeriut të bardhë”. Ndërsa Doucouliagos & Paldam tregojnë se NH në 40 vjetet e fundit, nuk ka qenë produktive (v.2009).
- ii) Grupi i rrymës së kundërt, argumenton se, ekzistojnë shumë evidenca që pasqyrojnë krejt të kundërtën, pra se NH ka arritur qëllimin e saj. (Shankar Prasad Ghimire Phd u.WesternMichiganv.2013).

Vetëm publikimi i artikullit të Bankes Botërore në 1998, me titull “Vlerësimi i NH: Cfare funksionon dhe cfare nuk funksionon, dhe perse”, bëri që politikbërësit të përfshiheshin në zhvillimet ndërkombëtare rreth rolit të politikave ekonomike në vendet pritese të NH (McGillivray et al, v.2006;Burnside & Dollar v.2000). Këtu punime shtuan një dimension të ri, sipas të cilit NH funksionon me efektivitet vetëm atëherë kur mjedisi politik i vendeve pritese është ‘i mirë’. Kjo nxiti debatin mbi politikën fiskale, monetare, tregtare etj. (Collier & Dehen v.2001; Collier & Dollar v.2002; Brunside & Dollar v.2004).

Por ky konstatim i tyre u kontestua si i paqëndrueshëm, i parë në prizmin se ekzistojnë një sërë faktoresh që duhen analizuar kur bëhet fjalë për efektivitetin e NH (Dalgard & Hansen v.2001;Islam v.2002;easterly et al v.2004).

Tradita ka treguar se të gjitha rrymat e mendimit bien në përgjithësi dakord se funksioni kryesor i NH është ndihma e ofruar drejt vendeve në zhvillim me qëllim rritjen ekonomike të këtyre vendeve. Por shizma/ndarja e madhe ndodh kur duhen përcaktuar rrugët që duhet të ndiqen për të rritur efektivitetin dhe eficienten NH tek vendet pritese, dhe për pasojë dhe performancën e donatorëve.

Në studimet pararendëse mbi efektivitetin e NH është përdorur metoda kumulative në analizen dhe matjen e ndikimit të NH (ODA-Official Development Assistance) tek e gjithë rritja ekonomike e vendit pritës. Por një gjë e tillë injoron të papriturat e paparashikueshme që mund të ndodhin brenda për

brenda se njejtës variable (sektor ekonomie). Nderkaq dihet, se në praktikë, NH mund të jetë e shpërndarë në mënyrë jo të njëtrajtëshme, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Pra NH mund të ndikojë pak, ose aspak, në rritjen totale të ekonomisë së vendit prites, megjithëse sektor të vecantë mund të kenë pësuar rritje të ndjeshme, siç dhe ndodh me sektorin e eksporteve. Sipas kësaj linje mendimi, NH do të duhej të targetonte përmirësimin e kapaciteteve tregtare të vendeve në zhvillim dhe të analizohej efekti i saj në performancën e eksportit në këto vende pritëse.

Ekonomistët besojnë se rritja e tregtisë ndërkombëtare dhe rritja e eksporteve është vitale për daljen

nga varferia të vendeve në zhvillim, (Awokuse, v.2006; Hausmann et al, v.2006; Rpdrik ,v.2008; Abott et al,v.2009). Rritja e eksporteve përkthehet në rritje punësimi, rritje të ardhurash, si dhe rritje të kërkesës për produktin e eksportit, që do të thotë rritje të mëtejshme të prodhimit dhe eksportit. Kjo ben që firmat eksportuese të jenë kompetitive, si në tregun e brendshëm dhe në atë global dhe si rrjedhim në rritje të efikasitetit të ekonomisë së vendit prites të NH.

Kjo qasje e re, ndihma e dhënë në funksion të zhvillimit të tregtisë (Aid for Trade – AfT), ka bashkuar tashmë si vendet donatore që janë në favor të dhenies së NH, dhe organizatat që promovojnë tregtinë e lirë, si “Organizata Botrore e Tregtisë”(WTO) dhe OECD, me qëllim bashkëpunimin ndërmjet tyre duke patur si qëllim të përbashkët rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim. Ndonse AfT ishte vetëm 18 % e totalit të NH në vitin 2006, në vitin 2010 kjo shifer është rritur në nivelin 30 % (130x10⁹\$). WTO & OECD kanë nxitur fort zbatimin e kësaj qasjeje duke ngritur një taskforce për promovimin e alokimit të NH në sektorin e tregtisë (Melitz v. 2003; Helpman, Melitz, Yeaple v.2004).

NH e dhënë për qëllime emergjente si lehtësim të pasojave nga katastrofat, shendetesi, zhvillimin e sistemit të edukimit, apo ulje të treguesve të varferisë, megjithëse mund të ndikojë në mënyrë direkte apo indirekte në zhvillimin ekonomik të vendit prites, në shumicën e rasteve nuk ndikon direkt në eksportet tyre, siç ndodh me AfT.

Sipas OECD, madhësia e AfT, shprehet në shumatorën totale të NH që shkon në sektorin e infrastruktures së ekonomisë, shërbimeve, etj. nepermjet të cilave pritet të promovohen eksportet. Pra këtu përfshihen kategori të NH të cilat shpenzohen për: politika tregtare të cilat kanë lidhje me infrastrukturen dhe që ndikojnë në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese. Kjo përpjekje për AfT, është shprehur dhe me heret në kohë, por vetëm në vitin 2005, ceshtja AfT, morri një trajtim serioz sistematik (Morrissey,v.2006;Wagner,v.2003;Lloyd,v.2000).

Edhe në Shqipëri vihet re se vitet e fundit është përqafuar përqasja për ta orientuar ndihmën e huaj rejt promovimit të eksporteve me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. Por vlen për t’u theksuar se, kryesisht gjatë tre viteve të fundit, NH ka filluar të orientohet në funksion të reformave dhe politikave të brendshme, e jo më sipas axhendës dhe progrmeve të donatorëve. Në këtë kuadër, eksportet dhe politikat e investimit që nxisin rritjen e nivelit të tyre përbëjnë një prioritet kyc për t’u adresuar.

Sipas VKM-së Nr.775, datë 24.9.2010, ‘Për Administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë’ që është ende në fuqi, si financime të huaja përcaktohen të gjitha huatë, kreditë dhe grantet që merr Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë, nga

shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, dhe organizatat joqeveritare.

1.3 Metodologjia

1.3.1. Objektivat e kërkimit

Objektivi kërkimor kryesor i studimit është: Matja e performancës së institucioneve përfituese të NH si faktor në efektivitetin e NH. Ky objektivi do të studiohet nëpërmjet:

- Analizës së të dhënave parësore të mbledhura nga pyetsorët e përgatitur dhe të shpërndarë në institucionet përfituese të ndihmës së huaj, si dhe informacionit të mbledhur nga intervistat me Departamentin që merret me Koordinimin e Ndihmës së Huaj, në kryeministri, si dhe me donatorët kryesorë që kanë kontribuar e financim ndër vite;
- Kryerjes së një analize përshkruese së të dhënave dytësore për ndihmën e huaj nga databaza e financimit të huaj që ka përfituar Shqipëria gjatë periudhës 2005-2015, të vënë në dispozicion nga DZHFNH, duke u fokusuar në shpërndarjen sipas ministrive, donatorëve kryesorë, në sektorë të ndryshëm, dhe sipas llojit të ndihmës (grant apo kredi e butë);
- Vlerësimit të impaktit të saj në zhvillimin e sektorëve kyç si transporti, ekonomia (duke u fokusuar tek zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme), bujqësia, si dhe të vendit në përgjithësi;

Pas kryerjes së kësaj analize të thelluar do të tentohet të identifikohen instrumentat si dhe problematikat që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen apo uljen e performancës së institucioneve përfituese;

Objektiv kërkimor dytesor: Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në rritjen e efektivitetit të ndihmës së huaj dhe rritjen e ndikimit të saj në zhvillimin e vendit. Ky objektivi do të studiohet kryesisht nëpërmjet identifikimit të hapave konkrete që duhen ndërmarrë për të rritur efektivitetin e Ndihmës së Huaj për të ardhmen

1.3.2. Hipotezat e kërkimit

Hipotezat e kërkimit të studimit listohen si më poshtë:

Hipoteza Qëndrore H_0 : Performanca e institucioneve përfituese (disbursimi sipas planifikimit) dhe përfshirja e planifikimit të disbursimeve të NH në buxhetin shtetëror ndikon në efektivitetin e NH.

Hipotezat e Punës:

H_1 : Reduktimi i vonesave procedurale për shkak të ristrukturimit të projektit gjatë zbatimit të tij dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore e materiale në institucionet përfituese ndikon në zbatimin e projektit sipas planifikimit.

H_2 : Efektiviteti i NH varet nga sektori i ekonomisë.

H_3 : Reduktimi i vonesave në fazën e projektimit dhe prokurimit ndikon në efektivitetin e NH.

H_4 : Përfshirja e ndihmës së huaj në tavanet buxhetore (PBA) ndikon në planifikimin më realist të fondeve të huaja nga institucionet përfituese dhe rrjedhimisht në performancën e tyre.

1.3.3. Instrumentat matës të kërkimit

Në mungesë të literaturës apo studimeve të ngjashme në Shqipëri mbi ndikimin e performancës së institucioneve përfituese në efektivitetin e NH, janë kryer intervista të hollësishme me drejtuesit e donatorëve dhe drejtoritë e projekteve në institucionet përfituese për të kuptuar mënyrën se si mund përgatitej pyetësi.

Struktura e pyetësit është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të marrë përgjigje për shprehjet që formojnë variabël. Pyetësi është i ndërtuar për çdo projekt dhe përmban 5 seksione si më poshtë:

- Pjesa e parë përfshin të dhënat formimit të përgjithshëm dhe informacion mbi projektin
- Pjesa e dytë përfshin pyetjet lidhur me ku konsiston projekti, sektorit apo industrisë të cilës i përket, etj.
- Pjesa e tretë, përfshin pyetjet që lidhen me problematikat e hasura.
- Pjesa e katërt, përfshin pyetjet që lidhen me impaktin e projektit në sektorin përkatës si dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.
- Pjesa e pestë, është lënë e lirë për listimin e rekomandimeve të aktorve të ndryshëm, të cilat mund të përmiresojnë zbatimin në kohë të projektit dhe përthithjen e fondeve të huaja.

Një anketim pilot prej 30 projekteve është realizuar në mënyrë që të testoheshin të gjitha hapat e

studimit. Nga rezultatet e këtij anketimi pilot u rishikua edhe një herë pyetësi i shpërndarë, dhe u bë i mundur dhe ndryshimi i planit të tabelave për t'u prodhuar.

Studimi paraprak ndihmoi në përlllogaritjen e procesit të intervistimit. Sipas personave të përgjigjur intervista arrinte një kohëzgjatje mesatare prej rreth 40-50 minuta.

Për kryerjen e studimit u mbledhën 212 pyetësorë (që i takojnë 212 projekteve me financim të huaj aktualisht në zbatim në sektorë të ndryshëm). Për analizën e të dhënave u përdorur SPSS.

SPSS ka aftësi të mëdha dhe fleksibilitet në analizën e të dhënave. Kjo paketa u perdorë edhe për analizë të variancës (Anova), testet statistikore chi - katror, analizë të korrelacionit, analizë të regresionit, testet e hipotezave statistikore etj.

Informacioni i mbledhur nga pyetësorët përbën edhe të dhënat baze mbi të cilat është mbështetur kryerja e këtij studimi.

Të dhëna dytësore të përdorura kanë qënë kryesisht të dhëna rreth financimit të huaj të prodhuara nga DZHFNH (databaza e donatorëve), dokumente strategjike, raporte të prodhuara nga organizata ndërkombëtare si BB, OECD, etj., dokumente ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet midis donatorëve dhe shteteve përfituese, minuta nga takime me ML apo donatorë, progres raporte të prodhuara nga DZHFNH, strategji operative të donatorëve kryesorë, marrëveshje bashkëpunimi, raportet e INSTAT e të Bankës së Shqipërisë, etj.

Ky punim është përgatitur në konsultim me Departamentin i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DZHFNH), me ministritë e linjës dhe donatorët dhe analiza e tendencave të kaluara të ndihmës

së huaj, është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Financimeve dhe Ndhmës së Huaj (nëpërmjet intervistave të kryera).

Kapitulli i dytë

TENDENCAT AKTUALE TË NDIHMËS SË HUAJ

Analizë e mbështetur në raportet e prodhuara nga Departamenti i Zhvillimit, Financimit dhe Ndhmës së Huaj, donatorët, organizatat vendase dhe ndërkombëtare

Per kryerjen e analizes u perdoren te dhenat nga databaza e DZHFNH, si dhe dhënat për grantet dhe kreditë koncensionare. Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)/Komiteti i Asistencës së Zhvillimit (DAC). Këto të dhëna janë klasifikuar si Ndhmë Zyrtare për Zhvillim (ODA)⁵, dhe përkojnë me të dhënat e dokumentit të Deklaratës së Parisit dhe me raportimet e tjera ndërkombëtare mbi ndihmën e huaj. Të dhënat janë për disbursimet dhe bazohen në informacionin zyrtar vjetor që donatorët raportojnë në OECD/DAC. Burimi i dytë kryesor i informacionit është baza e të dhënave zyrtare të donatorëve, i cili është mirëmbajtur dhe menaxhohet plotësisht nga DZHFNH. Parashikimet për ndihmën e huaj për vitet 2016-2019 janë bazuar në bazën e të dhënave të donatorëve duke supozuar se disbursimet bëhen në shumën e barabarta gjatë ciklit të projektit. Baza e të dhënave synon të përfshijë të gjithë projektet në vazhdim, të gjitha projektet e planifikuara si edhe ato projekte që kanë përfunduar kohët e fundit (kryesisht gjatë 4 viteve të fundit).


Ndihma e Huaj për Zhvillim - ODA - përfshin vetëm kreditë me një element granti mbi 25%, dhe nuk përfshin kreditë të cilat jepen me terma tregtarë. Burimet kryesore të ndihmës së huaj jo-koncensionare janë Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI) dhe Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës (CEB). Analiza e bazës së të dhënave të borxhit në MF tregon se disa nga donatorët dypalësh japin edhe kredi në terma jo-koncensionare. Për të pasqyruar nivelin e kredive jo-koncensionare pas vitit 2005 janë përdorur të dhënat e marra nga baza e të dhënave të donatorëve.

2.1 Situata aktuale dhe tendencat e ndihmës së huaj (krahasime ne rajon)


Që nga viti 2000, ndihma e huaj ka qenë në nivele të qëndrueshme duke variuar në vlerat 300 - 350 milion euro në vit. Në vitet e fundit, kryesisht pas vitit 2007, rritja në nivelin e kredive jo-koncensionare ka kompensuar rënien e qëndrueshme në nivelin e granteve dhe kredive koncensionare.

⁵ Të dhënat mbi ndihmën e huaj të paraqitura në këtë kapitull i referohen disburimeve neto të ODA, dhe jo atyre koncensionare, nga baza e të dhënave të OECD/DAC mbi agregatet vjetore të ODA. ODA është përkufizuar si grante ose kredi të cilat: (a) ndërmerren nga sektori zyrtar; (b) kanë si objektiv kryesor promovimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies; (c) janë me terma financiare koncensionare (nëse është kredi, duhet të ketë një element granti për të paktën 25%) (OECD/DAC 2007). ODA raportohet çdo vit nga të gjithë donatorët e vendeve të DAC. Të dhënat e DAC raportohen në USD dhe janë të konvertuara në EURO me kursin e këmbimit të vitit. Këto të dhëna mund të ndryshojnë me ato të bazës së të dhënave të donatorëve dhe nga ato të raportuara nga donatorët.

Ndihma e huaj totale, grante dhe kredi 2007 - 2013 (€ milion)




Ndihma e huaj si përqindje ndaj PBB, mesatare për 2007-2013




Në dy grafikët më poshtë vihet re se Shqipëria renditet e treta duke lënë pas Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi sa i përket nivelit total të ndihmës së përfutur në 13 vitet e fundit. Ndërsa gjatë pesë viteve të fundit, me fillimin e procesit të integritimit në BE të Kosovës, Shqipëria renditet e katërta pas Kosovës.

Ndihma e huaj e përfutur në total për secilin vend të rajonit për periudhën 2000-2013 (në milion Euro)



Ndihma e huaj e përfutur ndër vite nga vendet e rajonit (në milion Euro)



Burimi: Banka Botërore

Vihtet re se dy vendet që kanë thithur e vazhdojnë të përfitojnë nivelin më të lartë të financimeve të huaja në rajon janë Serbia dhe Bosnia Hercegovina.

2.2 Sistemi i planifikimit të integruar dhe strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim

Një nga objektivat e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) është lidhja e ngushtë midis ndihmës së huaj me prioritetet strategjike dhe procesin e buxhetimit. SPI-ja, miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave, përbën një grup parimesh funksionale për të garantuar që procesi i planifikimit dhe i zbatimit të politikave nga ana e Qeverisë të kryhet në mënyrë koherente, efikente dhe të integruar. Dy janë proceset më të rëndësishme në këtë sistem:

- Procesi afatgjatë për *planifikimin strategjik*, **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim** 2007-2013 dhe tani 2015-2020, e cila përcakton përparësitë dhe synimet strategjike. SKZHI ofron

një vizion afatgjatë për zhvillim kombëtar si dhe një horizont afatmesëm për planifikimin e politikave. SKZHI sintetizon strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale afatmesme dhe afatgjata.

- Procesi *buxhetor* afatmesëm, i quajtur **Programi Buxhetor Afatmesëm**, i cili kërkon që midis muajve mars dhe maj çdo ministri të përgatisë një plan trevjeçar brenda një tavani të përcaktuar shpenzimesh, për të arritur objektivat e politikës, si hapa të ndërmjetshëm për arritjen e synimeve të SKZHI-së. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të hartimit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve korrik dhe tetor.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programi Buxhetor Afatmesëm mbështesin plotësisht proceset e mëposhtme të planifikimit:

- **Programin e Qeverisë** i cili u paraqit në parlament në shtator të 2013-ës, në përputhje me detyrimet kushtetuese.
- **Integrimin European**, veçanërisht zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (e cila përditësohet çdo vit).
- **Menaxhimin e investimeve publike**, i cili është pjesë integrale e PBA-së.
- **Ndihmën e huaj**, veçanërisht përpjekjet e Qeverisë për të optimizuar përdorimin e ndihmës së huaj në përputhje me zotimet e Deklaratës së Parisit për efikasitetin e ndihmës.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 zëvendëson Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim 2007-2013, e cila ishte dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë deri në vitin 2013. SKZHI-ja është e lidhur me procesin e rregullt të planifikimit të ministrive, duke përfshirë dhe procesin e PBA-së. Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale janë dokumenti i referencës për PBA-në. Përgatitja dhe përditësimi i strategjive sektoriale është një nga tiparet kryesore të procesit të SKZHI-së. Megjithatë strategjitë sektoriale përditësohen në rast se do të ketë ndryshime të rëndësishme në politikat që ato parashikojnë, SKZHI-ja nuk ndryshon. Megjithatë, një rishikim i procesit të zbatimit të SKZHI-së bëhet çdo vit, duke i paraprirë procesit të përgatitjes së PBA-së në mënyrë që të nxirren informacione të mjaftueshme për përcaktimin e tavaneve buxhetore sektoriale fillestare.

Rëndësia e SPI-së dhe SKZHI-së dhe lidhja e tyre me NH theksohet dhe në VKM-në Nr.775, datë 24.9.2010, ‘Për Administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë’ ku thuhet se, mbështetur në analizën dhe vlerësimin e situatës ekonomike e financiare të vendit, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave, miraton çdo vit programin buxhetor afatmesëm (PBA), si pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar (SPI). PBA parashikon tërësinë e projekteve të investimeve publike, përfshirë edhe ato me financime tërësisht të huaja ose bashkëfinancim me buxhetin e shtetit, për çdo program, në një periudhë trevjeçare. Poashtu, theksohet fakti se koordinimi i projekteve me financim të huaj bëhet në përputhje me procedurat e sistemit të planifikimit të integruar (SPI).

Në këtë kuadër, ndihma e huaj përbën një pjesë organike të të gjithë procesit strategjik të planifikimit dhe buxhetimit. Kjo për faktin se financimet e huaja konsiderohen pjesë e të ardhurave të shtetit shqiptar, që bashkë me të ardhurat e brendshme përbëjnë buxhetin total që ka në dispozicion shtetit për

të materializuar reformat dhe politikat e tij me qëllim rritjen e mirëqënies së popullit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

2.3 Instrumentat ndërkombëtarë për matjen e efektivitetit të ndihmës së huaj

Për një kohë të gjatë, efektiviteti i ndihmës së huaj ka përbërë shqetësim për qeveritë e vëndeve në zhvillim dhe donatorët. Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj, e nënshkruar në Mars 2005⁶, në Forumin e Dytë të Nivelit të Lartë mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj, përfaqëson një angazhim nga të gjithë aktorët për të identifikuar problemet kryesore dhe për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për adresimin e tyre. Shqipëria, së bashku me 107 shtete dhe 26 organizata ndërkombëtare, ka nënshkruar Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj.

Deklarata e Parisit udhëhiqet pjesërisht nga monitorimi i treguesve të krahasueshëm të progresit. Informacioni për këta indikatorë është mbledhur nga Qeveria dhe donatorët duke përdorur një metodologji standarde të miratuar nga OECD.

Në shumë vende në zhvillim janë përgatitur Plane Veprimi për Harmonizim (PVH). Qëllimi i këtyre planeve është rritja e efektivitetit të ndihmës së huaj dhe bazohen në parimet e rritjes së pronësisë, harmonizimit të përputhjes së ndihmës me politikat prioritare, duke përdorur sistemet qeveritare kur është e mundur duke harmonizuar dhe thjeshtuar procedurat e donatorëve. Këto plane merren me harmonizimin jo thjesht në kuptimin e ngushtë që presupozon miratimin e procedurave të përbashkëta dhe shpërndarjen mes donatorëve të konstatimeve analitike dhe vlerësimeve, por me një gamë të gjerë masash me fokus efikasitetin e ndihmës. Planet e Veprimit për Harmonizim janë specifike për rrethanat e çdo vendi, por që nga Deklarata e Parisit mbi Efikasitetin e Ndhmës në mars 2005, ato bazohen në pesë angazhimet e partneritetit të shpallura në këtë Deklaratë:

- Pronësia
- Përafrimi
- Harmonizimi
- Menaxhim për Rezultate
- Llogaridhënia e Ndërsjellë

Deklarata e Parisit përcakton indikatorët dhe objektivat e miratuar në DAC që nevojiten për të miratuar zbatimin e Deklaratës së Parisit. Ndërhyrjet për përmirësimin e efikasitetit të ndihmës varen nga rrethanat e vendit, si dhe nga mundësitë dhe prioritetet e perceptuara nga qeveria e vendit pritës të NH dhe donatorët. Duhet theksuar këtu se Deklarata e Parisit dhe Axhenda e Akrës për Veprim, që zëvendësoi atë në vitin 2008 në Forumin e Tretë të Nivelit të Lartë mbi Efektivitetin e NH, edhe pse ofrojnë një kuadër analitik të shëndetshëm dhe të dobishëm që përcakton fushat ku nevojitet veprim global për të përmirësuar efikasitetin e ndihmës dhe mënyrat se si vlerësohet progresi, nuk përmendin në vetvete se çfarë masash nevojiten për t'u ndërmarrë. Në këtë kuadër u ra dakord se kjo mund të arrihej vetëm me axhendë individuale për çdo shtet, duke hartuar një PVH konkret dhe me detyra të qarta, në mënyrë që individët të ngarkohen për t'i realizuar brenda një afati. Këto detyra përcaktohen sipas realiteteve specifike të një shteti, sipas projekteve dhe programeve aktuale ku donatorët janë angazhuar, si edhe kushteve të sistemeve të qeverisjes (p.sh. për planifikimin kombëtar, menaxhimin financiar publik apo prokurimin). Për këto arsye, një PVH efikas duhet të ketë një analizë të plotë të

⁶ http://www.oecd.org/document/18/0,3343,en_2649_15577209_35401554_1_1_1_1,00.html

pozitës aktuale, në kuptimin e parimeve të Deklaratës së Parisit, ku të qartësohet deri në çfarë shkalle janë arritur parimet themelore si pronësia, përafrimi, harmonizimi, orientimi drejt rezultateve dhe llogaridhënia e ndërsjellë, si edhe faktorët që pengojnë progresin e mëtejshëm në këto drejtime.

Në këtë kuadër, në nëntor të vitit 2009 u hartua dhe publikua Plani i Veprimit për Harmonizim i Shqipërisë, i cili përfshin një analizë të thellë të situatës në vend, në kontekstin e zbatimit të Deklaratës së Parisit dhe përcakton veprimet praktike që duhen ndjekur për të arritur përmirësime të konsiderueshme në efektivitetin e ndihmës së huaj. Sistemi i monitorimit do të jetë pjesë e pandarë e PVH-së, bashkë me një proces menaxhimi të programit që mundëson ndjekjen e aktiviteteve të çdo komponenti të Programit, si dhe parametrat që shërbejnë për të vlerësuar progresin. Meqë PVH bazohet në parimet e Deklaratës së Parisit, monitorimi i progresit në zbatimin e Programit të Veprimit lehtëson monitorimin dhe raportimin e progresit nën sitën e 12 indikatorëve të përcaktuar në Deklaratë ("Indikatorët e Parisit"), si më poshtë:

Indikatori 1: Strategjitë Operacionale të Zhvillimit - vendet partnere të kenë strategji operacionale zhvillimi

Indikatori 2: Sistemet e Besueshme të Vendit – te ekzistojnë sisteme të besueshme Menaxhimi Financiar Publik (MFP) dhe Sisteme të Besueshme të Prokurimit

Indikatori 3: Flukset e Ndhmës të përafruara me Prioritetet Kombëtare – të raportohen në buxhetin e qeverise flukset e ndihmës për sektorin qeveritar.

Indikatori 4: Forcimi i kapaciteteve me mbështetje të koordinuar – flukset e bashkëpunimit teknik të zbatohen me programe të koordinuara që janë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit.

Indikatori 5: Përdorimi i Sistemeve MFP dhe të Prokurimit të vendit pritës nga donatorët

Indikatori 6: Forcimi i kapaciteteve duke shmangur strukturat zbatuese paralele me qëllim reduktimin e njërive paralele të zbatimit të projektit (NjZP)

Indikatori : Ndhmë më e parashikueshme duke bërë të mundur reduktimin e masës së ndihmës që nuk lëvrohet brenda vitit fiskal për të cilin është planifikuar

Indikatori 8: Ndhma e pakushtëzuar – Te ekzistojë një progres i vazhdueshëm në kohë

Indikatori 9: Përdorimi i rregullave apo procedurave të përbashkëta – Rritja e fluksit të ndihmës që jepet në kontekstin e përjasjeve në bazë programi.

Indikatori 10: Përqindja e misioneve në terren dhe/ose puna analitike e vendit dhe shqyrtimet diagnostike të jenë të përbashkëta.

Indikatori 11: Kuadre të Orientuara drejt Rezultateve - Pakësimi i numrit të vendeve pa kuadre vlerësimi të performancës, që janë transparente dhe të monitorueshme

Indikatori 12: Llogaridhënia e Ndërsjellë - Të gjitha vendet partnere të kenë të miratuara raporte vlerësimi të ndërsjella.

Gjatë viteve 2006-2011, janë kryer 3 anketime/monitorime, nën mbikqyrjen e OECD, mbi progresin e arritur lidhur me angazhimet e marra nëpërmjet Deklaratës së Parisit dhe Axhendës së Akrës për Veprim. Në këtë kuadër, donatorët si dhe qeveritë e shteteve në zhvillim angazhohen që “të japin informacione aktuale, transparente dhe të plota për asistencën e huaj me qëllim që t’u mundësojnë autoriteteve partnere paraqitjen e raporteve të plota lidhur me efektivitetin e Ndhmës së Huaj.

Në Forumin e Katërt të Nivelit të Lartë për Efektivitetin e Ndhmës së Huaj në Busan, në vitin 2011, donatorët ndërmorën angazhimet e tyre më specifike duke rënë dakord që të zbatonin një standard të

përbashkët e transparent për botimin e informacionit të ndihmës së huaj sipas Sistemit të Raportimit të Kreditorëve të OECD-së dhe Nismës Ndërkombëtare të Transparencës së Ndihmës së Huaj. Çdo organizatë që miratoi Partneritetin e Busanit pritej të hartonte afatet e zbatimit deri në dhjetor 2012 dhe të synonte zbatimin e plotë të standardeve të përbashkëta deri në dhjetor 2015.

Partenriteti Global për Bashkëpunim Efektiv për Zhvillim

(Global Partnership for Effective Development Cooperation – GPEDC)

Korniza e Monitorimit të Partneritetit Global Bashkëpunim Efektiv për Zhvillim është themeluar në vitin 2012 me qëllim mbështetjen e përgjegjësisë ndërkombëtare, për të bërë përparim në zbatimin e angazhimeve të Busanit për bashkëpunim për zhvillim më efektiv.

Takimi i Nivelit të Lartë në Busan, vuri themelet për krijimin e një seti sekeltiv dhe relevant indikatorësh për të monitoruar progresin kundrejt angazhimeve të rëna dakord në Busan, krahas atyre të vendosura në Paris dhe në Accra (targetet e vitit 2015).

Procesi i monitorimit koordinohet nga një grup i përbashkët OECD-UNDP, duke ndjekur një përjasje sipas vendeve ku aplikohet. Deri tani është kryer një raund monitorimi për periudhën 2013-2014, si rezultat i të cilit është prodhuar Raporti i Progresit për takimin e Nivelit të Lartë të organizuar në Meksikë në vitin 2014.

Gjatë vitit 2016, po organizohet Raundi i Dytë i Monitorimit të Partneritetit Global 2015-2016, ku po merr pjese dhe Shqipëria. Raundi i Dytë i Monitorimit të Partneritetit Global mbështet llogaridhënien lidhur me përparimin drejt zbatimit të angazhimeve dhe veprimeve të rëna dakord në vitin 2011 në Busan, përmes një kuadri të miratuar monitorimi global. Në këtë raund monitorimi vihet theksi kryesisht në ndryshimin e sjelljes në përpjekjet për Zhvillim dhe Bashkëpunim me qëllim rritjen e kontributit në arritjen e rezultateve të përcaktuara në strategjitë e zhvillimit të vendeve në zhvillim.

Parimet e bashkëpunimit efektiv për zhvillim në kuadër të GPEDC janë si më poshtë:

- ✓ Pronësia e prioriteteve të zhvillimit nga vendet në zhvillim
- ✓ Fokus në rezultate
- ✓ Partenritet për zhvillim gjithëpërfshirës
- ✓ Transparenca dhe përgjegjshmëria

Këto parime janë rezultat i një sërë diskutimesh dhe angazhimesh ndërkombëtare ndër vite. Ato janë kryesisht një rishikim i parimeve të mëparshme të Deklaratës së Parisit dhe Axhendës së Akrës për Veprim.


Monitorimet e vazhdueshme në nivel global të efektivitetit të ndihmës së huaj, bazuar në parimet e përcaktuara, mund të konsiderohen si një instrument i jashtëm i cili mat në mënyrën më asnjëanëse efektivitetin e ndihmës së huaj në vendet në zhvillim dhe si i tillë ndihmon qeveritë e këtyre vendeve për të patur një pasqyrë më të qartë të financimeve të huaja.

2.4 Përbërja e ndihmës së huaj

Sipas Institucioneve Përfituese


Nga një analizë e detajuar e bazës së projekteve me financim të huaj, e cila mirëmbahet dhe përditësohet nga Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj me të dhëna të marra nga donatorët dhe ministritë e linjës rezulton se financimi i huaj në Shqipëri, sipas vlerës së financimit për projektet aktualisht në zbatim, është rreth 2.8 mlrd Euro dhe është përqëndruar kryesisht tek: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (78% ndaj totalit), e ndjekur nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (36%), Ministria e Financave (28%) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (12%).

Financimi në zbatim sipas institucioneve përfituese
Milionë Euro



Për periudhën 2016-2018, vërehet një rënie e ndjeshme e financimit të planifikuar (mbi 50%) në rreth 1.2 mlrd Euro, kryesisht për shkak të limiteve të huamarrjes si dhe përthithjes së ngadaltë të financimit aktualisht në zbatim. Fondet do të alokohen kryesisht në projekte të ujësjellës-kanalizimeve dhe transportit (MTI), sistemeve të përmirësimit të menaxhimit financiar (MF), transmetim elektrik (MEI) si dhe bujqësisë (MBZHRAU).

Financimi i planifikuar sipas institucioneve përfituese për periudhën 2016-2018 (Milion Euro)




Sipas sektorëve

Për sa i përket sektorëve, investimet në infrastrukturë rrugore si rrugë kombëtare dhe dytësore, energjia, kryesisht projekte që lidhen me ngjitjen e kapaciteteve dhe parapërgatitjen për projektin TAP të gazsjellësit, transmetimi elektrik dhe investimet në ujësjellës-kanalizime përbëjnë rreth 61% të financimit total që aktualisht shkon për projektet në zbatim. Një vlerë substanciale prej rreth 350 mln Euro shkon për sektorin e Financave Publike, ku projekti për Menaxhimin e Financave Publike, me vlerë prej 170 Milionë Euro, zë pjesën më të madhe dhe lidhet me mbështetjen buxhetore që Banka Botërore ka akorduar për pagesat e borxheve të Qeverisë ndaj kompanive private, më së shumti për projekte infrastrukture.


Më konkretisht, sektorët të cilët përfitojnë pjesën më të madhe të fondeve të angazhuara janë: transporti (30% të financimit total në zbatim), energjia (18% të financimit total në zbatim), furnizimi me ujë dhe kanalizimet (13% të financimit total në zbatim), dhe financat publike (13% të financimit total në zbatim) sipas grafikut më poshtë.

Financimi në zbatim sipas sektorëve Milionë Euro



Për periudhën 2016-2018, sektori i transportit (ku pjesën më të madhe e zë projekti i BB për reformën në sektorin e transportit), energjisë (ku pjesën më të madhe e zë projekti i përbashkët me Greqinë, IPA Crossborder, i Eficencës së Energjisë), dhe financave publike (ku përfshihet projekti i financuar me mbështetje buxhetore nga BE për përmirësimin e Menaxhimit të Financave Publike si dhe kredia e bute e BB për forcimin e sektorit financiar) vazhdojnë të marrin një financim relativisht më të lartë krahasuar me sektorët e tjerë. Por, duhet theksuar fakti se vërehet një zhvendosje e financimit të huaj dhe në sektorë të tjerë si ekonomia kryesisht me projekte që lidhen me zhvillimin e SME-ve, përfshirë dhe subvencionet drejt fermerëve, administrata publike kryesisht me projekte për rritjen e numrit dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit, turizmi, etj. sipas grafikut më poshtë.

Financimi i planifikuar për periudhën 2016-2018 sipas sektorëve Milionë Euro





Si përfundim, përqëndrimi relativisht i lartë i ndihmës së huaj në sektorët si transport, energji dhe financë publike do të vazhdojë të jetë i justifikuar edhe për disa vite. Megjithatë, do të ketë një tendencë të uljes së diferencave midis sektorëve. Disa prej sektorëve përfitojnë një nivel të lartë të ndihmës së huaj për shkak se kanë nevojë për ndihmë teknike të konsiderueshme përveç nevojës për investime. Gjithashtu, disa nga kreditë më të mëdha gjysëm tregtare, kryesisht për sektorin e transportit dhe energjitik, me kalimin e kohës do të shndërrohen në kredi plotësisht tregtare, duke


ndjekur tendencat e filluara me daljen e Shqipërisë nga statusi i një vendi me të ardhura të ulta si dhe dhe përdorimi i kredive të ofruara nga donatorët dypalësh.

Sipas llojit

Vihet re se në pjesën më të madhe të financimit të Partnerëve Ndërkombëtarë për projektet në zbatim e zënë **kreditë e zhvillimit (rreth 76% të financimit total)**, në projektet e infrastrukturës dhe energjetikës duke u përqëndruar kryesisht në 3-4 insitucione. Ndërsa grantet kanë një shpërndarje më të njëtrajtshme dhe më të balancuar midis institucioneve, sic shihet dhe nga grafiku më poshtë.

Në vitet në vijim, sic vihet re nga grafiket më poshtë, pjesa më e madhe e granteve do të përqëndrohet tek Ministria e Energjetikës, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës si dhe në projekte të cilët kanë shumë institucione si përfitues. Ndërsa pjesa përqindja më e lartë e kredive do të përqëndrohet tek Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financës si dhe në projekte me shumë përfitues. Vlen të përmendet fakti se projekte të tilla, ku përfitojnë disa institucione përnjëherë (projekte me shume përfitues), janë kthyer në trend për vitet që vijnë pasi ato ofrojnë financim për një gamë të gjërë insitucionesh nëpërmjet një projekti të vetëm. Pra mund të konsiderohen si një grumbullim i fondeve ku secili insitucion përfiton një pjesë por që ka një qëllim të përbashkët, psh. forcimin e kapaciteteve njerëzore në këto institucione.






Sipas donatorëve

Donatorët që japin kontributin më të madh duke mbuluar rreth 74% të vlerës së projekteve në vazhdim, janë Banka Botërore me një kontribut prej 17% të financimit total, Gjermania, Bashkimi European, Banka Islamike për Zhvillim, dhe FMN respektivisht me rreth 12% secila, dhe Italia me 10% të financimit total në zbatim. Grafiku më poshtë tregon në detaj vlerën e financiar nga secili donatorë për projektet që janë aktualisht në zbatim.

Financimi në zbatim sipas donatorëve (Milion Euro)




Për periudhën 2016-2018, vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të donatorëve. Më pak se gjysma e donatorëve planifikohet të financojnë me ndihmë të huaj. Donatorët si Banka Botërore, BE dhe Gjermania do të vazhdojnë të ofrojnë nivelin më të lartë të financimit. Përkatësisht Banka Botërore pritet të japë një kontribut prej rreth 47% të financimit total kryesisht në formën e kredive të buta, Bashkimi Evropian planifikon të ofrojë një kontribut grant prej rreth 38% të financimit tërë në formën e mbështetjes buxhetore (detajet rreth kësaj forme të re financimi shpjegohen në Kapitullin 5), dhe Gjermania një kontribut prej rreth 8% të financimit total të planifikuar, kryesisht në formën e kredive të buta, shoqëruar dhe me një komponent të vogël grant për asistencë teknike.

Grafiku më poshtë jep më në detaj financimin e planifikuar në vlera monetare (milion Euro) për vitet që vijnë sipas donatorëve.

Nga analiza e mësipërme, shihet qartë se për vitet në vijim 2016-2018, megjithëse vërehet një shpërndarje më e njëtrajtshme e NH në institucione dhe sektorë të ekonomisë, vlera e financimit të huaj dhe vetë numri i donatorëve reduktohet ndjeshëm. NH do të reduktohet në rreth 1.2 miliardë Euro nga 2.8 miliardë Euro aktualisht në zbatim.


Shkaku kryesor i kësaj rënie graduale të donacioneve të huaja, është kalimi i Shqipërisë nga një vend me të ardhura të ulta në një vend me të ardhura të mesme dhe të larta (Raporti i Bankës Botërore "Rritja e artë: Rikthimi i shkëlqimit të Evropës, 2012). Ky fakt ka bërë që Shqipëria mos të perceptohet më nga qeveritë e huaja donatore si 'vend në nevojë'. Si rrjedhojë, mjaft donatorë duke vlerësuar se e kanë arritur qëllimin e tyre për zhvillimin e një vendi si Shqipëria, kanë kthyer vëmendjen dhe financimet e tyre drejt vendeve, kryesisht të Botës së Tretë, të cilët cilësohen si vende me nivel mjaft të ulët të ardhurash e jetese.

Financimi i planifikuar sipas donatorëve për periudhën 2016-2018 (Milion Euro)



Një shkak tjetër i reduktimit të ndihmës së huaj, dhe kryesisht të komponentit të kredive të buta, është fakti se Shqipëria ka për synim uljen e borxhit publik dhe mbajtjen e tij në një nivel të lejueshëm sipas angazhimeve të ndërmarra dhe në marrëveshjen me FMN-në. Si rrjedhim, duke konsideruar axhendën e integritetit evropian, me qëllim që të arrihen standardet e BE-së, si dhe të arrihet angazhimi i qeverisë për uljen e borxhit nga nga 72% në vitin 2015 në 62% në vitin 2018, sipas marrëveshjes së bërë me FMN, është e nevojshme një rritje e vazhdueshme e komponentëve grant të ndihmës së huaj dhe ulje e komponentëve të kredive të buta, në vitet në vijim.

Stoku i Borxhit Publik / PBB (Sipas Marrëveshjes me FMN)



Burimi: Ministria e Financave


Për këtë shkak, vihet re se për vitet 2016-2018 raporti kredi-grant i ndihmës së huaj ndryshon ndjeshëm, nga 76% kredi-24% grant (financimi aktualisht në zbatim) shkon në 56% kredi-44% grant

(financimi i planifikuar). Pra kjo tregon qartë tendencën për të ulur komponentin e kredive dhe për të rritur atë të granteve.

2.5 Impakti i financimeve të huaja ne zhvillimin ekonomik të vendit

Që nga viti 2000, raporti i ndihmës së huaj me produktin e brendshëm bruto (PBB) ka pësuar rënie. Deri në vitin 2007, shkaku kryesor i kësaj rënieje nuk ka qënë ulja e nivelit të ndihmës së huaj, por rritja e PBB-së (e cila mesatarisht ka qënë në nivele rreth 6% që prej vitit 2000). Në vitet 2007-2008, raporti i ndihmës së huaj me PBB ishte rreth 3 %. Nga viti 2009 e më pas, ky raport filloi të ulej e të arrijë nivelet rreth 2.1%.

Ndihma e huaj si pjesë e PBB-së, 2000-2014 (%)



Burimi: Banka Botërore

Vlen të përmendet se të ardhurat nga burimet e jashtme, jo vetë nga donacionet e huaja, por dhe nga burime të tjera si remitancat, fitimet nga eksporti, dhe IHD, kanë përbërë burim të rëndësishëm të investimeve dhe konsumit ndër vite.


Për të kuptuar më qartë këtë konkluzion është me vënd që fillimisht të jepet një përkufizim i këtyre koncepteve, si më poshtë:

Remitancat: Sipas Organizates Nderkombetare per Migracionin, dergesat në para të emigranteve (remitancat), në kuptimin e gjere te fjales, jane transferta monetare qe emigrantët kryejne ne vendin e origjines. Pra, keto dergesa jane prurje financiare te lidhura me migracionin. Ne shumicen e rasteve, keto dergesa jane transferta personale ne cash nga nje emigrant tek te afermit e tij ne vendin e origjines. Ne pergjithesi, me termin remitanca nenkuptohen tre lloje te transfertave monetare ne vendet e origjines dhe gjenden te publikuara ne Vjetarin Statistikor te Bilancit te Pagesave te FMN. Keto jane jane: dergesat e punetoreve, kompensimet e punedhenesve dhe transfertat e migranteve.

Investimet e Huaja Direkte (IHD): Raporti Botëror i Investimeve i Kombeve të Bashkuara (UNCTAD, 1999) i përcakton IHD-të si “një investim që përfshin një marrëdhënie afatgjatë, që pasqyron një interes të qëndrueshëm dhe kontroll të një subjekti vendas në një ekonomi (investitor direkt i huaj ose sipërmarrje mëmë) në një sipërmarrje vendase në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit direkt të huaj (sipërmarrja IHD, sipërmarrja degë ose dega e huaj)”.

Eksportet: përfaqësojnë vlerën e të gjithë mallrave të tjera të tregut, të parashikuara për pjesën tjetër të botës. Ato përfshijnë vlerën e produkteve, shërbimeve, sigurimeve, transportit, udhëtimeve, honorareve, pagesave të licencës, si dhe shërbime të tjera, të tilla si komunikim, ndërtim, shërbime financiare, informacion, shërbime biznesi dhe shërbime qeveritare (Kola, 2014).

Ndihma e huaj, eksportet, remitancat dhe IHD, 1990-2007 (milion Euro)




Burimi: OECD/DAC (2007); Parashikimet më të mira të Qeverisë për 2006 dhe 2007 të marra nga baza e të dhënave të donatorëve; Banka e Shqipërisë (2007)

Niveli i remitancave dhe eksporteve janë rritur ndjeshëm që nga mesi i viteve 1990. Si rjedhim mund të thuhet se rëndësia relative e ndihmës së huaj përkundrejt të ardhurave të tjera nga burime të jashtme ka pësuar rënie. Pas vitit 2008, niveli i Ndihmës së Huaj vazhdoi të ishte në rënie por njëkohësisht, për shkak të krizës botërore, edhe niveli i PBB filloi të ulej. Poashtu kriza ndikoi dhe në nivelin i remitancave, IHD dhe eksporteve, të cilat poashtu pësuan ulje.

Në vitin 2007, raporti i IHD kundrejt PBB-në ishte 22%, e ndjekur nga remitancat me 10%, ndihma e huaj me 3%

Ne vitin 2014, raporti i IHD kundrejt PBB-në ishte 7%, e ndjekur nga remitancat me 4%, ndihma e huaj me 2%



Burimi: Banka Botërore

Kjo analizë tregon se në vitet e fundit, për shkak dhe të rënies së nivelit të PBB, remitancave dhe IHD, megjithëse përqindja e ndihmës së huaj NH kundrejt PBB është pothuaj e njëjtë, ndikimi real i saj në krahasim me faktorët e tjerë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit është rritur. Si rezultat, mund të pohohet se NH ka pothuaj të njëjtin ndikim që ka dhe IHD apo remitancat ne PBB.

Kapitulli i tretë

IMPAKTI I NDIHMËS SË HUAJ NË SEKTORËT KYÇ

Ky kapitull paraqet një analizë të ndihmës së huaj në tre prej sektorëve të ekonomisë si Biznesi dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, Transporti dhe Bujqësia, në vitet e kaluara. Analiza e kryer ka për qëllim matjen e impaktit që ka patur ndihma e haj në këto sektorë kryesisht nëpërmjet ilustrimit me disa projekteve madhore të financuara në secilin prej këtyre sektorëve.



3.1. Biznesi / ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)

Duke qenë se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ekonomisë së vendit, kanë përfituar ndihmë të konsiderueshme financiare të huaj ndër vite. Kjo ndihmë është dhënë kryesisht në formën e asistencës teknike, granteve për zhvillim, kredive të buta, ose garancive bankare për bizneset e vogla që kërkojnë të marrin kredi. Kjo ndihmë, në shumicën e rasteve, është kombinuar dhe me instrumenta të tjerë nëpërmjet të cilëve është ofruar financim i brendshëm në mbështetje të NVM-ve. Këto instrumente të financimit të huaj dhe të brendshëm kanë ndikuar pozitivisht në këtë sektor, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve në Shqipëri si dhe në rritjen e fitimeve të tyre.

Për më tepër, vlen për t'u theksuar se gjatë viteve të fundit klima e biznesit është përmirësuar ndjeshëm për shkak të reformave të thella të zbatuara nga qeveria, si dhe kanalizimin e fondeve të huaja drejt prioritetëve të qeverisë në këtë sektor. Reforma Tatimore është një pjesë thelbësore e politikës fiskale për të lehtësuar të bërit biznes në Shqipëri. Paralelisht me këtë reformë është zhvilluar dhe portali e-qeverisje me synim lehtësimin e shërbimeve për bizneset, si në aspektin rregullator dhe në futjen e shërbimeve online, në mënyrë që të kontribuojë drejtpërdrejtë në uljen e informalitetit. Pavarësisht nga këto arritje, ka sfida të cilat mbeten për t'u adresuar me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit. Sipas një analize të kryer në gusht të vitit 2016 nga Komisioni Evropian, lidhur me Vlerësimin e Indeksit të Politikave të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi disa nga sfidat kryesore që mbeten për t'u adresuar janë: përmirësimi i konkurrencës së ekonomisë në tërësi; rritja e shkallës së inovacionit dhe zhvillimit të teknologjisë për SME-të për të siguruar një rritje të shpejtë të këtij sektori; dhe zhdukja e informalitetit.



Ndihma e huaj ka luajtur një rol vendimtar në mbështetjen e NVM-ve në Shqipëri. Deri tani janë dhënë nga partnerët për zhvillim (donatorët) rreth 111 milionë euro (53.9 milionë Euro kredi të buta dhe 57.1 mln Euro grante) në këtë sektor për projekte të financuara kryesisht gjatë periudhës 2012-2015. Për projekte të reja dhe të planifikuara për periudhën 2016-2018, kjo ndihmë është rreth 50 milionë euro (35 milionë euro kredi të buta dhe 14 mln euro grante).

Dy grafikët më poshtë tregojnë donatorët kryesor sipas sektoreve dhe vlerën e projekteve të planifikuara. .



Burimi: DZHFNH

Asistenca e dhënë nga donatorët në mbështetje të NVM-ve ndahet në kryesisht në katër komponentë financiarë dhe jo-financiarë: Linjë kredie, fond garancie, asistencë teknike (AT) dhe subvencione direkte. Dy grafikët më poshtë paraqesin një pasqyrë të peshës që ka secili prej këtyre komponentëve në vlerën totale të financimit në vazhdim 2012-2015, si dhe për projektet e reja të planifikuara për periudhën 2016-2018.



Burimi: DZHFNH

Ndihma e huaj ka patur një ndikim të lartë në sektor gjatë viteve të kaluara. Disa nga projektet dhe programet madhore që janë financuar me fonde të huaja si dhe impakti i tyre në sektor jepet më poshtë:

Programi për zhvillimin e SME-ve [Linje kredie + Fond garancie] – Italia - 27.5 mln Euro.

Impakti i programit i ilustruar në shifra:

- 94 projekte nga SME-ve shqiptare, për një shumë prej 20,6 mln euro
- Thirrja II: janë marrë 65 aplikime nga të cilat do të kontraktohen 30-35 kontrata.

Akses drejt kapitalit për fermerët dhe agrobiznesin – USAID – 1.1 mln Euro (AT)

Impakti i programit i ilustruar në shifra:

- Kane përfituar 18 agrobiznese deri në Shtator 2014.
- Projekti ka ndihmuar krijimin e 2 produkteve të reja bankare që tashme operojnë në treg.
- Agrobizneset e asistuar kanë kryer \$3.6 Million investime të reja dhe kanë krijuar 61 vende të reja pune.

Malet drejt Tregjeve – Kredi nga IFAD – 7.1 mln Euro (bashkefinancim nga GoA 1.7 mln Euro)

- *Impakti i programit i ilustruar në shifra:*
- 48 % ne aksin Tirane-Durres, 12 % ne Lushnje, 5 % ne Kavaje, Fier, Vlore, Shkoder
- 88% e kredisë për përfitimin e të mirave dhe shërbimeve nga Italia, 12% për të mbuluar kostot lokale

Zhvillimi i Autoritetit të Kreditit/ Bujqesi (Development Credit Authority, DCA) – USAID – 12.2 mln Euro

Impakti i programit i ilustruar në shifra:

- Ka mbuluar me garanci mbi 200 kreditorë

Mbeshtetje për Bujqesine dhe Zhvillimin Rural – GIZ/IPARD-10.5 mln Euro (10 mln nga BE dhe 0.5 nga GIZ)

Impakti i programit i ilustruar në shifra:

- Thirrja I: janë firmosur 19 kontrata për të cilat kanë filluar edhe pagesat e para.
- Ngritje infrastrukture 4 mln Euro - Jane ndertuar 25 objekte infrastrukture rurale.
- Zhvillimi I tregut rural (3.1 mln Euro) - Jane mbeshtetur me skemen e granteve te vogla deri tani 501 fermere dhe 19 kredi marres (fermere) me garanci kredie

Projekti Mikrofinance - Kredi nga IDB – 3.7 mln Euro (0.2 mln grant)

Impakti i programit i ilustruar në shifra:

- Me skemen e mikrofinancimit pritët: Perfitimi direkt I rreth 2500 klienteve, duke kontribuar ne zhvillimin e 5550 mikro-ndermarrjeve të reja, krijimi I punësimit të drejtpërdrejtë për afro 6000 njerëz, dhe në mënyrë të tërthortë do të ndikojnë në rreth 10,000 përfitues

Financime të brendshme

Përvec financimeve të huaja, sektori është mbështetur dhe vazhdon të mbështetet dhe nga fondet e shtetit me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Mekanizmat në mbeshtetje të NVM-ve nga Buxheti i Shtetit rradhiten si më poshtë:

- **AIDA**
 - Fondi i Konkurrueshmërisë - 68 mln Leke per vitet 2013-2015. Jep grante SME-ve deri ne 1.4 mln leke. Mbulon deri ne 70% te kostove te angazhuara
 - Fondi i Ekonomisë creative - – 40 mln Leke per vitet 2013-2016. Jep grante SME-ve deri ne 0.5 mln leke. Mbulon deri ne 60-80% te kostove te angazhuara
 - Fondi i Inovacionit - Fondi i Inovacionit – 14 mln Leke per vitet 2011-2014. Jep grante SME-ve deri ne 0.4 mln leke. Mbulon deri ne 30-50% te kostove te anagazhuara
 - Fondi ne mbeshtetje te grave sipërmarrese - – 26.5 mln Leke per vitet 2014-2017. Mbulon 50% te interesit te kredive (per 4 vite) te marra nga kompanite qe drejtohen nga gra. Kredi jo me te medha se 1 mln leke.
 - Fondi per bizneset e reja - – 25 mln Leke per vitet 2014-2017. Jep grante SME-ve 1-2

vjecare deri ne 0.3 mln leke. Mbulon deri ne 70% te kostove te angazhuara

- **AZHBR** - Financim i Fermerëve nga Skema Kombëtare
- **MADA** - Bashkefinancim i Qeverise Shqiptare ne programet e meposhtme:
 - “Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Zonave Rurale Malore”- kosto totale 20 mln Euro (OFID, IFAD, GoA) – 3.6 mln Euro
 - “Malet drejt tregjeve”– kosto totale 7.1 mln Euro (IFAD, GoA) – 1.7 mln Euro
- **FAF** – Skemë financimi e cila përfshin:
 - Kredi për bujqësi dhe mikro ferma bujqësore
 - Kredi për agro-industri
 - Kredi për agroturizëm dhe turizëm familjar
 - Kredi për blegtori
 - Kredi jo bujqësore për zonat malore, rurale, urbane dhe peri-urbane
 - Kredi sindikate në bashkëpunim me banka tregëtare, subvencione qeveritare donatorë të huaj, etj.
 - Kredi për burime natyrore (miniera, hidrocentrale)

Kombinimi i financimeve të huaja me ato të brendshme lejon ngritjen e një portofoli me një vlerë substanciale në mbështetje të këtij sektori. Pra është e rëndësishme që Ndihma e Huaj të jetë në një linjë me prioritetet e qeverisë të përcaktuara për këtë sektor në mënyrë që të jetë më efektive dhe të ketë impact më të ndjeshëm.

Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2013-2020 përcaktohen si më poshtë drejtimit kryesore ku duhet orientuar financimi në vitet në vijim me synim zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe inovacionit për NVM-të. Marrja e masave për adresimin e mungesës së kapaciteteve, mungesës së njohurive (know-how), ngritjen e infrastrukturës së nevojshme dhe përmirësimin e aksesit në financim.

Nxitja e kulturës dhe edukimit sipërmarrës. Ekziston një lidhje e fortë midis burimeve njerëzore dhe inovacionit. Si rrjedhim është e nevojshme përgatitja e kurrikulave të reja në nivele të ndryshme të edukimit, si dhe përgatitja një seri programesh për promovimin e kulturës sipërmarrëse nëpërmjet trajnimit dhe edukimit.

Përmirësimi i aksesit në financim për NVM-të. Përmirësimi i aksesit në financim është thelbësor për të arritur zhvillim të qëndrueshëm të sektorit. Si rrjedhim është e domosdoshme që përmirësimi i skemave të garancisë së kreditit të vihet në fokus për vitet në vijim.

Zhvillimi i infrastrukturës së NVM-ve. Ekziston nevoja për ngritjen e inkubatorëve për kompanitë e reja. Këto inkubatorë janë të rëndësishëm pasi ofrojnë hapësirat e nevojshme fizike si dhe shërbime në mbështetje të zhvillimit të biznesit për kompanitë e reja.


Së fundmi, rekomandohet që qeveria si dhe partnerët për zhvillim që operojnë në këtë sektor të përqëndrojnë veprimtarinë e tyre në identifikimin e mekanizmave të rinj financiar dhe jo financiar në mbështetje të NVM-ve, për rritjen e aksesit të sipërmarrësve ndaj burimeve financiare, përmes:

- Politikave fiskale lehtësuese dhe subvencioneve të institucioneve shtetërore ndaj skemave të garancive
- Rishikimit të kuadrit institucional
- Marrjes së iniciativave të përbashkëta publike-private, me qëllim këshillimin e Sipërmarrësve dhe zvogëlimin e kohës së nevojshme për marrjen e kredisë
- Rishikimit të kushteve (lehtësimi) për përfitimin ndaj linjave të kredisë në kuadër të programeve në mbështetje të NVM-ve.


3.2. Transporti

Financimet e huaja ndër vite janë përqëndruar kryesisht në sektorin e transportit. Ky sektor ka përfituar dhe vazhdon të përfitojë një vlerë të konsiderueshme të financimeve të huaja. Kjo ka ardhur kryesisht dhe për faktin se transporti ka përbërë gjithmonë një prioritet kyc të qeverive në pushtet, për vetë faktin se ky sektor ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin e vëndit.


Angazhimi total për këtë sektor, për projekte aktualisht në zbatim, arrin vlerën prej 1.346 Miliard Euro. Nder projektet ne vazhdim 112 milion Euro jane grant (8% e totalit) dhe 1.224 miliard Euro (92% e totalit) janë kredi.




Por duhet theksuar fakti se megjithëse ky sektor përfiton pjesën më të madhe të financimit niveli i disbursimit, sic shihet dhe në grafikun më poshtë, ka qënë dhe vazhdon të jetë mjaft i ulët (rreth 57% në total), gjë që përbën një prej problematikave kryesore. Me konkretisht, deri ne fund te vitit 2015, ishin disbursuar vetëm 49% to grantit total dhe 58% të kredisë totale për sektorin. Po të merret parasysh se këto projekte, sipas planifikimit fillestar duhet të ishin tashme ne vitin e fundit ose të parafundit të mbylljes së tyre, mund të arrihet mjaft lehtë në konkluzionin se performanca e këtij sektori nuk ka qënë mjaft efikase. Ky fakt do të shqyrtohet dhe më poshtë në kapitullin 4.



Donatorët kryesorë në sektor, sic shihet dhe në grafikun më poshtë, janë Banka Islamike për Zhvillim (IDB) me një financim prej rreth 354 mln Euro, Banka Botërore me 168 mln Euro, BRD me 167 mln Euro, dhe Banka Evropiane për Investime (EIB) me 156 mln Euro.



Grafiku më poshtë tregon vlerën e projekteve në vazhdim krahas atyre të planifikuara deri më tani. Për vitet në vijim, ky sektor pritet të ketë një rënie të financimit të huaj për shkak të zhvendosjes së ndihmës së huaj drejt prioriteteve të tjera. Megjithatë, duke qënë se transporti përbën një sektor kyc në ekonominë shqiptare, donatorët do të vazhdojnë ta mbështesin me fonde. Për arsye se ky sektor ka patur një performancë relativisht të ulët në përthithjen e fondeve, po bëhen përpjekje që në vitet që vijnë të gjenden mënyra alternative të financimit të huaj, duke mbajtur parasysh dhe angazhimet e vendit tonë për të mbajtur nivelin e borxhit në një nivel sa më të ulët. Si rezultat, pritet që financimi i planifikuar prej 24 Milion Euro, nga BE (IPA 2016), për sektorin e transportit të jepet në formën e mbështetjes buxhetore (e cila përshkruhet në detaj në Kapitullin 5).



Në këtë mënyrë, institucionetpërfituese të këtij fondi kanë përgjegjësinë për të arritur disa targete të vendosur paraprakisht në mënyrë që të mundësohet disbursimi i parave. BE ka vënë si parakusht përgatitjen e Masterplanit të Transportit në mënyrë që të mundësohet mbështetja buxhetore sektoriale në vitin 2016, e të zbatohet në vitin 2017/2018. Buxheti i alokuar në Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) për transportin është relativisht i vogël. Në këto kushte, kjo mbështetje planifikohet të jetë kryesisht e fokusuar tek mirëmbajtja e infrastrukturës aktuale. Mbështetja pritët të jetë në një linjë edhe me asistencën e dhënë nga Banka Botërore, që do të jepet po në të njëjtën mënyrë, pra si mbështetje buxhetore (WB Country Partnership Framework for Albania 2015-2019).

Një tjetër alternativë financimi, e propozuar dhe nga BE, për mbështetjen e sektorit të transportit është financimi nëpërmjet instrumentit WBIF i cili përveç studimeve mendohet të financojë edhe investime konkrete në të ardhmen, që bazohen kryesisht në frymën e propozimit të projekteve të përbashkëta midis vendeve të rajonit me qëllim nxitjen e frymës së bashkëpunimit dhe zbatimin e projekteve me impakt më të madh në rajon.

3.3 Bujqësia

Bujqësia është një ndër sektorët me numrin më të madh të të punësuarve në vend me rreth 40% (Tremujori III 2015, INSTAT), si dhe një ndër kontribuesit më të rëndësishëm në prodhimin e brendshëm bruto me rreth 20% (Banka e Shqipërisë). Për këtë shkak, me të drejtë ky sektor shihet si sektor strategjik dhe i një rëndësie të veçantë për një zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë. Bujqësia ka një potencial të padiskutueshëm për t'u integruar, e mund të kthehet në një ndër motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të zonave rurale dhe të vendit në përgjithësi. Kjo mund të arrihet duke investuar në potencialin vendas me qëllim rritjen e produktivitetit dhe konkurueshmërisë së këtij sektori.


Financimi i Brendshëm

Sipas buxhetit të brendshëm, është alokuar për subvencionet në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, një financim prej rreth 12.9 mln Euro për vitin 2015, dhe është parashikuar një financim prej rreth 11 mln Euro për vitin 2016. Këto fonde menaxhohen nga “Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural” (AZHBR) në funksion të mbështetjes së fermerëve në formën e investime - rreth 70% e financimit - dhe të asistencës teknike për përgatitjen e studimeve dhe analizave - rreth 30% të financimit (Ministria e Financave).

Financimi i Huaj

Totali i fondeve të angazhuara për projektet në vazhdim me financim të huaj është rreth 146 milionë Euro (46 milionë Euro kredi dhe 100 milionë Euro grant).

Lloji i financimit Grant vs Kredi



Partnerët më të rëndësishëm janë: Bashkimi Evropian (67 milionë Euro), Banka Botërore (36 milionë Euro), Gjermania (13.1 milionë Euro), Italia (11 milionë Euro), dhe Danimarka (10.6 milionë Euro).

Nën-sektori i ujitjes dhe kullimit dhe ai i konkurrueshmërisë, zënë peshën kryesore të financimit të huaj me një total financimi prej rreth 80 milionë Euro të financuara kryesisht nga BE dhe BB.

Në nën-sektorin e konkurrueshmërisë dhe agrobiznesit, pjesa më e madhe e skemës financohet nga fonde të donatorëve me bashkëfinancim nga AZHBR-në. Kontributin më të rëndësishëm e jep Gjermania dhe Danimarka me grantin prej 13,7 milionë Euro, nëpërmjet bashkëfinancimit të programit “Nxitja e Konkurrueshmërisë në Zonat Rurale”.

Burimi: Databaza e donatorëve, Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2016.

Ndër projektet kryesore aktualisht në zbatim, të cilat pritet të kenë ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e sektorit mund të vecohen si më poshtë:

Banka Botërore - Burimet Ujore dhe Ujitja– 36 Milion Euro (2014-2019)

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të transmetimit të ujit nëpërmjet rehabilitimit të rezervuareve dhe impjanteve të ujitjes dhe kullimit
- Asistencë teknike për rritjen e kapaciteteve të punëtorëve në zonat që prek projekti

IPA 2012 - Krijimi I Fondit të garancisë për kredite rurale, 5 Milion Euro (2014-2017)

- Ngritja e strukture institucionale për të siguruar funksionimin dhe përdorimin e Fondit të garancise, duke përfshirë edhe kuadrin ligjor.
- Ngritja e Fondit të Garancise për kredite Rurale dhe e sistemit operacional funksional për të siguruar Bankat që japin kredi ndaj fermerëve.
- Lehtësimi i aksesit në marrjen e kredive rurale dhe rritja e numrit të kredive të dhena fermerëve.

IPA 2013, Mbështetje për Modernizimin e Sektorit të Blegtorisë, 1.8 milionë Euro (2014-2019).

- Ky projekt ka për qëllim rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe eficiencës së prodhimit blegtoral në Shqipëri nëpërmjet zbatimit të politikave dhe praktikave të duhura racore. Projekti pritet të përfundojë në janar 2017.

Gjermania / GiZ dhe Danimarka Promovimi i Konkurrencës në zonën rurale, 23.7 Milion Euro – GiZ - 13.1 Milion euro dhe Danimarka 10.6 Milion Euro (2014-2017)

- Rritja e investimeve dhe ndihma për të përdorur më mirë mundësitë e financimit.
- Promovimi i veprimtarisë sipërmarrëse dhe ndihma për të lidhur këtë aktivitet me ngushtë me kërkesat e tregut .
- Heqja e pengesave ekzistuese brenda zinxhirëve të vlerës së shtuar.
- Përmirësimi i klimës së biznesit në nivelin mesatar duke krijuar një mjedis më të përshtatshëm për aktivitetin ekonomik.

Itali, Projekt pilot për ngritjen e një sistemi të sigurimit subvencionuar në bujqësi – 2 Milion Euro (2013-2016)

- Realizimi i një piloti për dhënien e subvencioneve në masën 80% fermerëve ndaj dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore (breshëri)
- Asistencë teknike për transferimin e know-how në stafin përkatës

Itali, Projekt ngritjen e kapaciteteve të AZHBR-së si institucioni që kryen pagesat e subvencioneve – 5 Milion Euro (2013-2017)

- Asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve të stafit përkatës
- Fuqizimin e sistemeve të kontrollit të AZHBR-së

Databaza e donatorëve, Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, 2016

Për vitet 2016-2020, financimi i huaj i planifikuar deri tani arrin në vlerën rreth 23.7 Milion Euro që mbulohet kryesisht nga BE me rreth një financim rreth 21.7 Milion Euro dhe 2 Milion Euro nga Gjermania.

Projektet që pritet të fillojnë gjatë këtyre viteve janë si më poshtë:

Skema e granteve IPARD (komponent i IPA 2016), 13 Milion Euro (2017-2020).

- Skema e granteve do të mbështesë fermerët për investime në fermat bujqësore, për përpunimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, diversifikimin e fermave dhe në asistencë teknike.

IPA 2016, Asistencë Teknike për Nën-sektorin e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit - 8.7 Milion Euro (2017-2020).

- Mbështetje e nën-sektorit të sigurisë ushqimore dhe atij të peshkimit me asistencë teknike për përmirësimin e kontrolleve ushqimore dhe fuqizimin e sektorit të peshkimit.


Gjermania / GIZ, Projekti Rajonal për Ujitjen dhe Kullimin - 2 Milion Euro (2016-2018).

- Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve me qëllim menaxhimin më të mirë të rrezikut përsa i perket përmbytjeve dhe thatësirave.
- Shqipëria do të jetë një nga vëndet partnere / përfituese në këtë projekt ku do të marrin pjesë dhe Maqedonia me Malin e Zi.

Databaza e donatorëve, Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, 2016

Nën-sektorët më të rëndësishëm që mbështeten aktualisht me asistencë të huaj jepen nëpërmjet grafikut të mëposhtëm:

Nën sektorët



Ujitja dhe kullimi dhe rritja e konkurrueshmërisë zënë peshën kryesore me një total financimi prej rreth 63% të totalit.

Mbështetja Financiare aktuale nga Sektori Bankar dhe Investimet e Huaja Private

Eksperiencat e deritanishme referojnë një numër të konsiderueshëm rastesh ku projekte zhvillimi apo kërkesa për kapital qarkullues nga ana e fermerëve të orientuara drejt sektorit bankar, të kenë rezultuar të pasuksesshme. Momentalisht sektori bankar e mbështet bujqësinë me vetëm rreth 2,4% të vlerës totale të financimit, ndërkohë që Investimet e Huaja Direkte (IHD) në këtë sektor janë më pak se 1%. Kjo do të thotë se sektori i bujqësisë realisht operon nën potencial (Banka e Shqipërisë, 2015).

Disa nga shkaqet e kësaj gjëndje mund të përfshijnë:

- Pamjaftueshmëri të kolateralit;
- Norma të larta interesi, si rrjedhojë e riskut të lartë;
- Kosto të larta administrative të menaxhimit të portofoleve;
- Akses të limituar në kreditim, në raport me nevojat;
- Perceptim i një risku të lartë si pasojë e mungesës së historikut apo kredibilitetit bankar

Në këtë kontekst, duke marrë parasysh vështirësitë e financimit si dhe tipologjinë e riskut që ky sektor paraqet, nevojitet një mekanizëm i qartë nxitës që do të promovojë kushte lehtësuese ndërmjet fermerit, sistemit bankar dhe mekanizmave të tjerë të ndihmës shtetërore. Ky mekanizëm partneriteti ka për qëllim integrimin e fondeve të përbashkëta banka-fermerë-shtet, përmes ndarjes së riskut dhe transferimit të njohurive.

Mekanizmi për nxitjen e kapitalit financiar

Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kanë propozuar krijimin e Fondit Kombëtar të Garancisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, si një nismë e përbashkët solidariteti, në mbështetje të nxitjes së kreditimit me qëllim krijimin e një sistemi unik, afatgjatë dhe të qëndrueshëm, që do të inkurajojë e rrisë ndjeshëm investimet private në bujqësi. Përmes konceptit të këtij Fondi synohet të aktivizohet një kapital privat investimesh private prej 180-300 milion Euro për 3 vitet në vazhdim. Ky Fond do të shërbejë si ndërmjetësues duke rritur ofertën e

kreditimit nga ana e Bankave, por edhe duke ndërgjegjësuar/përgatitur fermerët për projekte zhvillimi e të komercializueshëm.

Bashkëpjesmarrja në këtë Fond është si vijon: qeveria 20%, BERZH 40% dhe Bankat e Nivelit të Dytë 40%. Për vitin 2016, pjesëmarrja e qeverisë në Fond është 10 milion Eur, me anë të të cilave do të nxiten investime prej më shumë se 50 milion Eur (Melohina, 2016).

Fondi Kombëtar i Garancisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural mundëson ofrimin e garancive në trajtën e kolateralit për të nxitur kreditimin nga ana e sektorit bankar për atë grup fermerësh apo sipërmarrjesh bujqësore të cilat nuk kanë akses të lehtë në kredidhënie, për shkak të pamjaftueshmërisë së kolateralit ose pamundësisë për të përballuar interesat tepër të larta me të cilat Bankat operojnë momentalisht.

Reformat shoqëruese për nxitjen e Investimeve private në Bujqësi

Ky mekanizëm vjen si pjesë e Reformës për Menaxhimin Rajonal e cila ka në qendër mbështetjen e palëve dhe partnerëve kryesorë të zhvillimit të qyteteve, fshatrave dhe rajoneve, ndër të cilat përfshihen sipërmarrjet e agrobiznesit, dhe cluster-at sektorialë.

Paralelisht, Qeveria është duke thjeshtëzuar edhe shërbimet e integruara për fermerët: përmes Agjensisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), e cila do të shërbejë si Agjenti Financiar për projektet e fermerëve, duke siguruar zhvillimin, mbështetjen financiare si dhe zbatimin e suksesshëm të tyre, për llogari të çdo fermeri ose çdo sipërmarrjeje që ka nevojë të mbështetet për tu zhvilluar nga ky Fond (Peleshi, 2014).

Për këtë qëllim, thjeshtëzohen dhe qartësohen përfundimisht shërbimet publike ndaj fermerit duke prezantuar konceptin e Sportelit Unik (Banka Botërore, 2015) me një gamë të shumëllojshme formash të mbështetjes financiare si subvencionet, grantet për investime, kreditimi për investimet dhe projekte të sektorit, ndërmjetësimi për financim si dhe mbështetjes teknike për shkrim projektesh etj.

Mbështetja me Asistencë Teknike nga BERZH për Bankat dhe Qeverinë

Në përfundim, BERZH e ka filluar tashmë punën në asistencën e drejtpërdrejtë teknike ndaj Bankave të nivelit të dytë, për të parapërgatitur Departamentet e nevojshëm pranë këtyre bankave, në shërbim të nxitjes së kreditimit për fermerët.

Po ashtu Qeveria përmes Sportelit Unik është duke përgatitur stafin e nevojshëm në bashkëpunim edhe me Universitetin Bujqësor të Kamzës, dhe institucione të tjera, për të ndihmuar fermerët për përgatitjen e projekteve komerciale, bazuar edhe në Strategjinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural si dhe Rajonalizimin e Prodhimeve Bujqësore, të miratuara tashmë nga Ministria e Zhvillimit Bujqësor Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU, 2016).

Kapitulli i katërt

ANALIZA E REZULTATEVE: EFEKTIVITETI I NDIHMËS SË HUAJ

Ky kapitull paraqet rezultatet nga analiza e të dhënave parësore të mbledhura nga pyetsorët, nga intervistat e strukturuar, si dhe paraqet vërtetimin e hipotezave të studimit. Kapitulli mbyllet me një analizë të detajuar të të dhënave dytësore të mbledhura kryesisht nga databaza e ndihmës së huaj, e cila përditësohet dhe mirëmbahet nga DZHFNH.

4.1. Rezultatet nga analiza e të dhënave parësore


Në këtë seksion, të dhënat e mbledhura nga pyetsorët që janë përdorur për matjen e performancës së institucioneve përfituese të NH dhe që janë përdorur për të konkluduar në lidhje me objektivat e studimit. Në pjesën e parë diskutohen të dhënat gjysmë të strukturuar të 212 projekteve të marrë në shqyrtim, dhe që janë aktualisht në zbatim në Shqipëri. Ndërsa në pjesën e dytë, paraqitet analiza e pyetjeve kërkimore dhe vërtetimi apo hedhja poshtë e hipotezave të ngritura.

Të dhënat u përpunuan nëpërmjet programit SPSS (**Paketa Statistikore për Shkencat Sociale**) version 15.0 . Nëpërmjet këtij programi u krye analiza përshkruese e të dhënave dhe testimi i hipotezave. Studiues të ndryshëm e cilësojnë si programin SPSS më të përshatshëm duke marrë parasysh natyrën e të dhënave si dhe analizat që do të realizohen. Të dhënat që do të përpunohen janë kryesisht kategorike, paketa e zgjedhur SPSS konsiderohet ideale për përdorim në përpunimin e të dhënave dhe analizën e tyre. SPSS ka aftësi të mëdha dhe fleksibilitetet në analizën e të dhënave dhe gjenerimin të një gamë të pakufizuar të rezultateve të thjeshta dhe të sofistikuara statistikore, duke përfshirë tabelat e thjeshta të shpërndarjes si frekuencat, grafikët, përqindje etj. Paketa ka kapacitetet ekzekutimi të analizave shkencore të tilla si: analiza e variancës (Anova), testet statistikore chi - katror, analiza multivariate etj.

Nga analiza e kryer rezulton se dy institucionet që kanë përfituar pjesën më të madhe të projekteve me ndihmë të huaj, nga 212 projektet (pyetsorët) e marrë në shqyrtim janë ministria e Transportit e cila ka në zbatim 20% të projekteve dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit me 17% të projekteve. Ky rezultat përkon dhe me rezultatin e arritur nga analiza e të dhënave dytësore (e databazës së projekteve me financim të huaj) të paraqitur në seksionin 4.3 më poshtë.

Tabela më poshtë tregon numrin e projekteve të marrë në shqyrtim për cdo institucion të analizuar për qëllimet e këtij studimi.

Institucioni Perfitues	Frekuenca	Përqindja
AZHBR	2	1%
Fondi shqiptar I Zhvillimit	35	17%
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	15	7%
Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	26	12%
Ministria Drejtesise	2	1%
Ministria e Kultures	10	5%
Ministria e Mireqenjes Sociale dhe Rinise	20	9%
Ministria e Mjedisit	17	8%
Ministria e Puneve te Brendeshme	8	4%
Ministria e Shendetesise	11	5%
Ministria e Trasportit dhe Infrastruktures	43	20%
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	4	2%
Ministria e Zhvillimit Urban	5	2%
Ministria Financave	12	6%
Ministria Mbrojtjes	2	1%
Total	212	100%



Sic mund te shihet në figurën rreth 49% e te projekteve që kanë përfituar ndihme të huaj jane të fokusuar në asistence teknike dhe 46% e projekteve janë të fokusuar në investime në ngritje infarstukure



Analiza e projekteve sipas sektorit te ekonomise jepet ne tabelen ne vazhdim.

1.2 Projekti i perket sektorit konomik

	Frekuenca	Përqindja
1. Finance	9	4%
2. Bujqesi	14	7%
3. Arsim	10	5%
4. Shendetsi	13	6%
5. Social- Kulturor	28	13%
6.Zhv. Ekonomik	46	22%
7.Transport	50	24%
8. Ujesjelles-Kanalizime	19	9%
9. Mjedis	18	8%
10.Sigurise/mbrojtjes/policimit	5	2%
Total	212	100.0


Nga të dhënat e mësipërme shihet se sektori që ka përfituar me shumë ndihmë të huaj ka qënë sektori i Transportit me afërsisht 24% të projekteve. Ndërsa sektori që ka përftuar më pak ka qene sektori i mbrojtjes dhe sigurisë me afërsisht 2 % të 212 projekteve të marra në shqyrtim që kane perfituar ndihme te huaj.

Në lidhje me kohezgjatjen e projekteve të analizuara, grafiku me poshte tregon se 43% e projekteve që kane përfituar ndihme të huaj kane nje kohezgjatje prej 2-3 vjet, 40% e tyre nje kohezgjatje pre 3-5 vjet dhe 17% e tyre kohëzgjatje prej 5-7 vjet. Pra shumica e projekteve kanë një jetëgjatësi të planifikuar prej 2-5 vjetësh, pavarësisht se për shkak të arsyeve të ndryshme shumë herë ka vonesa e si ne zbatimin e projektit. Ne figurat me poshte jepet te dhena per projektet sipas kohe zgjatjes dhe sa perqind e tyre jane realizuar brenda kohes se parashikuar.




Nga të dhenat e grafikut të mësipërm vihet re se 52% e projekteve të shqyrtuar që kanë marrë ndihmë të huaj po zbatohen apo janë zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar ndërsa 48% e tyre e kanë tejkaluar apo pritet ta tejkalojnë kohëzgjatjen e planifikuar.

1.5. Projekti menaxhohet nga:




Grafiku tregon se vetëm 69% e projekteve menaxhohen nga institucioni përfitues, ndërsa pjesa tjetër prej 31% menaxhohet nga donatori në mënyrë të centralizuar, gjë që shpesh herë bëhet shkak për humbjen e kontrollit nga institucioni përfitues

1.6. Ekziston një plan për zbatimin e projektit i ndarë në aktivitete konkrete të parashikuara në kohë?




Pyetjes “A ekziston një plan zbatimi i projektit i ndarë në aktivitete konkrete, të parashikuara në kohë?”, rreth, 74% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht. Kjo tregon se një përqindje shumë e ulët e projekteve me financim të huaj kanë një plan të qartë zbatimi i cili i ndihmon në zbatimin efikas dhe në kohë.

1.7 Përfshihet financimi i projektit në PBA?




Pyetjes nëse financimi i huaj është përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), vetëm 46% e të anketuarve i janë përgjigjur pozitivisht sic shihet në grafikun më poshtë. Kjo përforcon faktin se një pjesë e konsiderueshme e financimit të huaj reflektohet në buxhet.


2.1 Ka patur ristrukturim/zgjatje afati të projektit gjatë zbatimit të tij?




Në grafik tregohet se rreth 39% e të anketuarit janë përgjigjur se e projekteve të marra në shqyrtim janë ristrukturuar apo kanë patur ndonjë zgjatje të afatit gjatë zbatimit, për arsye të ndryshme, kryesisht vonesa e problematika të hasura.



Burimet materiale e njerëzore janë mjaft të rëndësishme për zbatimin në kohë të projekteve. Pyetjes nëse kanë qënë këto burime të mjaftueshme, të anketuarit i janë përgjigjur se për rreth 36% e projekteve të marra në shqyrtim këto burime kanë qënë pak ose aspak të mjaftueshme. Kjo do të thotë se ky ka përbërë dhe një shkak kyc në moszbatimin në kohë të projekteve si dhe në mospërthithjen e fondeve në nivelin e duhur.



Të anketuarit janë përgjigjur se 28% e projekteve kanë hasur problematika që lidhen me shpronësimet, sigurimin e lejeve të ndërtimit kryesisht në fillim por dhe gjatë zbatimit të projektit, gjë që ka ndikuar në zgjatjen e zbatimit të projektit në kohë, dhe si rrjedhim në përthithjen e fondeve të huaja.




Pyetjes nëse kanë hasur mungesa ligjore apo probleme me legjislacionin në fuqi gjatë zbatimit të projektit, të anketuarit anë pohuar se 13% e projekteve kanë hasur problematika të tilla ligjore që kanë cuar në ngadalsimin e zbatimit të projektit




Të anketuarit kanë theksuar se 28% e projekteve të marra në shqyrtim kanë hasur problematika apo vonesa që lidhen me procesin e prokurimit

2.6. Keni hasur vonesa ne disbursimin e financimit nga donatori?




Pyetjes nëse anë hasur vonesa në disbursimin e fondeve nga donatori, të anketuarit iu përgjigjën se 19% e projekteve në zbatim kanë hasur vonesa për shkak të disbursimit jo në khë të transheve nga ana e donatorit, rysisht për shkak të procedurave të ndërlikuara e burreokratike që ata kanë

2.7. Keni patur vonesa ne hapjen e llogarive




Pyetjes për vonesat në hapjen e llogarive nga Ministria e Financave, në bankat e nivelit të dytë, ku dhe kryhet derdhja e fondeve të huaja nga donatori, të anketuarit janë përgjigjur që 8% e projekteve kanë hasur të tilla vonesa.

2.8. Keni patur vonesa ne moskryerje ne kohe e pagesave ne bankat e nivelit te dyte?




Rreth 13% e projekteve kanë hasur vonesa në kryerjen e pagesave në këto banka.

2.9. Eshte planifikuar dhe rimbursuar TVSH-ja ne kohe?




Pyetja në lidhje me rimbursimin e TVSH-së. Që sipas ligjit për projektet me financim të huaj, paguhet fillimisht nga donatori e më pas duhet rimbursuar nga shteti shqiptar. Për këtë është e nevojshme që të planifikohet financimi i saj për çdo projekt (që ka tVSH) në buxhetin e shtetit. Të anketuarit u përgjigjën se TVSH-ja është planifikuar në PBA vetëm për 58% të projekteve të marra në shqyrtim.

2.10. Ka patur vonesa ne projektimin e projektit?




Pyetjes nëse janë hasur vonesa në fazën fillestare të projektimit të projektit, të anketuarit I janë përgjigjur se 31% e projekteve anë hasur vonesa të tilla, që lidhen kryesisht me mungesën e kapaciteteve projektuese në institucionet përfituese.

2.11. Ka patur shkurtime buxheti




Të anketuarit referuan nëpërmjet pyetsorëve se 13% e projekteve kanë pësuar shkurtime të buxhetit dhe 7% e tyre ka hasur ndryshime të destinacionit të financimit gjatë zbatimit të projektit. Këto ndryshime kanë ndodhur për arsye të ndryshme që lidhen kryesisht me ristrukturime të projektit, planifikim jo i mirë i aktiviteteve në fazën fillestare, ose performancë e dobët e institucionit përfitues dhe zbatues.

2.12 Ka patur ndryshim te destinacionit te financimit gjate zbatimit te projektit?




3.1. Projekti ka patur/ pritet të ketë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm në sektorin ku është zbatuar?




Të anketuarit kanë shprehur nëpërmjet pyetsorëve, se 89% e projekteve kanë patur apo pritet të kenë impakt të ndjeshëm në sektorin ku po zbatohen.

3.2. Projekti ka ndikuar/pritet të ndikojë në rritjen e të ardhurave të sektorit perkates.




Të anketuarit janë përgjigjur se 49% e projekteve kanë ndikuar apo pritet të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të sektorit përkatës dhe se 76% e tyre pritet të krijojnë vende të reja pune.

3.3 Projekti ka krijuar / pritet të krijojë vende të reja pune




3.4. Projekti ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore.




Të anketuarit janë përgjigjur se 67% e projekteve, kryesisht ato që ofrojnë asistencë teknike, kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore

3.5 Projekti ka luajtur rol kyc ne rritjen e investimeve ne zonen ku eshte zbatuar?



Të anketuarit besojnë se 58% e projekteve kanë luajtur ose pritet të luajnë një rol kyc në zhvillimin e zonës ku ato zbatohen.

3.6. Sa banore kane perfituar apo pritet te perfitojne nga zbatimi i projektit



Nga pyetsorët e mbledhur rezulton se 76% e projekteve në zbatim të marra në shqyrtim janë projekte madhore të cilat pritet të kenë ndikim në jetën e mbi 100,000 banorëve.

4.2. Verifikim i hipotezave të ngritura

Verifikimi i hipotezës qendrore H^0 : Performanca e institucioneve përfituese (disbursimi sipas planifikimit) dhe përfshirja e planifikimit të disbursimeve të NH në buxhetin shtetëror ndikon në efektivitetin e NH.

Për të verifikuar këtë hipoteze do të përdoret testi statistikor i hi-katrorit, i cili zbulon nëse ka lidhje midis dy variablave. Të dhënat e pyetësorit i përmbushin kriteret e që duhet të plotësojnë variablat dhe të dhënat për të realizuar një test jo-parametrik.

Për këtë qellim ngrihen hipotezat e mëposhtme të ndara në dy pjesë. Fillimisht analizohet nëse ka ndonjë dallim statistiksht të rëndësishëm midis pyetjes 1.7 (Përfshihet financimi i projektit në PBA?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar?) dhe me pas me ane të pyetjes 3.1 (Projekti ka patur/ pritet të ketë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm në sektorin ku është zbatuar).

H^0_{a0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes së huaj e efektivitetin e saj.

Me hipoteze alterantive:

H^0_{a1} : Ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes së huaj e efektivitetin e saj.

H^0_{b0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor midis përfshirjes së planifikimit të disbursimeve të financimit në PBA dhe efektivitetit të ndihmës së huaj.

Me hipoteze alterantive:

H^0_{b1} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor midis përfshirjes së planifikimit të disbursimeve të financimit në PBA dhe efektivitetit të ndihmës së huaj

Për të testuar hipotezat e mësipërme do të përdoret testi statistikor i Hi-katrorit meqënëse të dhënat tona janë kategorike dhe ky test tregon dallimet ose jo midis grupeve.

Rezultati per verifikimin e H^0_{a0}

		3.1. Projekti ka patur/ pritet te kete impakt te ndjeshem dhe lehtesisht te matshem ne sektorin ku eshte zbatuar.		Total
		1. Po	2. Jo	
1.7 Perfshihet financimi i projektit ne PBA ?	1. Po	84	14	98
	2. Jo	104	10	114
Total		188	24	212

Nga të dhënat e tabelës se mësipërme vihet re se nga 98 projektet për të cilat financimi është përfshirë në PBA, 84 prej tyre kanë patur/pritet të kenë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm në sektorin ku zbatohen dhe 14 prej tyre nuk kanë patur/pritet të kenë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm.

Për te verifikuar hipotezen perdoren të dhënat (rezultatet) e tabelës së mëposhtme:

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.596(b)	10	.000
Likelihood Ratio	8.042	10	.005
Linear-by-Linear Association	8.917	1	.003
N of Valid Cases	212		

Nga te dhënat e mësipërme shihet se madhësia e kampionit, (212 projekte) të marrë në shqyrtim, është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, minimumi duhet të jetë afërsisht 11 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mësipërme shohim se vlera e Pearson Chi-Square = 7.596, $p=0.000$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performances së ndihmës se huaj dhe efektivitetit të saj.

Në përfundim të analizës se mësipërme mund të konkludohet se:

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës se huaj dhe efektivitetit të saj.

Verifikimi i Hipotezës $H^0_{b_0}$:

		3.1. Projekti ka patur/pritet të ketë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm në sektorin ku është zbatuar.		Total
		1. Po	2. Jo	
1.4 Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar	1. Po	93	17	110
	2. Jo	95	7	102
Total		188	24	212

Nga të dhënat e tabelës se mësipërme vihet re se nga 110 projektet janë zbatuar apo po zbatohen brenda kohëzgjatjes së planifikuar, 93 prej tyre kanë patur/pritet të kenë impakt të ndjeshëm dhe lehtësisht të matshëm në sektorin ku është zbatuar dhe 17 prej tyre projekti nuk ka impakt në sektorin ku është zbatuar.

Për të hedhur poshtë ose vërtetuar hipotezën analizohen të dhënat e tabelës se mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	3.892	10	.004
Likelihood Ratio	3.083	10	.007
Linear-by-Linear Association	4.016	1	.005
N of Valid Cases	212		

Nga të dhënat e mësipërme shihet se madhësia e kampionit (212 projekte) të marrë në shqyrtim është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, minimumi duhet afërsisht 11 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mësipërme shohim se vlera e Pearson Chi-Square = 3.892, $p = 0.004$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor midis përfshirjes së planifikimit të disbursimeve të financimit në PBA dhe efektivitetit të ndihmës së huaj, pra hipoteza e pare e studimit H_0 bie poshtë.

Në përfundim të analizës së mësipërme mund të konkludohet se:

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor midis përfshirjes së planifikimit të disbursimeve të financimit në PBA dhe efektivitetit të ndihmës së huaj.

Verifikimi i hipotezës H^1 : *Reduktimi i vonesave procedurale për shkak të ristrukturimit të projektit gjatë zbatimit të tij (2.1) dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore e materiale në institucionet përfituese (3.4) ndikon në zbatimin e projektit sipas planifikimit (1.4).*

Për të analizuar këtë hipotezë do të përdoret testi statistikor i hi-katrorit, i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri-tjetrin, i cili njihet ndryshe edhe si **testi hi-katror** i lidhjes. Ky test statistikor zbulon nëse ka lidhje (varësi) midis dy variablave. Të dhënat e pyetësorit i përmbushin kriteret e që duhet të plotësojnë variablat dhe të dhënat për të realizuar një test joparametrik.

Për këtë qëllim ngrihen hipotezat e mëposhtme të ndara në dy pjesë. Fillimisht shikohet nëse ka ndonjë dallim statistikisht të rëndësishëm midis pyetjes 2.1 (Ka patur ristrukturim/zgjatje afati të projektit gjatë zbatimit të tij?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar?) dhe më pas me anë të pyetjes 3.4 (Projekti ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar?).

H^1_{a0} : Nuk ka një dallim të rëndësishëm statistikor të performancën e ndihmës së huaj nëse ka reduktim të vonesave procedurale.

Me hipoteze alternative

H^1_{a1} : Ka një dallim të rëndësishëm statistikor të performancën e ndihmës së huaj nëse ka reduktim të vonesave procedurale.

H^1_{b0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performancës së ndihmës së huaj nëse ka një rritje të kapaciteteve të njerëzore e materialeve

Me hipoteze alternative

H^1_{b1} : Ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performancës së ndihmës së huaj nëse ka një rritje të kapaciteteve të njerëzore e materialeve

Për të testuar hipotezat e mësipërme do të përdoret testi statistikor i Hi-katrorit meqënëse të dhënat e analizura janë kategorike dhe ky test tregon dallimet ose jo midis grupeve.

Verifikimi i hipotezes H^1_{a0} :

		2.1 Ka patur ristrukturim/zgjatje afati te projektit gjate zbatimit te tij?		Total
		1. Po	2. Jo	
1.4 Projekti po zbatohet/ eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar	1. Po	32	78	110
	2. Jo	50	52	102
Total		82	130	212

Nga të dhenat e tabelës se mesiperme veme re se nga 110 projektet te cilat jane zbatuar apo po zhvillohen brenda kohëzgjatjes se planifikuar, 32 prej tyre kane patur nevojë per ristruktim/ zgjatje afati dhe 78 prej tyre nuk kane patur jashte këtij afati.

Rezultati i krahasimit me testin Chi-Square :

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	8.862(b)	10	.003
Likelihood Ratio	8.042	10	.005
Linear-by-Linear Association	8.917	1	.003
N of Valid Cases	212		

Nga te dhenat e mesiperme shihet se madhesia e kampionit (212 projekte) tone eshte e mjaftueshme per te bere testin statistikor, minimumi duhet afersisht 39 projekte per te pare dallimet ose jo midis variblave.

Nga tabela e mesiperme shohim se vlera e Pearson Chi-Square = 8.862, $p=0.003$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim rëndësishëm statistikor nëpërmejet performances së ndihmes se huaj gjate reduktimit te vonesave proceduriale, pra hipoteza e pare e studimit H_0 bie poshte.

Në përfundim te analizës së mësipërme mund të konkludohet se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmes se huaj nëse ka patur reduktim të vonesave proceduriale.

Verifikimi i hipotezës H^1_{b0} :

		3.4. Projekti ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore.		Total
		1. Po	2. Jo	1. Po
1.4 Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar	1. Po	65	45	110
	2. Jo	78	24	102
Total		143	69	212

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vërejmë se nga 110 projektet të cilat janë zbatuar apo po zhvillohen brenda kohëzgjatjes së planifikuar, në 65 prej tyre projekti ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe 45 prej tyre projekti nuk ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore.

Për të hedhur poshtë ose vërtetuar hipotezën analizohen të dhënat e tabelës së mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.282	10	.008
Likelihood Ratio	6.511	10	.011
Linear-by-Linear Association	7.375	1	.007
N of Valid Cases	212		

Nga të dhënat e mësipërme shihet se madhësia e kampionit (212 projekte) është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, minimumi duhet afërsisht 33 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mësipërme shihet se vlera e Pearson Chi-Square = 7.282, $p=0.008$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim të rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës së huaj nëse ka një rritje të kapaciteteve të njerëzore e materialeve, pra hipoteza e parë e studimit H_0 bie poshtë.

Në përfundim të analizës së mësipërme mund të konkludohet se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës së huaj nëse ka një rritje të kapaciteteve njerëzore e materialeve.

Verifikimi i hipotezës së punës H^2 : Efektiviteti i NH varet nga sektori i ekonomisë.

Do të analizohet nëse ka dallime apo jo midis efektivitetit të Ndhmës së Huaj nga sektori i ekonomisë ku operon institucioni që ka përfutur ndihmën. Për të realizuar këto analize do të përdoret testi statistikor të hi-katrorit. Për të realizuar analizën nepermjet testit Hi-katror duhet që të dhënat të jenë:

- Varibla në shkallë matje kategorike
 - Të kenë të paktën 2 kategori (shkalla e matjes për pyetjet në shqyrtim është kategorike)
- Ndërsa efektivitetin do ta masim me anë të pyetjes katër të pyetsorit si më poshtë:

Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar

Për pjesën e sektorit, bëhet një ndarje sipas 10 kategorive të mëposhtme:

1. Finance
2. Bujqesi
3. Arsim
4. Shëndetsi
5. Social- Kulturor
6. Zhvillim. Ekonomik
7. Transport
8. Ujesjelles-Kanalizime
9. Mjedis
10. Siguria/Mbrojtja/Policimi

Një institucion për një pyetje klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat e pyetësorit të ndërtuar i përmbushin kriteret e mesiperme.

Duhet vërtetuar nëse në sektorë të ndryshëm ku është marrë ndihma e huaj ka ndonjë dallim statistikisht të rëndësishëm përse i përket efektivitetit të saj. Për këtë qëllim ngrihen hipotezat e mëposhtme:

H^2_0 : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor midis sektorëve të ekonomisë përse i përket ndihmës së huaj të përfituar.

Me hipotezë alternative:

H^2_1 : Ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor midis sektorëve të ekonomisë përse i përket ndihmës së huaj të përfituar

Verifikimi i hipotezes: H^2_0

Rezultatet e verifikimit të kësaj hipoteze jepen në tabelën në vazhdim:

		1.4 Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar		Total
		1. Po	2. Jo	1. Po
1.2 Projekti i perket sektorit ekonomik:	1. Finance	3	0	3
	2. Bujqesi	5	9	14
	3. Arsim	6	4	10
	4. Shendetsi	11	2	13
	5. Social- Kulturor	16	16	32
	6. Zhv. Ekonomik	34	12	46
	7. Transport	12	36	48
	8. Ujesjelles-Kanalizime	3	6	9
	9. Mjedis	18	10	28
	10. Sigurise/mbrojtjes/policimit	0	7	7
	11. Infrastruktura	2	0	2
Total		110	102	212

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vëhet re se nga 48 projektet të cilat janë zhvilluar në sektorin e transportit, 12 prej tyre po zbatohen ose janë zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar dhe 36 jashtë këtij afati. E kundërta ndodh në sektorin e zhvillimit ekonomik ku nga 46 projekte të financuara me ndihmë të huaj, 34 prej tyre po zbatohen ose janë zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar dhe 12 projekte jashtë këtij afati.

Për të verifikuar hipotezën analizohen të dhënat e tabelës së mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	45.344(a)	10	.000
Likelihood Ratio	51.615	10	.000
Linear-by-Linear Association	2.384	1	.123
N of Valid Cases	212		

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	5.368 ^a	4	.252
Likelihood Ratio	5.321	4	.256
Linear-by-Linear Association	.011	1	.916
N of Valid Cases	270		

Nga te dhenat e mesipërme shihet se madhesia e kampionit (212 projekte) eshte e mjaftueshme per te bere testin statistikor, minimumi duhet afersisht 96 projekte per te pare dallimet ose jo midis varibleve.

Nga tabela e mesiperme shohim se vlera e Pearson Chi-Square = 45.344, $p=0.000$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim rëndësishem statistikor midis sektoreve të ekonomise persa i përkët ndihmës së huaj, pra hipoteza e dyte e studimit H_{02} bie poshte.

Në përfundim te analizes se mesiperme mund te konludojme se :

Ekziston një dallim rëndësishem statistikor midis sektoreve të ekonomisë, pra efektiviteti i ndihmës se huaj varet nga sektori ku ajo zbatohet.

Verifikimi i hipotezës së punës H^3 : Reduktimi i vonesave në fazën e projektimit (2.10) dhe prokurimit (2.5) ndikon në efektivitetin e Ndhmës së Huaj (1.4)

Per të vërtetuar kete hipoteze do te perdoret testi statistikor i hi-katrorit. Edhe në këtë rast, të dhënat e pyetësorit i permbushin kriteret e qe duhet te plotesojne variablat dhe te dhenat per te realizuar nje test joparametrik.

Për këtë qellim ngrihen hipotezat e mëposhtme te ndara ne dy pjese. Fillimisht analizohe nese ka ndonje dallim statistikisht të rendesishem midis pyetjes 2.10 (Ka patur vonesa ne projektimin e projektit?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar?) dhe me pas midis pyetjes 2.5 (Ka patur problematika/vonesa ne fazen e prokurimit?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar?).

H^3_{a0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes se huaj nëse ka patur vonesa ne projektimin e projektit.

Me hipoteze alternative:

H^3_{a1} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes se huaj nëse ka patur vonesa ne projektimin e projektit.

H^3_{b0} : Ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes se huaj nese ka patur problematika/vonesa ne fazen e prokurimit

Me hipoteze alternative:

H^3_{b1} : Ekziston ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes se huaj nese ka patur problematika/vonesa ne fazen e prokurimit

Për të testuar hipotezat e mësipërme do të përdoret testi statistikor i Hi-katrorit mqs te dhenat tona janë kategorike dhe ky test tregon dallimet ose jo midis grupeve.

Verifikimi i hipotezes **H^3_{a0}** me hipoteze alternative **H^3_a**

		2.10. Ka patur vonesa ne projektimin e projektit?		Total
		1. Po	2. Jo	
1.4 Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar	1. Po	52	58	110
	2. Jo	14	88	102
Total		66	146	212

Nga të dhenat e tabelës se mësipërme vihet re se nga 110 projekte të cilat janë zbatuar apo po zhvillohen brenda kohëzgjatjes së planifikuar, 52 prej tyre kanë patur vonesa në projektimin e projektit dhe 58 prej tyre nuk kanë patur vonesa në projektim.

Për të hedhur poshtë ose vërtetuar hipotezën analizohen të dhenat e tabelës së mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	27.781	1	.000
Likelihood Ratio	26.238	1	.000
Linear-by-Linear Association	29.191	1	.000
N of Valid Cases	212		

Nga të dhenat e mësipërme shihet se madhësia e kampionit (212 projekte) e marrë në shqyrtim, është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, pasi minimumi duhet afërsisht të jetë rreth 32 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mësipërme shohim se vlera e Pearson Chi-Square = 27.781, $p=0.000$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performances së ndihmes se huaj gjatë vonesave në projektimin e projektit, pra hipoteza e parë e studimit H_0 bie poshtë.

Në përfundim të analizës së mesipërme mund të konkludohet se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës së huaj nëse ka patur vonesa në projektimin e projektit.

Verifikimi i hipotezës H^3_{b0} me hipotezë alternative H^3_{b1}

		2.5. Ka patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit?		Total
		1. Po	2. Jo	
1.4 Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohëzgjatjes së planifikuar	1. Po	46	64	110
	2. Jo	13	89	102
Total		59	153	212

Nga të dhënat e tabelës së mesipërme vihet re se nga 110 projektet të cilat janë zbatuar apo po zhvillohen brenda kohëzgjatjes së planifikuar, 46 prej tyre kanë patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit dhe 64 prej tyre nuk kanë patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit.

Per të hedhur poshtë ose vërtetuar hipotezën shohim të dhënat e tabelës së mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	22.272	1	.000
Likelihood Ratio	20.848	1	.000
Linear-by-Linear Association	23.367	1	.000
N of Valid Cases	212		

Nga të dhënat e mesipërme shihet se madhësia e kampionit (212 projekte) është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, minimumi duhet afërsisht 28 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mesipërme shohim se vlera e Pearson Chi-Square =22.272, $p=0.000$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të performancës së ndihmës së huaj nëse ka patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit, pra hipoteza e parë e studimit H_0 bie poshtë.

Në përfundim të analizës së mesipërme mund të konkludohet se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës së huaj nëse ka patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit.

Verifikimi i hipotezës së punës H^4 : Përfshirja e ndihmës së huaj në tavanet buxhetore (PBA) (1.7) ndikon në planifikimin më realist të fondeve të huaja nga institucionet përfituese (1.6) dhe rrjedhimisht në performancën e tyre (1.4).

Per të vërtetuar këtë hipotezë do të përdoret testi statistikor i hi-katrorit. Te dhënat e pyetësorit i permbushin kriteret qe duhet te plotesojne variablat dhe te dhenat per te realizuar nje test joparametrik.

Për këtë qëllim ngrihen hipotezat e mëposhtme te ndara ne dy pjesë. Fillimisht analizohe nese ka ndonje dallim statistikisht të rëndësishëm midis pyetjes 1.7 (Përfshihet financimi i projektit ne PBA?) dhe 1.6 (Ekziston nje plan per zbatimin e projektit i ndarë ne aktivitete konkrete të parashikuara në kohë?) dhe me pas midis pyetjes 1.7 (Përfshihet financimi i projektit ne PBA?) dhe 1.4 (Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar?).

H^{4a_0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të përfshirjes së financimit të projektit ne PBA dhe ekzistencës së një plani zbatimi të projektit me aktivitete konkrete.

me hipoteze alternative:

H^{4a_1} : Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit ne PBA dhe ekzistencës së një plani zbatimi të projektit me aktivitete konkrete.

H^{4b_0} : Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të përfshirjes së financimit të projektit ne PBA dhe zbatimit të projektit brenda kohezgjatjes se planifikuar.

me hipoteze alternative:

H^{4b_1} : Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit ne PBA dhe zbatimit të projektit brenda kohezgjatjes se planifikuar.

Për të testuar hipotezat e mësipërme do të përdoret testi statistikor të Hi-katrorit mqs te dhenat janë kategorike dhe ky test tregon dallimet ose jo midis grupeve.

Verifikimi i hipotezes H^{4a_0} me hipoteze alternative H^{4a_1}

		1.6. Ekziston nje plan per zbatimin e projektit I ndare ne aktivitete konkrete te parashikuara ne kohe?		Total
		1. Po	2. Jo	
1.7 Përfshihet financimi I projektit ne PBA?	1. Po	32	66	98
	2. Jo	24	90	114
Total		56	156	212

Nga të dhenat e tabelës së mësipërme vëhet re se nga 98 projektet financimi i të cilave është përfshirë në PBA, 32 prej tyre kanë një plan për zbatimin e projektit të ndarë në aktivitete konkrete të parashikuara në kohë dhe 66 prej tyre nuk e kanë një plan të tillë.

Për të hedhur poshtë ose vërtetuar hipotezën analizohen të dhenat e tabelës së mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	36.48	1	.042
Likelihood Ratio	30.76	1	.040
Linear-by-Linear Association	36.45	1	.030
N of Valid Cases	212		

Nga të dhenat e mësipërme shihet se madhësia e kampionit (212 projekte) është e mjaftueshme për të bërë testin statistikor, minimumi duhet afërsisht 25 projekte për të parë dallimet ose jo midis variablave.

Nga tabela e mësipërme shihet se vlera e Pearson Chi-Square = 36.480, $p=0.042$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të financimit të projektit në PBA dhe ekzistencës së një plani zbatimi të projektit me aktivitete konkrete, dhe H_0 bie poshtë.

Në përfundim të analizës së mësipërme mund të konkludohet se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit në PBA dhe ekzistencës së një plani zbatimi të projektit me aktivitete konkrete.

Verifikimi i hipotezës H^4_{b0} me hipotezë alternative H^4_{b1}

		1.4 Projekti po zbatohet/është zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar		Total
		1. Po	2. Jo	
1.7 Përfshihet financimi i projektit në PBA?	1. Po	58	40	98
	2. Jo	52	62	114
Total		110	102	212

Nga të dhenat e tabelës së mësipërme vëhet re se nga 98 projektet financimi i të cilave është përfshirë në PBA, 58 prej tyre po zbatohen/janë zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar dhe 66 prej tyre nuk po zbatohen/janë zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar.

Per te hedhur poshte ose vërtetuar hipotezen shohim te dhenat e tabelës se mëposhtme :

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	38.87	1	.000
Likelihood Ratio	33.62	1	.000
Linear-by-Linear Association	39.01	1	.000
N of Valid Cases	212		

Nga te dhenat e mesiperme shihet se madhesia e kampionit (212 projekte) eshte e mjaftueshme per te bere testin statistikor, dhe per te pare dallimet ose jo midis variblave.

Nga tabela e mesiperme shihet se vlera e Pearson Chi-Square =38.87, $p=0.000$ pra $p < 0.05$. Kjo tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit ne PBA zbatimit të tij brenda kohezgjatjes se planifikuar, pra hipoteza e pare e studimit H_0 bie poshte.

Në përfundim te analizes se mesiperme mund te konludojme se :

Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit ne PBA dhe zbatimit të tij brenda kohezgjatjes se planifikuar.

4.3. Performanca e insitucioneve përfituese – analiza e të dhënave dytësore

Ky seksion përfshin një analizë të financimit të huaj total në zbatim si dhe atij të planifikuar për kryesisht për vitet 2016-2020. Të dhënat e analizuara janë marrë nga Databaza e Ndihmës së Huaj, e vënë në dispozicion nga DZHFNH, që ka dhe funksionin e koordinatorit qëndror të financimit të huaj në vend. Sic vihet re, në përfundim të kësaj analize të thelluar të të dhënave dytësore, rezultatet e përfituara janë në linjë të plotë dhe përforcojnë rezultatet e përfituara nga analiza e të dhënave parësore në seksionin 4.1 si dhe dhe me rezultatet e përfituara nga vërtetimi i hipotezave në seksionin 4.2.

Analiza e të dhënave dytësore

Portofoli i ndihmës së huaj në Shqipëri, për projektet në zbatim, sic është përmëndur dhe më sipër, është përqëndruar kryesisht tek 4 institucione: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (78% ndaj totalit), e ndjekur nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (36%), Ministria e Financave (28%) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (12%).

Disbursimi i financimit të huaj sipas një plani të parashikuar duke iu përmbajtur kohëzgjatjes së përcaktuar të projektit përbën treguesin kryesor të performancës së institucioneve përfituese. Në rastet kur vërehet një nivel i ulët disbursimi, i cili, për shkaqe të ndryshme, nuk përkon me planin e

parashikuar fillimisht, dhe si rrjedhojë projekti detyrohet të zgjatet në kohë, themi se insitucioni përgjegjës për zbatimin e këtij projekti nuk ka një performancë të mirë.

Nga një analizë e thelluar e kryer nga të dhënat e Ndhmës së Huaj sipas institucioneve përfituese, duke krahasuar financimin e angazhuar kundrejt atij të planifikuar, vihet re se ndër institucionet me performancë më e ulët janë ato institucione që zbatojnë projekte infrastrukturore, si MTI, MBZHRAU, MEI, MM, me një nivel disbursimi rreth 30-47 %.


MTI: ka një nivel disbursimi mjaft të ulët (46.5%) dhe si rrjedhim performancë të ulët në realizimin e projekteve dhe kjo ndikon në uljen e totalit të përthithjes dhe realizimit të fondeve. Duke qënë se ky institucion thith 78% të totalit të Ndhmës së Huaj, kjo të con në konkluzionin se pjesa më e madhe e Ndhmës së Huaj nuk përthithet në nivelin e duhur dhe si rrjedhim nuk ka efektivitetin e pritur në sektor.

MEI: Vazhdon të përthithë financime për shkak të karakterit strategjik. Megjithatë edhe në këtë sektor vihet re një performancë e dobët që arrin rreth 40% (matur në fund të vitit 2015).

FSHZH: ka një performancë dukshëm më të mirë (psh për vitin 2014/2015: 68%) krahasuar me institucionet e tjera. Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë performancë është menaxhimi me bazë portofoli për projektet aktualisht në zbatim;

MF: Ka marrë një mbështetje të konsiderueshme nga Banka Botërore për forcimin e financave publike. Ky është një sektor kyç, nga i cili varet performanca e sektorëve të tjerë, sidomos në kushtet e mbështetjes buxhetore nga BB dhe BE. Por, edhe ky institucion ka një nivel disbursimi relativisht të ulët prej 46%.

Niveli i disbursimit të Ndhmës së Huaj sipas Institucioneve (matur në fund të vitit 2015)
Në milion Euro




Burimi: Databaza e të dhënave DZHFNH

Analiza më poshtë ka si qëllim paraqitjen në detaj të nivelit të disbursimit sipas institucioneve përfituese, arsyet kryesore të cilat kanë kontribuar në këtë nivel disbursimi dhe si rrjedhim në performancën e këtyre institucioneve, duke u bazuar kryesisht tek problematikat e hasura apo vonesat e ndryshme, të reflektuara dhe në pjesën përkatëse të pyetsorit të plotësuar nga këto institucione. Pra, bëhet një ndërthurje midis analizës së të dhënave dytësore me analizën e të dhënave parësore të mbledhura nga pyetsorët e plotësuar si dhe nga intervistat e kryera.



Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)

Angazhimi total për këtë institucion, për 57 projekte aktualisht në zbatim, arrin vlerën prej 1,069.960 Milion Euro, nga të cilat 85% janë kredi që mbulon kryesisht projektet e investimeve madhore në sektor dhe 15% janë grant që përdoret kryesisht për asistencë teknike për ngritje kapacitetesh dhe përgatitje të projekt-propozimeve.



Donatorët kryesorë që kontribuojnë me financim janë IDB (Banka Islamike për Zhvillim), Banka botërore dhe BE nëpërmjet instrumentit IPA.

Donatorët kryesorë



Financimi i huaj i përfituar nga MTI ndahet sipas tre fushave kryesore: Transporti, Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet, si dhe Infrastruktura e Administrimit të Mbetjeve, sic shihet dhe në grafik.

Transport

Projektet më madhore synojnë ndërtimin e segmenteve të reja si pjesë e Korridorit VIII ose të Boshtit Veri-Jug. Më konkretisht për tu përmenduar janë:

- Ndërtimi i Rrugës Tiranë-Elbasan, projekt me vlerë 240 Milion Euro financuar nga Banka Islamike për Zhvillim - IDB dhe OPEC, pritet të përfundojë në vitin 2017. Projekti aktualisht po përmbyll segmentin Sauk – Hyrje e Tunelit të Krrabës (km 13).
- Ndërtimi i Rrugës Qukës - Qafë Plloçë, me vlerë 134,3 Milionë Euro, financuar nga Banka Islamike për Zhvillim - IDB, (111.9 Milion Euro) dhe Fondi Saudit (22.4 Milion Euro). Segmenti prej 43,4 km do të kalojë ndërmjet Qarkut të Elbasanit dhe Korçës. Si pjesë e Korridorit VIII, ai do të sigurojë një lidhje më të shpejtë dhe komode midis portit të Durrësit dhe vendeve të tjera të Ballkanit, duke e bërë Shqipërinë vendin më të përshtatshëm për të kryer tranzitin nga vendet e Ballkanit drejt Evropës dhe në të kundërt. Kjo rrugë shërben gjithashtu si bypass për qytetin e Pogradecit.
- Me një financim total prej 160,8 Milionë Euro, po zbatohen 5 projekte madhore infrastrukturore me rëndësi, pasi krijojnë nyje për integrimin e rrjetit rrugor kombëtar. Më konkretisht projektet që veçohen janë *By-pass*et: -Fier, me vlerë 88 Milionë Euro (BERZH, BEI); - Vlorë, me vlerë 37,3 Milionë Euro (BERZH, BEI, IPA 2011); - Rrogozhinë, me vlerë 7 Milionë Euro (IPA 2012); dhe Durrës, me vlerë 28,5 Milionë Euro (Fondi Kuvajtian dhe Saudit për Zhvillim), me afat përfundimi Dhjetor 2016.
- Krahas veprave në ndërtim, me ndihmën e Koorperacionit Italian me një vlerë prej 24,35 Milion Euro po ndertohet rruga Lushnje-Fier dhe po mbikqyren punimet e rruges Fier-Vlorë.
- Për t'u veçuar, në Transportin Detar, janë dy projektet madhore për rehabilitimin/zgjerimin e dy porteve kryesore të vendit: 1. Durrës: Ndërtimi i një terminali tragetesh për pasagjerët dhe rehabilitimi i infrastrukturës shoqëruese, molet 7-8, (BEI, 18 Milionë Euro kredi, Banka Islamike për Zhvillim 12,38 Milion Euro Kredi); 2. Vlorë: Ndërtimi i portit të Vlorës dhe mbikqyrja e punimeve për të zhvilluar terminalin dhe lehtësuar levizjen e mallrave dhe njerezve financuar nga Italia me një kredi me vlerë rreth 15 Milionë Euro.
- Me një fond prej 22,4 Milionë Euro kredi, OPEC po nderton dhe rikostrukturon rrugët lokale dhe dytesore në disa zona të vendit.
- WBIF në bashkëpunim me BERZH, me një fond total prej 2,77 Milione Euro grant, po harton projektin për ndërtimin e hekurudhës Tirane-Durrës (1,25 Milione Euro), rikostruksionin e linjes hekurudhore Durrës-Pogradec-Lin (720,00 Euro) dhe hartimin e projektit të linjes hekurudhore Vlorë-Hani i Hotit (800,000 Euro).

Ujësjellës – Kanalizime

- Nën-sektori është një nga përthithësit më madhor të fondeve të huaja, duke u rradhitur si sektori i dytë më i rëndësishëm. Totali i financimit aktiv është 343.7 Milionë Euro (223,9 Milionë Euro kredi; 119,7 Milionë Euro grant), i shpërndarë në 19 Projekte/Programe madhore infrastrukturore në zbatim në të gjithë vendin (Sistemet Shkodër/Velipojë, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat/Kuçovë, Korçë/Pogradec, etj). Si programe madhore mund të veçohen:

- Investime në sektorin e Ujësjiellës Kanalizimeve (Durrës), financuar nga Banka Botërore me një financim prej 76,77 Milion Euro kredi, që përfshin puse të furnizimit me ujë, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në zonën e plazhit të Durrësit, rehabilitimi i pjesëve kritike të sistemit ekzistues në Durrës dhe rrethinat e tij, si dhe lidhja me Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura.
- Projekti i Përmirësimit të sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe, financuar nga Japonia me 73,84 Milion Euro kredi. Projekti synon trajtimin e ujërave të zeza, të cilat mbledhen në Lumin Lanë, ndërtimin e një Impianti në Kashar, Laknas dhe rehabilitimin e kanalizimeve mbështetëse.
- Përmirësimi i sistemeve të ujësjiellës-kanalizimeve & Infrastruktura Bashkiake III-IV në Tiranë, financuar nga Gjermania/KfW dhe Zvicra me një total financimi prej 76,48 Milionë Euro 36,48 Milionë euro Grant; 40 Milionë euro Kredi).
- Përmirësimi i sistemit të ujësjiellës kanalizimeve në bashkitë e Kamëz, Lushnjë, Fieri, Sarandë, Berat (14 Milion Euro Kredi), Lezhë (10,5 Milione Euro Grant), Shkoder (12,23 Milion Euro Grant), Pogradec (10 Milion Euro) etj.
- Projekte me rëndësi strategjike janë ndërtimi i Impianteve të trajtimit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza përgjatë bregut, të cilat ndikojnë në cilësinë e produktit turistik në vend. Mund të veçojmë projekte si ITUZ i: Vlorës (IPA 2009/12, 35,71 Milionë Euro); Velipojës (IPA 2011, 10,5 Milion Euro); Shëngjin, Sarandë/Ksamil, etj. Këto i shtohen ose vendosin në funksion ITAZ ekzistues të ndërtuar nga BB si ai i Durrësit, Sarandës, dhe Lezhës.


Infrastruktura e Administrimit të Mbetjeve

Ky sektor ka filluar të përfitojë financim të huaj në masë të konsiderueshme relativisht vonë. Projektet madhore në zbatim që mund të veçohen janë:

- Ndërtimi i Landfillit të Shqipërisë Jug-Lindore (Maliq/Korçë) me vlerë 11.8 Milionë euro (KfW, me afat përfundimi dhjetor 2016) i cili pas Sharrës dhe Bushatit, është landfilli i 3-të që i shërben një rajoni të gjerë.
- Zgjerimi i Landfillit të Sharres në Tiranë, financuar nga Italia me një vlerë rreth 6 Milion Euro në formën e kredisë së butë.



Planifikimi për vitet në vijim

Fondet totale të planifikuara për vitet 2016-2020 janë rreth 189 Milion Euro, të ndara në 11 projekte.



Edhe këtu vërehet një ndryshim i raportit grant-kredi ku tashmë përqindja e grantit është rritur në rreth 23% nga 15% që ishte për projektet aktualisht në zbatim. Kjo tregon edhe njëherë tendencën e përgjithshme për të ulur komponentin e kredisë e për të rritur atë të grantit.

Grafiku më poshtë tregon financimin e planifikuar sipas donatorëve kryesorë. Pjesën më të madhe të financimit, rreth 70%, e mbulon Banka Botërore dhe Kuvajti.



Sikurse vërehet, në shpërndarjen e fondeve sipas nën-sektorëve, ka një zhvendosje të optikës së donatorëve nga Transporti drejt Menaxhimit të Mbetjeve, me një total financimi për këtë të fundit prej rreth 10 Milionë Euro, kryesisht angazhuar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW).

Disa nga projektet kryesore që pritet të financohen në vitet e ardhshme, të grupuar sipas nën-sektorëve, janë si më poshtë:

Transport

Megjithëse financimi total për këtë nën-sektor pritet të pësojë një ulje të ndjeshme në vitet që vijnë, vërehet se vëmendja do të zhvendoset nga ndërtimi i segmenteve rrugore në zbatimin e projekteve të mirëmbajtjes rrugore dhe kryesisht në prezervimin e aseteve tashmë të ndërtuara apo në ndërtim. Ky fakt tregon dhe sensibilizimin tashmë për të financuar projekte që t'i qëndrojnë kohës e si rrjedhim me një impakt më të lartë në komunitet.

- Veçohet angazhimi i Bankës Botërore me 96 milionë Euro për Programin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore. Ky projekt konsiston në riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar, hartimin e strategjisë së mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, dhe rritjen e kapaciteteve në këto aktivitete të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Ky projekt pritet të ketë një impakt të ndjeshëm në këtë sektor.
- Një tjetër projekt me rëndësi është ai i Kuvajtit për Rikonstruksionin e Rrugës së Lumit të Vlorës me një financim prej rreth 36,7 Milion Euro.
- BE (IPA) me një projekt për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë Rrugore me financim rreth 24 Milion Euro grant.

Infrastruktura e administrimit të mbetjeve

Ky nën-sektor pritet të tërheqë financime të konsiderueshme në vitet që vijnë, për faktin se administrimi i mbetjeve shihet si një prioritet i cili mbetet për t'u adresuar pasi ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin dhe cilësinë e jetës së përditshme të popullsisë. Dy projekte madhore që pritet të fillojnë së shpejti në këtë fushë, janë:


- Ndërtimi i Landfillit të Vlorës (mundësisht duke përfshirë edhe qytetin e Fierit) financuar nga Gjermania/KfW me një vlerë prej 19,53 Mln Euro dhe pritet të fillojë në vitin 2017.

- Nje tjetër projekt është Administrimi i Mbetjeve dhe Riciklimi i tyre i financuar nga Gjermania/GIZ me nje vlere prej 3 Milion Euro grant.

Ujësjiellës-kanalizime

Megjithëse financimi në këtë sektor pritët të reduktohet në vitet që vijnë, mund të përmenden dis projekte madhore dhe me impakt si më poshtë:

- Mbeshtetje për Menaxhimin e Ujit e financuar nga BE nëpërmjet instrumentit IPA 2016 me një vlerë prej 4 Milion Euro grant.
- Nje projekt tjetër për t'u përmendur është Reforma e Ujit, i cili ka për qëllim orientimin e politikave drejt rritjes së cilësisë së ujit të pijshëm me një vlerë prej rreth 2,2 Milion Euro grant, të financuar nga Gjermania/GIZ.




Sic është përmendur dhe më sipër, kjo ministri ka një nivel disbursimi mjaft të ulët prej rreth 46%. Pra më shumë se gjysma e financimit për projektet në vazhdim nuk është disbursuar ende. Ky fakt nënkupton një përthithje relativisht të ulët të financimit

Nga analiza e pyetsorëve të mbledhur për projektet e këtij institucioni rezulton se problematikat me frekuencë më të lartë që rrejdhimisht janë faktorët kryesorë që ndikojnë në përthithjen e ulët të

financimit të huaj, në zgjatjen e projekteve në kohë përtej planifikimit të parashikuar lidhen kryesisht me procesin shumë të ngadaltë të shpronësimeve. Kjo problematikë vërehet kryesisht në projektet si By-passi i Fierit, Vlorës, Rruga Qukës-Qafë Plloçë, Ujësjiellësi i Veliojës, By-Pasi i Durrësit, Landfilli i Maliqit, etj.

Poshtu, mungesa e fondeve të mirëmbajtjes dhe kapaciteteve njerëzore e materiale të Shoqërive të Ujësjiellës-Kanalizimeve, kanë sjellë në disa raste amortizim të aseteve të ndërtuara, sic është rasti i ITUZ Vlorë. Nga analiza e kryer rezulton se vonesa të punimeve për projektet e kësaj ministrie ka patur edhe si pasojë të mungesës së lidhjes me OSHE, si në rastin e ITUZ Velipojë apo Sarandë, por edhe probleme të hasura për përcaktimin institucionit përgjegjës për marrjen në dorëzim të veprave të përfunduara, sic është rasti i ITUZ Lezhë, apo Durrës.


Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (MEI)




Financimi i huaj shkon në vlerën e 497,63 Milionë Euro, për zbatimin e 21 projekteve. Nga totali i financimit, 92% (460 Milionë euro) janë në formën e kredisë dhe vetëm 8% janë grant.

Burimi më i madh i financimit vjen nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare që më së shumti angazhojnë kredi, si Gjermani/KfW dhe Banka Botërore (BB) me rreth 66% të financimit total në zbatim. Ndërkohë partneri kryesor që angazhon grante

është Zvicra dhe Bashkimi Evropian përmes programeve të ndryshme kryesisht rajonale.



Financimi aktualisht në zbatim për këtë institucion ndahet sipas katër fushave kryesore si: Siguria e Digave, Transmetim, Eficiencia Energjetike dhe Hidrokarburet.



Transmetim

Pjesa më e madhe e financimit me një vlerë totale prej rreth 343 Milion Euro përqëndrohet në këtë fushë për shkak të rëndësisë që ajo ka. Disa prej projekteve madhore dhe që pritet të kenë një impakt të ndjeshëm janë:

- Projekti “ Linja e Interkonjksionit 440 KV me Kosovën”, financuar nga KfW, me vlerë 42 Milion Euro i cili ka një rëndësi strategjike. Synimi i këtij projekti është integrimi në tregjet rajonale të energjisë, duke siguruar për të dy vendet diversifikim burimesh dhe rrjedhimisht qendrueshmëri energjetike. Fillimi i punimeve u bë i mundur pas një sërë vonesash gjatë Qershorit 2014. Projekti pritët të përfundojë në fund të vitit 2017.
- Një tjetër projekt me rëndësi, është “Ndërtimi i Linjës 110 kV rrethore e boshtit të Jugut”, financuar nga KfW me një vlerë prej 51 Milion Euro. Më konkretisht do të ndërtohet linja ajrore 110 kV Shqipëria e Jugut dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues 400/110 kV Zemblak. Rëndësia e këtij projekti qëndron në përmirësimin e sistemit të transmetimit dhe në furnizimin cilësor me energji elektrike të zonës së jugut të Shqipërisë. Projekti pritët të përfundojë në shkurt të vitit 2018.
- Më rëndësi është edhe ndërhyrja në linjën e transmetimit 440 KV Elbasan-Tiranë dhe ndërtimi i disa nënstacioneve (Tirana 2, Kashar, Sauk; Pogradec) të financuara nga Qeveria Italiane. Këto janë mundësuar nga dy projekte me vlerë totale prej 93 Milion Euro.
- Një tjetër projekt është ndërtimi i linjës së transmetimit Tiranë-Rrëshbull me një vlerë prej 40 Milion Euro e financuar nga Gjermania/KfW”.

Siguria e digave

Ky nën-sektor përfiton aktualisht rreth 95 Milion Euro dhe përbën një sketor me një rëndësi të vecantë pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e digave dhe si rrjedhim mbrojtjen e popullsisë në zonat më të rrezikuara. Disa nga projektet madhore në zbatim mund të përmenden:

- Përmirësimi i sigurisë së Hidrocentraleve Koman, Fierzë dhe Vau i Dejës, me financim të BB (51.2 Milionë euro - Kredi), BERZH (12.7 Milionë euro - Kredi) dhe Zvicër/SECO (6.4 Milionë euro –Grant). Projekti do të rehabilitojë sistemet Elektromekanike dhe të Portave të Shkarkimit dhe të Remontit në HEC-e dhe do të kontribuojë në rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve mbi lumin Drin dhe Mat si dhe do të ndikojë në rritjen e furnizimit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i treguesve të cilësive të furnizimit me energji elektrike. Përfutjes janë gjithë konsumatorët në Shqipëri dhe në vecanti banorët në rrjedhën e poshtme të lumenjve si rezultat i parandalimit të katastrofave në rast çarje të digës. Projekti pritët të përfundojë brenda vitit 2017.
- Një tjetër projekt është Reabilitimi i Hidrocentralit të Komanit financuar nga Gjermania/KfW me një fond prej 20 Milion Euro Kredi.

Hidrokarburet

Ky nën-sektor përfiton rreth 45 milion Euro dhe përfshin kryesisht projekte që lidhen me prodhimin e energjisë termike dhe projekte parapërgatitore për infrastrukturën e gazit. Disa prej projekteve listohen më poshtë:

- Projekti i Prodhimit të Energjisë Termike në Vlorë me një vlerë prej 40 Milion Euro e financuar nga BERZH (EBRD).
- Projekti për hartimin e Master Planit të Gazit në Shqipëri, me një vlerë prej 1,1 Milionë Euro e financuar nga WBIF, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për politikën e mëtejshme kur të fillojë projekti i madh TAP, ku do të përfshihet dhe Shqipëria.


- Ngritja e Kapaciteteve të Gazit (Gaz Capacity Building), faza e dytë, me një vlerë prej 6.6 Milion Euro e financuar nga Zvicra. Projekti synon të ndihmojë institucionet kompetente shqiptare në punën përgatitore për zbatimin e suksesshëm të projekteve që lidhen me infrastrukturën e gazit brenda territorit të vendit.

Eficienca energjetike

Kjo fushë lidhet kryesisht me eficiencën e enrgjisë dhe përdorimin e burimeve alternative të energjisë. Projektet madhore aktualisht në zbatim janë si më poshtë:

- Programi “Mbështetje për Energjitë e Rinovushme dhe eficiencën e energjisë, financuar nga Gjermania/KfW me një vlerë prej 13,5 Milion Euro grant. Projekti ka dy komponentë: Garantimin e kredive për ndërtimin e HEC (1 Milion Euro) dhe implementimin e masave të eficiencës së energjisë dhe rehabilitimin e godinave publike (parashkollor dhe në Qytetin Studenti). Projekti pritet të përfundojë në dhjetor 2017.
- Një tjetër projekt është “Alterenegy” i cili do të mbështesë me studime, konsultime, ngritje kapacitetsh dhe pritet të kontribuojë në përmirësimin e punës për mbështetjen e eficiencës energjetike në 8 shkolla në Lushnjë dhe Lezhë, i financuar nga BE/IPA me një vlerë prej 3 Milionë Euro. Ky projekt është në kuadrin e programit të bashkëpunimit kufitar të vendeve të IPAs në zonën e Adriatikut dhe ka si qëllim stimulimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe përdorimin efiçent të energjisë.

Planifikimi për vitet në vijim




Për vitet 2016-2020, financimi i huaj i planifikuar arrin vlerën prej rreth 177 Milion Euro, të ndara në 5 projekte kryesore. Rreth 65% e kësaj vlere (115 Milion Euro) është grant dhe rreth 35% (ose 62 Milion Euro) është kredi e butë. Donatorët kryesorë që pritet të financojnë në vitet në vijim janë BERZH (EBRD) me një financim prej rreth 114 Milion Euro, BE nëpërmjet instrumentit IPA me një financim prej rreth 62 Milion Euro dhe Gjermania me një financim prej rreth 700 mijë Euro.

Pjesa më e madhe e financimit të huaj pritet të shkojnë për dy projekte **në fushën e Eficiencës Energjetike**, ku projekti më i rëndësishëm është projekti i përbashkët me Greqinë me një vlerë prej 114,2 Milion Euro, financuar nga BE/IPA për të rritur eficiencën energjetike në banesat e qyteteve afër kufirit të dy vendeve. Një tjetër projekt është ai i Eficiencës nëpërmjet përdorimit të Sektorit Bankar i financuar nga Gjermania/KfW, me një vlerë prej 12 Milion Euro.

Në fushën e transmetimit, pritet të fillojë zbatimin në janar të vitit 2017, Linja e Interkonjeksionit me Maqedoninë, e

financuar nga një kredi e butë e KfW-së, prej 50 Milion Euro; Projekti pritet të të përfundojë në dhjetor të vitit 2020. Kjo ministri ka një nivel disbursimi relativisht të ulët, rreth 42%. Pra më shumë se gjysma e financimit për projektet në vazhdim nuk është disbursuar ende. Ky fakt nënkupton një përthithje relativisht të ulët të financimit.




Nga analiza e pyetsorëve të mbledhur për projektet e këtij institucioni rezulton se problematikat me frekuencë më të lartë dhe që rrejdhimisht janë faktorët kryesorë që ndikojnë në përthithjen e ulët të financimit të huaj, në zgjatjen e projekteve në kohë përtej planifikimit të parashikuar lidhen kryesisht me vonesa në vlerësimin e nevojave dhe planifikimin buxhetor të projekteve. Poshtu, vonesa janë konstantuar në procedurat për marrjen e kredive, si dhe si pasojë e ristrukturimit të projektit duke

shtuar punime shtese, sic ka ndodhur në rastin e Rehabilitimit E-M të HEC Koman, ku për shkak të punimeve shtesë, si dhe fondeve shtesë të nevojshme, u zgjat në kohë duke dalë jashtë planifikimit fillestar. Vonesa janë hasur dhe në përgatitjen e procedurës së prokurimit për disa projekte si dhe dhe miratimit nga donatori. Se fundmi, për shkak të vonesave të hasura në procedurën e disburimit të fondeve, si psh për projektin ‘Alterenergy’ nga ana e donatorit (IPA Crossborder në këtë rast), nuk është mundur të kryhen pagesat në kohë për kontraktoret të cilët kanë përfunduar punimet.



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) ka si qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve në fushën e përkujdesjes, mbrojtjes, përfshirjes sociale dhe shanseve të barabarta, sigurimit shoqëror, arsimimit dhe formimit profesional, punësimit të sigurtë e të denjë dhe forcimit të bashkëpunimit me partnerët socialë. Donatorët dhe partnerët për zhvillim mbështesin aktualisht 27 projekte në mbështetje të sektorëve të sipërpërmendur.



Totali financimit për projektet në vazhdim është rreth 86.3 milion Euro për periudhën 2012-2017, prej të cilave 45 milion Euro (52%) janë kredi dhe 41.3 milion Euro (48%) janë në gran.

Donatorët më të rëndësishëm që financojnë rreth 68% të vlerës totale të projekteve aktualisht në zbatim janë: Banka Botërore me një financim prej 45 Milion Euro dhe Zvicra me 13.9 Milion Euro



Kjo mbështetje pritet të ketë impakt në krijimin e një sistemi modern të asistencës sociale, në rritjen e nivelit të kualifikimit të fuqisë punëtore dhe lehtësimin e aksesit të rinjve në tregun e punës, forcimin e lidhjeve midis arsimit dhe punësimit, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara të grupeve në nevojë në aktivitete ekonomike e sociale.

Fushat e mbështetjes me asistencë të huaj për

këtë ministri janë: Përfshirja dhe Mbrojtja Sociale, Edukimi dhe Trajnimi Profesional dhe Punësimi, sic tregohen në grafikun më poshtë.

Përfshirja dhe mbrojtja sociale

Përfshirja Sociale dhe mbrojtja sociale zë peshën kryesore me një total financimi prej 62.2 milion Euro për periudhën 2013-2017, kryesisht në mbështetje të komunitetit Rom dhe të personave me aftësi të kufizuar (PAK).

- Në kuadrin e modernizimit të asistencës sociale, Banka Botërore po financoi rreth 45 Milion Euro në formën e kredisë së butë. Në këtë kuadër, është përgatitur strategjia për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, janë kryer një sërë trajnimesh për administratorët socialë, si dhe ka filluar financimi i një pjese të shpenzimeve të skemës së Ndihmës Ekonomike (NE). Në qershor të vitit 2014 filloi pilotimi në tre qarqe i reformës së skemës së NE (Tiranë, Durrës dhe Elbasan). Kjo fazë shërben si bazë në shtrirjen e skemës në të gjithë vendin. Komponenti i Asistencës Teknike për projektin mbështetet gjithashtu edhe nga fondet IPA 2013 me 1.5 milionë Euro për periudhën 2015-2017.
- Në kuadër të Reformës së Kujdesit Social dhe rritjes së shërbimeve sociale mund të përmendet mbështetja nga Zyra e Kooperacionit Zviceran me rreth 11,75 Milion Euro Grant, në bashkëpunim me Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, duke siguruar një analizë e gjendjes bazë të sistemit të kujdesit social. Është instaluar sistemi i “manaxhimit të rastit”, janë ofruar shërbime mbështetëse shumëdimensionale si: ndihmë ligjore falas, trajnime, përfshirja e fëmijëve romë në shkollë e arsim profesional në bashkitë e Korçës, Tiranës, Elbasanit dhe Beratit, etj.
- Për fuqizimin ekonomik dhe social të Romëve dhe Egjiptianëve IPA 2014 ka ofruar një fond prej 4 milionë Euro Grant. Projekti pritet të përfundojë në vitin 2019.

Edukimi dhe trajnimi profesional

Totali i financimit në grant për këtë sektor është 9.17 milion Euro për periudhën 2012-2017, duke kontribuar në ofrimin e mundësive të reja për politikën e tregut aktiv të punës në Shqipëri, futjen e normave dhe standarteve europiane si dhe të zbatimit të tyre në praktikë.

- Janë përfunduar një sërë studimesh, është vënë në funksionim Qendra Multifunkionale në Kamëz, si dhe janë trajnuar 75 përfaqësues të zyrave kombëtare dhe rajonale të punës, nëpërmjet asistencës së dhënë nga Programi i arsimit dhe formimit profesional-Faza II, e financuar nga Gjermania. Programi vijon me një fazë të tretë për vitet e ardhshme.
- Hartimi i 35 kurrikulave dhe modeleve të bashkëpunimit mes shkollave profesionale dhe sektorit privat për praktikën profesionale, të mundësuar nga projekti Alb-VET i financuar nga qeveria Zvicerane. Janë zhvilluar kurse kualifikimi për 30 mijë pjesëmarrës nga grupet e rrezikuara për të cilat aplikohen modele partneriteti për punësim si: kurse të termo-hidraulikës, trajnim të mesëm dhe post-sekondar për IT, bukëpjekës, pastičeri, parukeri, etj. Zvicra do të vazhdojë të mbështesë sektorin edhe për 4 vitet e ardhshme.
- Qeveria Austriake ka mbështetur kompanitë private me kurse trajnimi në profesionin e saldatorit, në të cilat kanë marrë pjesë 447 persona dhe janë çertifikuar sipas standardeve europiane 170 persona.

- Me mbështetje nga IPA 2013 me një vlerë prej 6.17 milion Euro, brenda vitit 2017 do të perfundojë ngritja e 4 qendrave të reja multifunkionale.
- **Barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës në familje** mbështet kryesisht nga Austria me një fond prej 1.6 milion Euro në formën e grantit.


Punësimi

Zhvillimi i kapaciteteve në zyrat e punësimit dhe lehtësimi i aksesit të të rinjve në tregun e punës përbën synimin kryesor të mbështetjes në këtë sektor, i cili ka përfituar një shumë të konsiderueshme, kryesisht grant për periudhën 2011-2016.

- Nëpërmjet projektit “Pakti i Punësimit territorial-TEP”, i financuar nga Qeveria Zvicerane me një vlerë prej 2.5 milion Euro në formën e grantit, janë krijuar Bordet Rajonale të Punësimit në Shkodër dhe Lezhë, si dhe janë miratuar e vënë në zbatim paktet përkatëse të punësimit; është siguruar punësimi dhe vetëpunësimi i 300 të rinjve, ngritja e dy kooperativave të kultivimit të peshkut si dhe përfshirja e 250 familjeve në sektorin e artizanatit.
- Qeveria Zvicerane aktualisht po mbështet projektin “Risi Albania” i cili synon rritjen e aksesit për punësim të 100,000 të rinjve (djem e vajza) në tregun e punës, si dhe sigurimin e punësimit për 11,000 të rinj gjatë periudhës 2014-2017 në 3 sektorë: përpunimi bujqësor, turizëm dhe TIK.

Planifikimi për vitet në vijim

Për vitet 2016-2020, financimi i huaj i planifikuar arrin vlerën prej rreth 36 milion Euro, në formën grant. Kjo mbështetje pritet të ketë impakt në krijimin e një sistemi modern të asistencës sociale, në rritjen e nivelit të kualifikimit të fuqisë punëtore dhe lehtësimin e aksesit të të rinjve në tregun e punës, forcimin e lidhjeve midis arsimit dhe punësimit, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara të grupeve në nevojë në aktivitete ekonomike e sociale.



Donatorët kryesorë që pritet të kontribuojnë në vitet në vijim janë BE me një financim prej rreth 30 milion Euro, Zvicra me një financim prej rreth 5 milion Euro dhe Austria.

Sektori që pritet të përfitojë financimin më të madh (rreth 96% të financimit total të planifikuar) është punësimi, nëpërmjet grantit të Bashkimit Evropian, të dhënë në formën e mbështetjes buxhetore


Projekte të Planifikuara

- Një projekt i rëndësishëm është ai i financuar nga IPA 2015 për të Mbështetur sektorin e Punësimit me një fond prej 30 Milionë Euro Grant, projekti pritet të përfundojë në vitin 2020;
- Në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe aftësive për punë është planifikuar projekti i financuar nga Zvicrra me një vlerë 5.16 Milionë Euro Grant.
- Austria pitet të financoj në disa sektorë: Përmirësimin e kushteve të jetesës dhe riintegrimin e fëmijëve emigrant në Shqipëri (450.000 Euro Grant) ; Al-Tour: Mbështetja dhe qasja e Edukimit dhe Formimit Turizmit (845.000 Euro Grant) dhe Mbeështetja e Qeverisë Shqipëtare për të përvetësuar Barazinë Gjinore të BE.


Niveli i disbursimit duke përfshirë edhe vitin 2015 është 36.7 milionë Euro (ose 43,5% e fondeve të angazhuara). Kjo tregon se edhe ky institucion ka një nivel relativisht të ulët disbursimi. Nga pyetsorët e mbledhur si dhe nga intervistat e kryera rezulton se problematikat kryesore që kanë ndikuar në këtë nivel të ulët disbursimi lidhen kryesisht me mos koordinimin midis donatorëve në rastin e bashkëfinancimit të projekteve të përbashkëta sic ka ndodhur në rastin e Bankës Botërore dhe Komisionit European për projektin e përbashkët “Mbështetje për modernizimin e sistemit të asistencës sociale në Shqipëri”, ku ka patur mjaft vonesa në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet tyre. Po ashtu, projekti “Korpusi i vullnetarëve shqiptar” ka hasur problematika gjatë zbatimit të projektit kryesisht nga mungesa e paketave ligjore të caktuara, dhe më specifikisht të ligjit të vullnetarizmit.

Ministria e Mjedisit (MM)


Mbështetja e donatorëve për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm përfshin mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi, ruajtjen e biodiversitetit, reduktimin e emisioneve të CO₂, menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe ujërave, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, arritjen e standarteve të kërkuara nga Bashkimi Europian dhe përmirësimin e shërimeve mjedisore.



Totali i financimit me asistencë të huaj ku përfitues është Ministria e Mjedisit është rreth 50 milion Euro, të angazhuara në 20 projekte në vazhdim për periudhën 2011-2019. Ndërkohë është në proces planifikimi edhe 1 projekt tjetër me një total financimi prej rreth 500.000 Euro. rreth 82% e financimit në zbatim që përkon me 49.9 Milion Euro jepet në formën e grantit financiar nga donatorë si Suedia, Gjermania, Banka Botërore, IPA etj. dhe rreth 18% ose 9 Milion Euro jepet në formën e kredisë së butë



Donatorët kryesorë në sektor janë Austria, Gjermania, Banka Botërore dhe BE nëpërmjet instrumentit IPA



Fushat që përfitojnë pjesën më të madhe të financimit janë: Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura (33%) dhe Mbrojtja e Mjedisit (27%). Gjithsejt financimet parashikohen të shtrihen në 5 fushat. Me nivele të ndryshme financimi.

Ruajtja e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura

Është sektori që ka përthithur më shumë fonde, rreth 16.5 milion Euro grant për periudhën 2011-2017 nga donatorë si BE/IPA, Gjermania dhe Italia. Fokusi i mbështetjes lidhet kryesisht me përgatitjen e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura (PMZM) dhe vënia në zbatim e tyre, përgatitjet për përfshirjen e zonave të tjera si zona të mbrojtura, konservimi dhe promovimi i vlerave natyrore, rritja e të ardhurave të banorëve në zonat rurale nëpërmjet zhvillimit të turizmit dhe agrobiznesit, si dhe lidhjen e produkteve lokale me tregjet rajonale. Ndër projektet më të rëndësishme përmenden:

- “Monitorimi i zonave të mbrojtura” me financim nga IPA 2013 prej 4 milion Euro
- “Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit”, financuar nga Italia me një vlerë prej 2.2 milion Euro.
- “Rezervati Biosferik Ndërkufitar i Prespës” financuar nga Gjermania me 6.5 milion Euro, ka mbështetur PMZM të Parkut Kombëtar të Prespës.
- “Konservimi i agrobiodiversitetit në zonat rurale të Alpeve”, financuar nga GIZ me 2 milionë Euro për krijimin e dy parqeve natyrore rajonale në zonën e Shkrelit dhe Lekbibajt.
- “Natyra 2000”, financuar nga IPA 2013 me 4.4 milionë Euro. Projekti synon të mbështesë zbatimin e PMZM-ve ekzistuese në 5 zona të mbrojtura dhe përgatitjen e projekteve në fushën e biodiversitetit si dhe krijimin e rrjetit Natyra 2000.
- “Përmirësimi i qeverisjes së trashëgimisë së përbashkët natyrore dhe kulturore ndërkufitare të Rajonit të Liqenit të Ohrit” financuar nga IPA 2013 dhe zbatuar nga UNDP me 1.7 milionë Euro.
- “Përmirësimi i efektivitetit të mbulimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura detare (ZMD)” financuar nga GEF dhe zbatuar nga UNDP me 0.8 milionë Euro për përgatitjen e PMZM-ve në Karaburun-Sazan si dhe shpalljen e Zonave të Porto-Palermos dhe Kepit të Rodonit si ZMD.

Mbrojtja e mjedisit

Është një fushë që ka përfituar rreth 13.5 milion Euro për periudhën 2014-2019.

- Projekti më i rëndësishëm është projekti ESP i cili do të bëjë një menaxhim të qëndrueshëm të mjedisit shqipëtar, i financuar nga Banka Botërore me 9 milionë Euro kredi.
- Një tjetër projekt është “Mbështetja për minimizimin, riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve në Shqipëri” i financuar nga qeveria Japoneze me 2.41 milion Euro. Ai konsiston në sigurimin e mbështetjes për bashkitë Lezhë, Durrës dhe Tiranë në formulimin dhe vënien në zbatim brenda vitit 2017 të Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Kjo fushë ka përfituar rreth 7.38 milion Euro grant për periudhën 2012-2016, kryesisht nëpërmjet tre projekteve të financuara nga Gjermania (GIZ), Suedia dhe Kombet e Bashkuara. Projektet kryesore aktualisht në zbatim janë:

- “Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor (CCAEB)”, financuar nga GIZ me 3.5 milion Euro për periudhën 2012-2018. Përgatitja e 8 planeve vendore për menaxhimin e përmbytjeve do të sjellë impakt në nivel vendor, ndërsa në nivel qëndror do të

sigurohet një plan lidhur me adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, dhe në nivel rajonal shërbimet hidrometeorologjike do të kenë një sistem paralajmërimi të hershëm për përmbytjet në lumin Drin si dhe të dhëna në kohë reale.


- “Menaxhimi i burimeve natyrore”, financuar nga Suedia me 1.9 milion Euro. Pritet të përfundojë në dhjetor 2016.
- “Ndryshimet Klimatike”, financuar nga Kombet e Bashkuara me 1.8 milion Euro.

Sektori i pyjeve

Sektori i Pyjeve ka përthithur një financim prej rreth 4.7 milionë Euro në formën e grantit për periudhën 2014-2019 nëpërmjet projektit: “*Forcimi i qendrueshmërisë së pyjeve*”, i financuar nga Suedia. Projekti fillojë zbatimin në Janar 2015 dhe lidhet me përmirësimin e shërbimeve mjedisore. Ai pritët të ketë impakt në përmirësimin e praktikave në menaxhimin e tokës dhe regjistrimin e pyjeve dhe kullotave, rritjen e përfitimeve monetare dhe jomonetare në 310 komuna rurale dhe 2980 fshatra të vendit, rritjen e cilësisë së ujit dhe parandalimin e përmbytjeve për një zonë me më shumë se një milion banorë.

Planifikimi për vitet në vijim

Në vitin 2017 pritët të fillojë 1 projekt i ri me një vlerë rreth 0,5 milion Euro në formën e grantit, të financuar nga Gjermania për periudhën 2017-2018. Financimi i planifikuar mbulon fushën e biodiversitetit. Më konkretisht projekti lidhet me Ruajtjen dhe përdorimin e qendrueshëm të biodiversitetit në zonën e 3 liqeneve – Faza II”, financuar nga GIZ.




Vërehet se totali i disbursimeve të deri më tani (përfshirë edhe vitin 2015) është rreth 46% kundrejt totalit të angazhimeve për projektet në vazhdim. Megjithatë mjaft projekte madhore kanë filluar gjatë këtij viti dhe pritët që në fund të periudhës 2016-2017 të rritet niveli i disbursimit.

Problematikat kryesore që kanë rezultuar nga përpunimi i të dhënave të mbledhura nga pyetsorët dhe intervistat e kryera lidhen kryesisht me mungesën e kapaciteteve teknike dhe financiare të institucioneve që kanë sjellë vonesa në zbatimin e projektit të “Biodiversitetit në zonën e 3 liqeneve”- financuar nga GIZ. Poashtu vonesa janë hasur në procesin e disbursimit të fondeve psh. Per projektin e Shërbimeve Mjedisore. Një problematikë tjetër është mungesa e stafit si dhe largimi i stafit të trajnuar dhe zëvendësimi i tij me personel të pakualifikuar, hasur në projekte si “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor” dhe në projektin “Rezervati Biosferik Nderkufitar i Prespes – Mbeshtetje për Parkun Kombëtar të Prespes në Shqipëri”.



Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU)

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave ka si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm rural, përmes rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, përmirësimit të infrastukturës së ujitjes dhe kullimit, menaxhimit të veprimtarisë së peshkimit, si dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatorit. Donatorët dhe partnerët për zhvillim mbështesin aktualisht 25 projekte në mbështetje të sektorëve të sipërpërmendur, dhe janë programuar 3 projekte të reja që pritet të fillojnë në prill të viti 2016.



Totali i fondeve të angazhuara për projektet në vazhdim me financim të huaj është rreth 124 milion Euro (46 milion Euro kredi dhe 78 milion Euro grant).

Partnerët më të rëndësishëm janë: BE/IPA me një financim prej rreth 45 milion Euro, Banka Botërore me 36 milion Euro, Gjermania/GIZ me një financim prej 13.1 milion Euro, Italia me 11.1 milion Euro, dhe Danimarka me 10.6 milion Euro.



Fushat e mbështetjes.

Sektorët më të rëndësishëm që mbështeten aktualisht me asistencë të huaj jepen në grafik.

Rritja e konkurrueshmërisë rurale

Kjo fushë aktualisht përfiton një financim total prej 14.4 milion Euro të financuara nga Gjermania/GIZ, Zvicra dhe SHBA/USAID. Kontributin më të rëndësishëm e jep GIZ me 13.1 milionë Euro, nëpërmjet programit “Zhvillimi i konkurrencës në zonat bujqësore” i cili pritet të përfundojë në vitin 2018.

Sektori i agrobiznesit

- Në këtë fushë janë investuar 35.6 milionë Euro. Projektet më të rëndësishme janë:
- “Promovimi i konkurrencës në zonat bujqësore”, e financuar nga Danimarka me 10.6 milion Euro grant;
- “Mbështetja e bujqësisë dhe e zonave rurale”, projekt i financuar nga IPA 2011 me 10 milion Euro
- Projekti “Forcimi i agjensisë së pagesave Shqipëtare (ARDA)”, e financuar nga Italia me 5 milion Euro.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Kjo fushë ka përfituar një mbështetje prej 12 milion Euro për periudhën 2012-2019. Ndër projektet më të mëdha janë:

- Projekti “Mbrotja e konsumatorit nga fatkeqsitë zoonotike” financuar nga IPA 2012 me një vlerë prej 2.44 mln Euro
- Projekti i financuar nga USAID për “Fuqizimin e fushave kryesore të bujqësisë”.
- Projekti “Mbështetje për Modernizimin e Sektorit të Blegtorisë” prej 1.8 milionë Euro (IPA 2013). Ky projekt ka për qëllim rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe eficiencës së prodhimit blegtoral në Shqipëri nëpërmjet zbatimit të politikave dhe praktikave të duhura racore. Projekti pritet të përfundojë në janar 2017.

Ujitja dhe kullimi

Për periudhën 2013-2018, kjo fushë është mbështetur kryesisht nëpërmjet projektit “Burimet Ujore dhe Kullimi”, i bashkëfinancuar nga Banka Botërore dhe Suedia me 39.7 milionë Euro. Projekti synon të krijojë një kuadër strategjik për të menaxhuar burimet ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drin - Bunë dhe Seman si dhe të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme, performancën e sistemeve të ujitjes. Deri tani, ka filluar puna për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe projekteve të zbatimit për sistemet e ujitjes dhe kullimit. Poashtu, është nënshkruar kontrata për rehabilitimin e 11 digave, dhe ka përgatitja e planeve të menaxhimit social-mjedisor në sistemet e ujitjes dhe kullimit.

Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit

Është mbështetur nga Bashkimi Evropian me 7.2 milionë Euro (IPA 2009, 2012, 2013) për periudhën 2012-2018. Nëpërmjet projektit “Mbështetje për Infrastrukturën e Sigurisë Ushqimore” është përfunduar ngritja e zyrave dhe laboratorëve rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) në 10 qarqe.


Sektori i menaxhimit të katastrofave

Në këtë sektor janë investuar 8.9 milion Euro IPA 2013 për “Përmirësimin e dëmeve bujqësore dhe rivendosjen e kapaciteteve prodhuese” me 2.5 milion Euro; si dhe “Parandalimin e përmbytjeve” me 6.4 milion Euro.

Planifikimi për vitet në vijim

Për vitet në vijim është planifikuar një financim prej rreth 22 milion Euro, të financuara nga BE / IPA 2016 të përqëndruara në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe më specifiku, rreth 13 milion Euro për projektin IPARD që ka si qëllim zhvillimin e sektorit të bujqësisë, rritjen e konkurrueshmërisë, zhvillimin e sektorit agro-ushqimor dhe ekonominë rurale; dhe rreth 9 milion Euro për projektin “Peshkim dhe Siguri Ushqimore”.

Deri në fund të vitit 2015, ky institucion ka disbursuar rreth 47 milionë Euro ose rreth 38% të fondeve të angazhuara.




Nga analiza e të dhënave të pyetsorëve dhe intervistat e kryera rezulton se kjo përthithje e ulët e financimit të huaj vjen si pasojë e disa problematikave dhe vonesave të hasura si shkurtimi i fondeve për financimin e huaj nga planifikimi fillestar që ka ndikuar në moskryerjen në kohë të pagesave të planifikuara dhe si rrjedhim uljen e disbursimit nga donatori në rastin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes financiar nga IBRD; probleme të


legjislacionit që lidhet me treguesit gjeografike si dhe institucionet e nevojshme për certifikimin dhe kontrollin e produkteve të hasura gjatë zbatimit të projektit “Ruajtja dhe Vlerësimi i Biodiversitetit: “Zhvillimi i Qendrushëm Rural në malet Ballkanike”, si dhe mangësi dhe dobësi në kuadrin kombëtar ligjor, administrativ dhe teknik, për të zhvilluar sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave, software IPARD-like me qëllim sigurimin e një menaxhim financiar dhe kontrolli të granteve sa më transparent dhe unik. Probleme janë hasur dhe nga mungesa e stafit të trajnuar për menaxhimin e disa projekteve.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS)

Ministria Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes është përfituese e një sërë projektesh në fushën e nxitjes së SME-ve, konkurrueshmërisë dhe qeverisjes së korporatave. Ministria ka në zbatim 20 projekte që përfshijnë periudhën 2009-2018 si dhe pritet të fillojnë 3 projekte të reja në vitin 2017.



Totali i fondeve të angazhuara aktualisht është 76 milion Euro, nga të cilat 33 milion Euro janë grante dhe 22.5 milion Euro kredi.



Donatorët kryesorë që kontribuojnë me projekte janë: Italia, Gjermania, Zvicra që mbulojnë rreth 90% të financimit total në zbatim.

Ndër projektet aktualisht në zbatim mund të përmenden:


- “Programi për zhvillimin e SME-ve (Linjë kredie prej 44.2 milion Euro, financuar nga Italia). Ky projekt mund të konsiderohet si një instrument i suksesshëm, i aftë të ofrojë likuiditetin e nevojshëm për SME-të Shqiptare duke u dhënë mundësinë të realizojnë planet e tyre të investimeve. Përmes këtij programi është mundësuar mbështetja e 102 sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushën e prodhimit, agro-përpunimit, ndërtimit, transportit, tekstileve, dhe përpunimit të drurit. Pjesa më e madhe e këtyre sipërmarrjeve janë përqëndruar në zonën Tiranë-Durrës duke vijuar në qytetet: Lushnje, Kavajë, Fier, Vlorë dhe Shkodër.
- “Programi i zhvillimit ekonomik dhe promovimit të punësimit”, financuar nga Gjermania/GIZ me një vlerë prej 13.9 milion Euro grant.
- Në kuadër të programit “Qeverisja e korporatave faza III” e financuar nga qeveria Zvicerane (3.1 milionë Euro për periudhën 2012-2017), është përgatitur kodi për “Parimet e drejtimit të

brendshëm të shoqërive tregtare”, dhe ai për bizneset familjare, si dhe manuali për qeverisjen e shoqërive tregtare. Gjithashtu është ngritur Instituti i Qeverisjes së Shoqërive Tregtare (Corporate Governance Institute), i cili ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence për shoqëritë tregtare përmes vlerësimit të performancës dhe riskut.

- “Programi për zhvillimin e SME-ve TAM/BAS”, e financuar nga IPA 2013 me një vlerë prej 2 milion Euro grant, i cili ka për qëllim ofrimin e shërbimeve këshilluese ndaj biznesit.
- “Programi ndërmarrësi” me një vlerë prej 2 milion Euro e financuar nga Zvicra. Projekti pritet të përfundoj në dhjetor të vitit 2018.


Planifikimi për vitet në vijim

Totali i fondeve që planifikohen të zbatohen për periudhën 2016-2020, arrin vlerën prej rreth 71 milion Euro, të financuara nga Banka Botërore, Gjermani/GIZ dhe USAID, prej të cilave 67,2 milion Euro do të jepen në formën e kredisë të butë nga Banka Botërore.



Projektet kryesore të planifikuara janë:

- “Programi për zhvillimin të konkurrencës” e financuar nga Banka Botërore me 67.2 milion Euro kredi, dhe që pritet të fillojë në janar të vitit 2017.
- “Mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit” me një fond prej 2.7 milion Euro grant të financuar nga USAID.
- “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE”, financuar me një grant prej 1 milion Euro nga Gjermania/GIZ.



Niveli i disbursimeve (përfshirë edhe vitin 2015) është 51,6 milion Euro, i cili përbën rreth 69% të totalit të angazhimeve. Kjo do të thotë se ky institucion performën relativisht mirë në përthithjen e fondeve të huaja.


Një problematikë e hasur nga ky institucion, sic rezulton nga pyetsorët e mbledhur është mungesa e personelit të kualifikuar dhe vonesat në fazën e parë përgatitore të disa projekteve, sic është projekti: “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE” që ka filluar të përgatitet për zbatim së fundmi.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Mbështetja për reformimin e forcës policore, lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit si dhe forcimi i masave për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore përbën fokusin kryesor të asistencës së huaj për Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB).

Aktualisht kjo ministri ka 9 projekte në vazhdim me një total financimi prej rreth 17.05 milion Euro për periudhën 2012-2018. Rreth 17 milion Euro financohet nga BE/IPA dhe 0.05 milion Euro nga USAID në formën e grantit. Ndërkohë është planifikuar një fond prej 16.6 milion Euro për t'u zbatuar në periudhën 2016-2019.

Fushat e mbështetjes me asistencë të huaj janë jepen nga grafiku me poshtë. Si shihet pjesën më të madhe, rreth 84% e zë Policia dhe Lufta Kunder Krimit te Organizuar, Terrorizmit dhe Trafikimit, dhe 16% e zë Menaxhimi i Integruar i Kufirit.



Policia, lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

Ky sektor ka përfituar një total financimi në grant 13.81 milionë Euro për periudhën 2012-2019. Ndër projektet dhe arritjet më të rëndësishme në sektor mund të përmendim:

- Ndërtimi i kapaciteteve për reformën policore dhe rikonstrukcioni i tri objekteve të Repartit RENEA që pritet të përfundojnë brenda vitit 2017, përbëjnë fushat e mbështetjes së PAMECA IV (me financim nga IPA 2009 dhe 2012) me një fond prej rreth 5 milion Euro.
- Ndërtimi i Qendrës së Formimit Policor dhe ngritja e Qendrës Operacionale të Emergjencës në Tiranë – Linja 112, financuar nga IPA 2010 dhe 2011 me një fond prej 5.21 milion Euro.
- Ndërtimi i njësisë RENEA në Tiranë e financuar nga IPA 2013 me një fond prej 2.09 milion Euro.
- Projekti “Së bashku për të mbrojtur fëmijet”, financuar nga USAID me një fond prej 453,000 Euro.


Menaxhimi i integruar i kufirit

Ndër projektet kryesore listohen:

- Ndërtimi i Pikes Kufitare të Hanit të Hotit në Shkodër, financuar nga IPA 2012 me një fond prej 1,73 milion Euro.
- Ndërtimi i Pikes Kufitare të Morinës në Kukës, faza e dytë, financuar nga IPA 2012 me një fond prej 1.04 milion Euro.

Planifikimi për vitet në vijim

Në vitet në vijim është planifikuar një financim total prej rreth 17 milion Euro në formën e grantit nga BE dhe Suedia.



Projekti më i rëndësishëm është ai PAMECA (zgjatje e projektit aktual) në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit, i financuar nga IPA 2015 me një fond prej 13 milion Euro grant. Ndërsa, Ambasada Suedeze ka planifikuar të vijojë mbështetjen me një fazë të dytë të projektit “Policimi në komunitet” për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të Policisë Shqiptare dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit dhe policisë së shtetit me një total prej 2.6 milion Euro.

Niveli i disbursimit, duke përfshirë edhe vitin 2015 është rreth 8.6 milion Euro ose 50.3% e totalit të angazhimeve.


Nga të dhënat e mbledhura rezulton se problematikat kryesore që kanë ndikuar në nivelin e disbursimit janë vonesat e hasura në përfundimin e procedurave të kontraktimit nga donatori, dhe me miratimin e lejes së ndërtimit, kryesisht për projektin e Rinovimit të Pikës Kufitare të Hanit të Hotit.

Ministria e Kulturës (MK)

Mbrojtja, kujdesi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore përbën fokusin kryesor të mbështetjes me asistencë të huaj, ku përfitues direkt apo indirekt është Ministria e Kulturës. Aktualisht kjo ministri ka 2 projekte në vazhdim.

Totali i financimit në grant për projektet në vazhdim arrin në 912,000 Euro për periudhën 2015-2017, financuar nga Bashkimi Evropian. Nëpërmjet kësaj mbështetje është bërë i mundur restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar në fushën e zbatimit të praktikave të sukseshme të restaurimit dhe konservimit të trashëgimisë kulturore.

Fushat e mbështetjes me asistencë të huaj jepen në grafikun më poshtë ku shihet se 85% e fondeve janë përqëndruar në fushën e Kulturës dhe 15% në fushën e Trashëgimisë Kulturore.



Kultura zë peshën më të madhe të financimit me një total prej 780.000 Euro në zbatim, financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet instrumentit CARDS, për periudhën 2015-2017, që shkojnë kryesisht për financimin e projektit për rehabilitimin e Manastirit të Shën Mërisë, muzealizimin i pejsazhit, dhe sitit arkeologjik të Apollonisë, Fier. Gjithashtu, po hartohet projekti për rehabilitimin dhe zgjerimin e Librarisë Kombëtare të Shqipërisë.

Disa projekte të përfunduara dhe disa arritje mund të përmenden si më poshtë:

- Si rezultat i mbështetjes së Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), ka përfunduar restaurimi i 4 xhamive, objekte kulturore të kategorisë së parë, dhe pritet të përfundojë një tjetër brenda këtij viti.
- Me mbështetje nga UNESCO, është restauruar dhe kthyer në muze banesa e Kadaresë në Gjirokastrë.
- Është transformuar Fototeka Kombëtare “Marubi” në një institucion bashkëkohor, ku PNUD ka mbështetur punën e stafit të Fototekës për dixhitalizimin e 100 mijë negativëve dhe realizimin e Muzeut Virtual Marubi.

-
- Janë rehabilituar monumentet e kulturës si: Manastiri i Apollonisë, përmirësimi i sinjalistikës në Kalanë e Lezhës (mbështetur nga BE) si dhe përmirësimin e zonës turistike në Pazarin e Vjetër të Krujës (Fondi i Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan-AADF).


Niveli i disbursimit (përfshirë edhe vitin 2015) është rreth 10%, kjo për shkak se projektet aktualisht në zbatim janë projekte që kanë filluar kryesisht në vitin 2015-2016.

Nga pyetorët dhe intervistat, arrihet në përfundimin se kjo ministri ka hasur mjaft problematika e vonesa në të kaluarën që lidhen kryesisht me ristrukturimin apo zgjatjen e afatit të projekteve si në rastin e projektit “ADRIFORT- Adriatic Fortresses and Military Areas” apo në rastin e projektit “Restaurimi dhe konservimi i kalave tre dhe kater kendore” Butrint, Sarande. Janë hasur dhe vonesa në fazën e projektimit të projekteve kryesisht për shkak të marrjes së disa lejeve të ndërtimit si në rastin e projektit “Restaurimi dhe konsolidimi i Manastirit të Shën Marisë në Apolloni”.


Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU)

Planifikimi urban dhe strehimi janë fushat kryesore të mbështetjes me asistencë të huaj të përfituar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Aktualisht kjo ministri ka një projekt në zbatim me vlerë prej rreth 1 milion Euro grant dhe 2 projekte madhore me një total financimi prej rreth 29 milion Euro kredi të cilët janë mbyllur gjatë vitit 2015.

Donatorët më të rëndësishëm janë Banka Botërore (14.3 milion Euro në bashkëpunim me donatorë të tjerë), Banka Qendrore Europiane - CEB (kredi 15 milion Euro) dhe Gjermania (grant 1 milion Euro).



Fushat e mbështetjes me asistencë të huaj jepen në grafikun më poshtë. Sic shihet financimi është i ndarë pothuaj në mënyrë të barabartë midis dy sektorëve: Planifikimi dhe Zhvillimi Urban dhe Strehimi.



Planifikimi urban është sektori që ka përfituar një financim prej rreth 15.2 milion Euro kredi nëpërmjet projektit për Menaxhimin e Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare i cili ka përfunduar në vitin 2015 dhe ka përfshirë komponentët si më poshtë:

- Punimet në portin dhe në rrjetin e Ujesjellës-Kanalizime në Sarandë,
- Ndërtimi i objektit të presimit të mbetjeve të rrezikshme në Porto Romano,
- Zbatimi i 9 projekteve për rehabilitimin e rrugëve e shesheve të fshatrave,

- Përfundimi i 5 nënprojekteve për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të fshatrave të Bregdetit të Jugut.
- Punimet për vendgrumbullimin e mbetjeve Bajkaj-Palavli dhe në Stacionin e Transferimit.


Spektori i strehimit është financuar nga CEB me 15 milionë Euro kredi (2006 – 2016) për ndërtimin e 1138 banesave sociale në 8 bashki të vendit. Projekti ka përfunduar në vitin 2015.

Planifikimi për vitet në vijim

Planifikimi dhe Zhvillimi Urban është sektori që do të përfitojë fondet e planfikuar në vitet në vijim, me një total financimi 57.67 milionë Euro kredi, për periudhën 2017-2020. Projekti i planifikuar është “Zhvillimi i integruar ekonomik dhe urban”, i financuar nga Banka Botërore i cili ka si objektiv përmirësimin e infrastrukturës urbane, rritjen e aseteve kulturore, dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të mbështetur zhvillimin ekonomik lokal në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Gjithashtu, është planifikuar të financohet nga GIZ me 1 milion Euro grant (për periudhën 2017 – 2018) faza e dytë e projektit aktualisht në zbatim “Zhvillimi i Integruar i qëndrueshëm i rajonit bregdetar në Shqipëri”. Projekti pritet të kontribuojë në hartimin e perspektivave për zhvillim brenda kornizës së Planit të Menaxhimit Bregdetar si dhe për të dhënë një shembull të zhvillimit të integruar të rajonit bregdetar në zonat pilot.


Niveli i disbursimit, duke përfshirë edhe vitin 2015 është 28 milion Euro ose 92% e totalit të angazhimeve duke përfshirë këtu dhe dy projektet madhore që kanë përfunduar në vitin 2015.




Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Infrastruktura lokale ka përfituar investime të konsiderueshme gjatë viteve 2013-2015 duke ndikuar ndjeshëm në rehabilitimin dhe rindërtimin e rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, si dhe duke përmirësuar aksesin në ujë e pijshëm nëpërmjet rehabilitimit ose rindërtimit të skemave të ujësjellësive rurale me rrjedhje të lire dhe tarifa që mbulojnë kostot nga pikpamja sociale. Fondi Shqiptar i Zhvillimit si përfituesi direkt i këtyre investimeve, ka në zbatim 14 projekte dhe 2 projekte të planifikuara për vitet në vijim.


Totali i financimit të huaj për projektet në vazhdim arrin vlerën prej rreth 159.5 milion Euro nga të cilat 70.7 milion Euro ose 44% janë grante dhe 88.6 milionë Euro ose 56% janë kredi.



Donatorët kryesorë që financojnë me projekte aktualisht në zbatim për këtë institucion janë BE, Gjermania dhe Banka Qëndrore Evropiane (CEB), sic shikohet dhe në grafikun më poshtë.



Fushat e mbështetjes: Në grafikun më poshtë tregohen fushat më të rëndësishme të mbështetjes me asistencë të huaj.



Transporti

Rehabilitimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal zë peshën më të madhe të financimit në zbatim me rreth 60% të financimit total ose rreth 95.2 milion Euro. Si rezultat i financimit të huaj, deri më tani janë rehabilituar dhe rindërtuar mbi 1,200 km rrugë dytësore dhe lokale. Ndër projektet me vlerë më të madhe financimi radhiten:

- Projekti për Përmirësimin i Rrugëve Dytësore dhe Lokale, bashkëfinancuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Bashkimi Evropian (IPA 2009-2010-2011) me një total prej 34.5 milion Euro. Projekti ka filluar në Mars të vitit 2010 dhe përfundon në Mars të vitit 2017. Janë bashkëfinancuar gjithsej 57 segmente rrugore në të gjithë vendin ose rreth 525 km. Projekti ka pasur një impakt të ndjeshëm për rreth 290 mijë banorë në të gjithë vendin. Disa nga përfitimet imediate janë: rritja e aksesit në shërbimet jetësore bazë (spitale, shkolla); rritja e aksesit drejt tregjeve rajonale, lokale dhe zonave turistike; nxitja e zhvillimit ekonomik në zona me dendësi të madhe të popullsisë dhe prodhimit të lartë bujqësore dhe blegtorale; shkurtimi i kohës së udhëtimit me 60%, krahasuar me kohën përpara investimit dhe rritja e volumit të trafikut me rreth 20% në rrugët e rikonstruara.
- Projekti për Përmirësimin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale bashkëfinancuar nga Banka e Këshillit të Evropës (CEB) dhe Norëay Trust Account me një total prej rreth 37.7 milion Euro. Projekti ka filluar në janar të vitit 2009 dhe pritet të përfundojë në mars të vitit 2017. Qëllimi i projektit është promovimi i zhvillimit të qendrueshëm social dhe ekonomik në zonat e izoluar rurale të vendit, përmirësimi i aksesit dhe inkurajimi i zhvillimit ekonomik. Janë financuar gjithsej 32 segmente rrugore në të gjithë vendin ose rreth 250 km.
- Projekti SIF IV, i financuar nga Gjermania/KfE me një fond prej 20 milion Euro kredi. Projekti konsiston në rehabilitimin ose rikonstruksionin e 100 km të rrjetit rrugor rural, ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale, dhe ndërtimin dhe rehabilitimin e kanalizimeve në zonat e ndërhyrjes si Qarqet e Shkodrës, Kukës dhe Dibrës.
- Ndërtimi i lungomares në Vlorë me një kosto prej 12 milion Euro, mbulohet nga fondet e Bashkimit Evropian. Ky projekt ka filluar në Qeshor të vitit 2015 dhe pritet të përfundojë në shtator të vitit 2017.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Në këtë sektor janë anagazhuar rreth 64.2 milionë Euro (kredi e butë). Projektet më të rëndësishme janë:

- Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale. Ndërtimi dhe rehabilitimi bazë i objekteve të kanalizimeve, financuar nga Gjermania/KfE me një fond prej 34.5 milionë Euro.
- “Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale”, financuar nga IPA 2013 dhe zbatohet përmes marrëveshjes së deleguar të Gjermani/KfE, me një fond prej 10 milionë Euro grant. Projekti ka filluar në 2014 dhe pritet të përfundoj në 2020.
- Dy projekte të financuara nga Austria në formë kredie janë:
 - “Përmirësimi i sistemit të ujrave të zeza në Bilisht”, me një fond prej 2.99 milionë Euro;
 - “Furnizimi me ujë dhe kanalizime në Peshkopi”, me një fond prej 4 milionë Euro.

Planifikimi për vitet në vijim


Donatori që pritet të kontribuoj në vitet në vijim është Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), projekti do të fokusohet në ndërtimin e 40 godinave të reja shkollore për 30 000 nxënës të vendosur në zonat me dendësi të lartë urbane në zonën "Tiranë-Durrës"

Poashtu, një projekt tjetër që **planifikohet** të mbështetet me financim të huaj është përmirësimi i shërbimeve publike sociale dhe infrastrukturës së zonave periferike të Tiranës dhe Durrësit për grupet në nevojë. Në këtë kuadër janë planifikuar 6.4 milionë Euro grant që menaxhohen nga delegacioni i BE-së, për të ndërtuar një qendër të kujdesit ditor për fëmijë, kopësht, shkollë fillore dhe një qendër sociale multifunksionale së bashku me ndërtimin e rrugës dhe trotuareve pranë kopshtit.


Deri në fund të vitit 2015 janë disbursuar në total 68.14 milionë Euro, ose rreth 43% e totalit të angazhuar. Duhet përmendur këtu se kjo shifër e ulët, në rastin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit nuk reflekton përthithjen e ulët të fondeve. Përkundrazi, ky institucion është ndër institucionet që ndër vite ka performuar më mirë se shumë nga insitucionet e tjera që përfitojnë ndhmë të huaj. Përqindja e ulët e disbursimit, vjen kryesisht si rezultat i fillimit të projekteve relativisht madhore në vlerë gjatë viteve 2014-2015, të cilat janë ende në një fazë përgatitore ose të fillimit, dhe si pasojë dibursimi i fondeve nuk ka filluar ende, ose është relativisht i ulët.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS)

Mbështetja me financim të huaj e përfituar nga Ministria e Arsimit ka ndikuar në zhvillimin e infrastrukturës arsimore, përmirësimin e cilësisë së kushteve të të mësuarit për nxënësit, rritjen e regjistrimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor sipas standarteve evropiane.




Totali i financimit të huaj për projektet në vazhdim arrin në vlerën prej 12.7 milion Euro nga të cilat 9.2 milion Euro janë grante dhe 3.5 milion Euro janë kredi.



Donatorët kryesorë që mbështesin me financim të huaj për zbatimin e projekteve për këtë institucion janë Austria, Italia, UN (OKB) dhe BE

Fushat e mbështetjes: Në grafikun më poshtë tregohen fushat më të rëndësishme që mbështeten aktualisht me asistencë të huaj.




Arsimi zë peshën më të madhe me një financim prej rreth 8.3 milion Euro. Projekte me rëndësi të vecantë në sektori rradhiten:

- Projektet “Tempus” me një vlerë totale prej 2 milion Euro të financuar nga BE, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në modernizimin e IAL-ve shqiptare dhe përafrimin e tyre me standardet e simotrave evropiane. Falë tyre, janë trajnuar një pjesë e mirë e stafëve akademike, janë blerë pajisje të reja laboratorike, është lehtësuar implementimi i reformës së arsimit të lartë nga pikpamja e sigurimit të cilësisë, janë krijuar qendrat e karrierës si dhe janë zhvilluar dhe modernizuar metodologjitë e mësimdhënies.
- Projekti “Krijimi i një rrjeti telematik midis universiteteve shqiptare” financuar nga qeveria Italiane nëpërmjet një granti me vlerë 4 milion Euro. Qëllim i këtij projekti është themelimi për herë të parë në Shqipëri i Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) i cili lidh institucionet e arsimit të lartë me institutet kërkimore shkencore dhe më tej me Rrjetin Paneuropian të Kërkimit dhe Edukimit “GÉANT”.
- Projekti për Arsimin i financuar nga Kombet e Bashkuara (UN) me një vlerë prej 2.1 milion Euro grant. Projekti ka filluar në janar të 2015 dhe pritet të përfundojë në dhjetor të 2016.

Informacionit dhe telekomunikacionit, përfshihet projekti i financuar nga Austria me një fond prej 3.5 milion Euro grant. Projekti “Zhvillimi i E-Government në arsim”, kjo është pjesë e mbështetje paketës TIK prej 40 milionë euro, i cili ka si qëllim modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri.

Deri në fund të vitit 2015 janë disbursuar në total rreth 9 milion Euro ose rreth 69.6% e financimit të angazhuar dhe aktualisht në zbatim.



Nga të dhënat e mbledhura nga pyetsorët dhe intervistat rezulton se ky institucion ka hasur disa problematika që lidhen me zbatimin e projekteve me financim të huaj. Disa nga këto problematika mund të rradhiten si më poshtë:

“Programi për cilësi në arsim dhe barazi”: Një sërë reformash të synuara nga ky projekt janë arritur vetëm pjesërisht. Financimet nga buxheti i shtetit kanë rezultuar të pamajftueshme për mbajtjen e infrastrukturës dhe lidhjeve me internetin. Problematikë ka qënë dhe *mungesa e mekanizmave ligjorë* për të mbajtur të përgjegjshëm organet e pushtetit vendor.

Projekti “Tempus” - Janë hasur dy problematika kryesore:


- *Mos përjashtimi nga pagesa e TVSH për pajisjet e blera në kuadër të projekteve. Në zbatim të ligjit nr. 9840, dt 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të parazgjerimit IPA” pajisjet që blihen në kuadër të programit Tempus përjashtohen nga pagesa e TVSH-së.*
- *Vështirësitë dhe vonesat procedurale me Ministrinë e Financës për hapjen e llogarive të posaçme në EURO për çdo projekt të veçantë.*

Projekti “Arsimi Universitar: Krijimi i një Qendre Shërbimesh dhe Rrjeti Telematik për universitetet”


- *vonesa në zbatim, në ngritjen e Qendrës Ndëruniversitare, në tenderimin e asistencës teknike, probleme me angazhimin e dy prej tre universiteteve pilote, mungesë e stafit, mungesa e akteve nënligjore për Qendrën për të gjitha IAL publike.*

Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Mbështetja me financim të huaj për Ministrinë e Shëndetësisë është fokusuar kryesisht në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor, mbështetje për përmirësimin e shërbimit shëndetësor sekondar, rritjen e aksesit për këto shërbime, ngritjen e qendrës së Telemjeksisë dhe E-shëndetësisë. Ministria aktualisht ka në zbatim 10 projekte.



Totali i fondeve të angazhuara për projektet në vazhdim është 86.5 milionë Euro nga të cilat 14.4 milionë Euro janë grante dhe 72 milionë Euro janë kredi. Donatorët kryesorë janë: Banka Botërore (36 milionë Euro), Austria (15.9 milionë Euro), Italia (10.2 milionë Euro), CEB (10 milionë Euro) Zvicra (8 milionë Euro), Kombet e Bashkuara (4.15 milionë Euro) dhe USAID (2 milionë Euro).




Disa prej projekteve madhore të financuara në fushën e shëndetësisë rradhitën:

- “Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë”, kredi e financuar nga Banka Botërore me një fond prej 36 milion Euro kredi. Projekti fokusohet në përmirësimin e shërbimeve spitalore, zgjerimin e sistemit të menaxhimit të informacionit shëndetësor/HMIS, reformimin e financimit shëndetësor për zgjerimin dhe përmirësimin e performancës.
 - Projekti ka nisur në shkurt të 2015 dhe pritet të përfundojë në vitin 2021.
 - “Rehabilitimi i Qendrës Kombëtare të Traumës”, me një fond prej 5.1 milion Euro e financuar nga Italia. Ky projekt ka për qëllim sigurimin e kujdesit cilësor për pacientët me trauma të shumta në Qendrën Kombëtare të Traumës përmes furnizimit e pajisjeve, mirëmbajtjes së materialeve dhe të trajnimit profesional.

- “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”, kredi e financuar nga Italia me një fond prej 5.08 milionë Euro. Projekti ka si qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetsore në 5 poliklinika (N.2 dhe N.3 në Tiranë, Korçë, Peshkopi dhe Gjirokastrë) në drejtim të aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara, punimet rehabilituese dhe furnizimit me pajisje.
- “Mbështetja e sistemit të Shëndetsisë”, grant e financuar nga Zvicra me një fond prej 8.08 milion Euro. Qëllimi i përgjithshëm i programit është përmirësimi i qasjes në cilësi të lartë dhe më të mirë të shërbimeve shëndetsore të menaxhuara.
- “Reforma e programit të Qëndres Spitalore Universitare të Tiranës, faza e dytë”, me një fond prej 10 milion Euro e financuar nga CEB. Faza e Parë e projektit ka përfunduar në vitin 2010, duke mundësuar ndërtimin e një godine të re kryesore të spitalit dhe të ndërtesës teknike. Ndërsa nëpërmjet fazës së dytë synohet rehabilitimi i QSUT, duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme aksesin në kujdesin shëndetësor spitalor cilësor për popullsinë e Shqipërisë, nëse merret në konsideratë fakti që një pjesë shumë e madhe e pacienteve të cilët trajtohen çdo vit në këtë qendër spitalore vijnë nga jashtë Tiranës. Projekti ka filluar në janar 2015 dhe pritet të përfundojë në dhjetor 2016.
- “E-Shëndetsia (E-Health)”, kredi e financuar nga Austria me një fond prej 13.99 milionë Euro. Kjo është pjesë e mbështetje paketës TIK prej 40 milionë Euro.

Deri në fund të vitit 2015 janë disbursuar 28.1 rreth 32.5% të totalit të angazhuar për këtë institucion.




Vlen të përmendet se ky nivel i ulët disbursimi nuk përbën tregues të përthithjes dhe performancës së kësaj ministrie pasi një ndër projektet më madhore aktualisht në zbatim ka filluar në vitin 2015, dhe si rrjedhim nuk ka filluar ende disbursimi i fondeve për këtë projekt.

Nga të dhënat e mbledhura nga pyetsorët rezulton se janë hasur një sërë problematikash për këtë institucion që lidhen kryesisht me mungesa të personelit, mungesa të ambjenteve të përshtatshme për vendosjen e pajisjeve, mungesa e sistemeve të kondicionimit për pajisjet, aftësitë e limituara në përdorimin e kompjuterit të personelit si dhe mungesa të kuadrit ligjor për kryerjen e mbrojtjes së të dhënave personale shëndetsore, sic ka ndodhur në rastin e projektit “E-Shëndetsia”.

INSTAT

Statistika kombëtare përbëjnë një sektor të rëndësishëm, pasi bëjnë të mundur sigurimin e informacionit të nevojshëm dhe ndihmojnë proceset vendim-marrëse të të gjitha niveleve qeverisëse, partnerëve dhe publikut të gjerë, në zhvillimin e vendit. Mbështetja në sektor është përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve të INSTAT për përmirësimin e informacionit statistikor, analizimin dhe shpërndarjen në përputhje me standartet e BE, që ndikon drejtpërdrejtë në përgatitjen e vendit për sfidat që ka përpara lidhur me procesin e negociatave me BE.

INSTAT, si institucioni përgjegjës në sigurimin e statistikave kombëtare, përfiton aktualisht një mbështetje totale në grant prej 4.2 milion Euro, të angazhuara kryesisht nëpërmjet 3 projekteve në vazhdim për periudhën 2014-2020.




Më sipër jepet grafiku i volumit të angazhimeve sipas donatorëve, ku më të rëndësishmit janë Suedia dhe Bashkimi Evropian.

Suedia është donatori që ka anagzhuar më shumë fonde edhe në vitet e kaluara (4.5 milionë Euro) nëpërmjet Programeve “Mbështetje per Programin e Statistikave Kombetare, Statistikave Ekonomike dhe Censurit – Faza III” dhe “Mbështetje direkte për INSTAT” (2010-2014). Nëpërmjet tyre është mundur ngritja e kapaciteteve të INSTAT dhe përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor, kryerja me sukses i censurit të ndërmarrjeve dhe njësive ekonomike bujqësore, krijimi për herë të parë i regjistrit të ndërmarrjeve sipas standarteve të BE-së dhe publikimi i rezultateve nga të dy censuset duke siguruar një pasqyrë të plotë të situatës së ndërmarrjeve ekonomike e bujqësore në të gjithë vendin. Në vazhdim të kësaj mbështetje, është miratuar dhe është aktualisht në zbatim faza IV e programit të Statistikave Kombëtare me 2.7 milion Euro, duke ndihmuar INSTAT në statistikave ekonomike dhe bujqësore në përputhje me kërkesat e BE-së dhe për të përmirësuar mjedisin e saj IT dhe publikimin e të dhënave.

Zvicra ka mështetur Censurin e Popullsisë dhe Banesave me fokus në analizat e thelluara post-Census, kryerjen e anketës së matjes së varfërisë LSMS, si dhe publikimin e një serie prej 9 botimesh në shqip e anglisht.

Bashkimi European asiston aktualisht këtë institucion nëpërmjet projektit “*Përmirësimi i sistemit të informacionit statistikor*” me qëllim rritjen e efektivitetit të INSTAT për prodhimin, komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor, si dhe mundësimin e përdorimit sa më efikas të këtij informacioni nga qeveria dhe publiku me një vlerë prej 1.5 milion Euro për periudhën 2014-2017.


Totali i disbursimeve deri tani, (përfshirë edhe vitin 2015) arrin në 57.7% kundrejt totalit të angazhimeve për projektet në vazhdim.




Megjithëse nga analiza projekteve me financim të huaj rezulton se ky institucion ka patur në përgjithësi një nivel dibursimi dhe përthithjeje të kënaqshme ndër vite, nga pyetsorët e mbledhur dalin në pahë disa problematika të hasura si vonesa në fillimin e zbatimit të projektit sic ka ndodhur në rastin e projektit “Mbështetje për Përmirësimin e Sistemit të Informacionit Statistikor “ si dhe ndryshime të shpeshta të buxhetit në rastin e projektit “Financim direkt për një pjesë të shpenzimeve për Censusin e njësive ekonomike jo- bujqësore dhe Censusin e njësive ekonomike bujqësore (CAH)”

Ministria e Financave (MF)

Mbështetja me financim të huaj e përfituar nga Ministria e Financës ka ndikuar në forcimin e menaxhimit të financave publike, forcimin e regjimit rregullator dhe mbikëqyrës të sektorit financiar, rritjen e transparencës dhe thjeshtësinë e procedurave të administratës tatimore dhe doganore.




Totali i financimit të huaj për projektet në vazhdim arrin në 383.9 milion Euro nga të cilat 30.3 milionë Euro janë grante dhe 353.6 milion Euro janë kredi



Donatorët kryesorë, të cilët mbulojnë rreth 95% të financimit total, janë IMF, Italia dhe Bashkimi Evropian.

Fushat e mbështetjes. Në grafikun më poshtë tregohen fushat më të rëndësishme të mbështetjes me asistencë të huaj.



Menaxhimi i financave publike

Kjo fushë zë peshën më të madhe të financimit në zbatim. Si rezultat i financimit të huaj në këtë fushë është forcuar regjimi rregullator dhe mbikëqyrës të sektorin financiar. Ndër kontributet madhore në këtë fushë përmenden:

- Kredia prej 330.9 milionë Euro, financuar nga IMF, për mbështetje buxhetore që ka si qëllim zgjerimin e buxhetit.
- Grantet e Bashkimit European me një vlerë prej 6.2 milion Euro për binjakëzimin për të mbështetur kontrollin publik të brendshëm financiar dhe inspektimin financiar; për kontrollin e brendshëm të financave publike, kontrollit e lartë dhe anti korrupsionin; dhe forcimin e kapaciteteve të Njesisë së Financimit Qendror Kontraktuese (CFCU) për zbatimin efikas të fondeve të BE-së zgjerimin e sistemit të thesarit, fuqizimit të kapaciteteve të CFCU për zbatimin eficient të fondeve të BE-së.
- Një tjetër grant e financuar nga Zvicra me vlerë 1.9 milion Euro, për remitancat dhe pagesat përqëndrohet në mbështetjen e reformës territoriale dhe administrative në Shqipëri

Disa proekte madhore të përfunduara në këtë fushë mund të përmenden:

- Kredia prej 72.6 milion Euro, financuar nga Banka Botërore mbi Politikën e Zhvillimit të Borxhit (DPL) e cila synon forcimin e regjimit rregullator dhe mbikëqyrës të sektorit financiar si dhe zbutjen e dobësive të sektorëve bankare dhe jo-bankarë.
- Kredia prej 87 milion Euro nga Banka Botërore për fuqizimin e menaxhimit të financave publike duke pasur si qëllim përmirësimin i kuadrit fiskal dhe eliminimin e faturave të papaguara në të ardhmen.

Tatimet

Disa projekte madhore në fushën e tatimeve janë:

- Një ndër projektet madhore të financuar në **fushën e tatimeve** është “Zhvillimi i E-Qeverisjes në administrimin e taksave” (E-Taxation), me një vlerë prej 10.3 milionë Euro (kredi e butë) financuar nga Qeveria Austriake. Projekti ka përfunduar dhe është vënë në zbatim në vitin 2015. Ky projekt ka për qëllim të kontribuojë në trajtimin e drejtë, transparent dhe të barabartë të tatimpaguesve duke automatizuar shume procese që aktualisht kryhen me dore. Gjithashtu, ky sistem do t’i japë mundësinë tatimpaguesve që të kenë një pamje të plotë të situatës së tyre tatimore në sistem, si dhe të kenë mundësinë të ndryshojnë vetë deklaratat e tyre tatimore pa qenë nevoja t’i drejtohen inspektorëve tatimorë.
- Granti i financuar nga Zvicra me një vlerë prej 2.1 milionë Euro, Programi i thjeshtimit dhe transparencës së taksave në Europën Juglindore.
- Faza e tretë e bashkëpunimit ndërmjet administratave suedeze dhe shqiptare tatimore duke u fokusuar në arkivimin dixhital të taksapaguesve, shërbimeve dhe kadastrës fiskale, grant në vlerën 3.2 milion Euro.

Dogانات

Kjo fushë përfiton aktualisht grante të Bashkimit Europian me një vlerë prej rreth 10.8 milion Euro kryesisht për modernizimin e administratës doganore në funksion të Sistemit ITMS (Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave); Forcimi i kapaciteteve teknike dhe operacionale të Anti-kontrabandës Drejtorisë në luftën kundër kontrabandës; për furnizim me pajisje të Laboratorit të Doganave, për lidhjen e kontratave të binjakëzimit në fushën e analizës së riskut dhe përafrimit të legjislacionit me BE-në.

Mikrofinanca


Kjo fushë është mbështetur nga Banka Islamike për Zhvillim (IDB) me një vlerë prej 2.7 milion Euro në formën e kredisë së butë, kryesisht për sigurimin e një burimi të përballueshëm, gjithpërfshirës të financimit mikrofinanciar për segment e varfëra të popullsisë (sidomos femrat), kryesisht në zonat rurale dhe malore. Zbatimi i këtij projekti kontribuon në zhvillimin e 550 mikro ndërmarrjeve të reja, duke krijuar mundësi punësimi për rreth 6000 njerëz.

Marrëveshja "SWAP – Rikthimi i Borxhit" për zhvillimin e sektorit social me vlerë prej 20 milion Euro të financuara nga Qeveria Italiane, ka për qëllim mbështetjen e zbatimit të projekteve në sektorin social, propozuar nga institucionet përkatëse publike shqiptare të fokusuara në arsim, shëndetësi dhe gjenerim punësimi. Deri tani janë realizuar 2 thirrje për propozime dhe janë shpallur 13 projekte fituese (disa ende në zbatim; një pjesë të përfunduara) gjatë thirrjes së parë dhe 12 projekte fituese në thirrjen e dytë.


Zhvillimi i sektorit privat

Mbështetet aktualisht me një projekt të financuar nga Zvicra me një fond prej 2.2 milion Euro, i cili ka si qëllim përmirësimin dhe forcimin e zbatimit të raportimit financiar me cilësi të mirë me anë të ngritjes së kapaciteteve të kontabilitetit dhe auditimit në profesione, zbatimin më të mirë dhe monitorimin nga rregullatorët e raportimit të cilësisë financiare dhe transparencës publike të informacionit financiar të kompanive.

Planifikimi për vitet në vijim




Totali i financimit të huaj për projektet e planifikuara për vitet 2016-2019 arrin në vlerën prej 138.2 milion Euro, ku 42 milionë janë grante dhe 96.2 milion janë kredi.



Banka Botërore ka planifikuar projektin për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar, me një fond prej 96 milion Euro kredi e butë. Objektivi i këtij projekti do të jetë forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit financiar, kuadrin e sigurimit të depozitave, dhe rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, jo-bankare. Ndërsa, Bashkimi Europian (BE) do të kontribuojë me një fond prej 42 milion Euro për financimin e "Reformën e Sektorit të Menaxhimit të Financave

Publike", kjo është një mbështetje buxhetore për menaxhimin e financave publike (PFM), reformën për të siguruar disiplinën fiskale, menaxhimin më të kujdesshëm financiar dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike.



Deri në fund të vitit 2015 janë disbursuar në total 177.3 milion Euro, ose rreth 46.2% të financimit të angazhuar aktualisht. Ky nivel relativisht i ulët i dibursimit dhe përthithjes së fondeve të huaja, nga rezultatet e pyetsorëve dhe analizave të kryera, vjen kryesisht për shkak të problematikave të hasura si vonesa në prokurimin e pajisjeve hardware nga MF në rastin e projektit "Mbështetje për zgjerimin e sistemit të thesarit (SETS)" dhe projektit

"e-Taxation".

Problematikë tjetër përbën dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së projeteve të përfunduara si në rastin e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) pas përfundimit të projektit SETS si dhe përgatitja për mbajtjen në funksion të sistemit e-Taxation për periudhën pas përfundimit të projektit. Pra nuk nevojitet që institucioni, në këtë rast MF, të bëjë të mundur *sigurimin e fondeve të nevojshme buxhetore për të garantuar vazhdimësinë e projekteve për vitet në vitet në vijim*.

Një problematikë tjetër janë vonesat procedurale për shkak të mungesës së stafit të dedikuar dhe mbingarkesës së stafit aktual të ministrisë si në rastin e projektit të Marrëveshjes "SWAP – Rikthimi i Borxhit".

Ministria e Drejtësisë (MD)

Mbështetja me financim të huaj e përfituar nga Ministria e Drejtësisë ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe eficiencës së gjyqësorit, përmirësimin e standarteve të institucioneve të vuajtjes së dënimit, uljen e mbipopullimit në burgjet ekzistuese, dhe garantimin e të drejtave të pronësisë, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e tregut të tokës dhe te pasurive te paluajtshme, të investimeve të qëndrueshme mbi këto pasuri si nga sipërmarrja vendase apo e huaj ashtu dhe nga individët.

Totali i financimit të huaj për projektet në vazhdim arrin në 30.1 milion Euro në formën e grantit. Donatorët që mbështesin këtë institucion me financim janë Bashkimi Evropian dhe Zvicra.



Financimi në zbatim përqëndrohet kryesisht në përirësimin dhe forcimin e sistemit të drejtësisë dhe kryesisht në forcimin e sistemit penitenciar. Aktualisht kjo fushë mbështetet nga BE me një total prej 29.2 milion Euro me projekte si:


- Ndërtimi i qendrës së re të paraburgimit në Berat, me një vlerë prej 3.6 milion Euro. Projekti pritet të përfundoj në dhjetor 2016.
- Ndërtimi i qendrës së re të paraburgimit në Fier, me një vlerë prej 4 milion Euro. Projekti pritet të përfundojë në 2016.
- Ndërtimi i burgut të Shkodrës dhe qendra e paraburgimit, me një vlerë prej 15.3 milion Euro dhe me një kapacitet prej 600 të burgosur dhe 120 të paraburgosur.
- Projekti për mbështetjen e eficiencës së drejtësisë, me një vlerë prej 1 milion Euro. Ky projekt zbatohet nëpërmjet Këshillit të Evropës (CoE). Zbatimi i metodave CEPEJ dhe mjeteve bashkëkohore dhe transparente në të gjitha gjykatat shqiptare.
- Me rëndësi të veçantë është dhe projekti “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, financuar nga BE me një vlerë prej 3.9 milion Euro. Projekti zbatohet nëpërmjet Gjermanisë/GIZ-it dhe ka si qëllim reformën e gjykatës së lartë dhe bashkimin e jurisprudencës; reformat e këshillit të lartë të drejtësisë; reformat e procedurave të Kodit Civil dhe Penal; mbështetjen për zbatimin e ligjit të gjykatës administrative; ekstradimet dhe bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar; luftën kundër korrupsionit në gjyqësor; sistemin e

monitorimit gjyqësor; mbështetje për administratën e burgjeve; si dhe mbështetjen për organizimin dhe funksionimin e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm

Në **fushën e të drejtës së pronës**, ndër projektet më madhore të financuara dhe të përfunduara mund të përmendet “Projekti për Administrimin dhe Manaxhimin e Tokës (LAMP)” bashkëfinancim i Bankës Botërore dhe Suedisë me vlerë totale 31 milion Euro. Si rezultat i këtij projekti është përfunduar regjistrimi fillestar për 315,000 pasuri të paluajtshme kryesisht në zonat urbane në Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Laç, Elbasan, Fier, Vlorë, Sarandë. Është bërë e mundur që të dhënat dixhitale të përditësuara mbi këto pasuri të aksesohen online nga qytetarët dhe institucionet e interesuara për përdorimin e këtyre të dhënave. Gjithashtu është ulur koha mesatare për regjistrimin e transaksioneve të pronësisë të matur në ZVRPP Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Fier nga 47 ditë në 6 ditë.

Planifikimi për vitet në vijim


Financimi i planifikuar për periudhën 2016-2019 arrin vlerën prej 38.2 milion Euro në formën e grantit. Nga të cilat 27.3 milionë Euro nga Bashkimi Evropian (BE) në vlerën e 13.5 milion Euro kryesisht për mbështetjen për zbatimin e Strategjisë së Pronës, konsolidimin e Sistemit të Drejtësisë (Euralius V, Monitorimi i Verifikimit të Gjyqtarëve); dhe 10.9 milion Euro nga USAID për projektin e Anti korrupsionit dhe përmirësimit të performancës së gjykatës në Shqipëri; si dhe granti prej 2.6 milion Euro për mbështetjen e drejtësisë për të mitur nëpërmjet 4 autoriteteve Suedeze.



Deri në fund të vitit 2015 janë disbursuar në total 24.8 milionë Euro, ose rreth 80% e totalit të financimit të projekteve aktualisht në zbatim. Ky nivel disbursimi dhe përthithjeje e fondeve të huaja është relativisht i kënaqshëm. Ky fakt pasqyrohet dhe në analizën e të dhënave të pyetsorëve, nga e cila nuk ka rezultuar ndonjë problematikë madhore e hasur nga ky institucion.

Ministri i shtetit për inovacionin dhe administratën publike (MIAP)

MIAP ka si objektiv kryesor forcimin e administratës publike nëpërmjet rritjes së kapaciteteve si dhe ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit. Aktualisht janë në zbatim projekte me një vlerë totale financimi të huaj prej rreth 30.8 milion Euro, prej të cilave 28.8 milion Euro (93%) janë në formën e kredisë së butë dhe rreth 2 milion Euro (7%) në formën e grantit.



Donatorët që financojnë aktualisht janë Banka Botërore nëpërmjet kredisë së butë prej 28.8 milion Euro, BE nëpërmjet një granti prej 1.8 milion Euro dhe Italia nëpërmjet një granti prej rreth 270,000 Euro, sic tregohet dhe në grafikun më poshtë.

Gjatë vitit 2015, MIAP ka përfituar Mbështetjen e Bankës Botërore me anë të një kredie me vlerën e 28.8 milion Euro për financimin e iniciativës së ndërmarrë nga qeveria për krijimin e “Public Service Mall” në bashkëpunim dhe me BE. Projekti është parashikuar të ndahet në tre faza, 1 – Krijimi i Modelit të Public Service Mall dhe hapja e disa qendrave pilot (Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezhë) për ofrimin si one-stop shop të 25 shërbimeve publike; 2 – Zbatimi dhe operacionaliteti i Public Service Mall në Tiranë si dhe reformës në tërësi (reinxhinierimi i shërbimeve, thjeshtëzimi dhe dixhitalizimi); 3- Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimeve dhe thellimi i reformës dhe platformës së komunikimit për reformën.


Një tjetër projekt i financuar nga BE lidhet me mbështetjen e reformes për shërbimet civile e cila ka si qëllim zbatimin e ligjit për shërbimin civil, zbatimin e ligjit mbi procedurën administrative dhe forcimin e kapaciteteve të shërbimit civil.

Poashtu, gjatë vitit 2014, MIAP ka përfituar Mbështetjen e BE-së për Reformën e Administratës Publike. Projekti me vlerë 1.8 Milionë Euro u financua nëpërmjet programit IPA 2012. Projekti vlerësohet si i rëndësishëm pasi mbështeti zbatimin e Ligjit të ri të Nënpunësit Civil. Projekti u zbatua përmes një binjakëzimi me Ecole Nationale D’Administration, ku qëllimi ishte zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Administrative dhe forcimi i kapaciteteve të Shërbimit Civil.


Planifikimi për vitet në vijim

Fondet totale të planifikuara për periudhën 2016-2020 janë 74 Milion Euro, të ndara në 4 projekte kryesisht me fokus krijimin e një infrastrukture të thjeshtëzuar, unifikuar, dhe dixhitalizuar të

ofrimit të shërbimeve publike. Prej këtij totali, rreth 38 milion Euro ose 51% do të financohen në formën e grantit (mbështetje buxhetore) nga BE dhe përndrohen kryesisht në fushën e administrimit publik, në mbështetje të reformës së administrimit publik me anë të forcimit të ligjit gjatë katër viteve të ardhshme dhe zhvillimin e politikave të nevojshme gjatë procesit të reformës. Ndërsa, rreth 36 milion Euro do të financohen në formën e kredisë së butë të financuar nga Banka Botërore, në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit, kryesisht për ngritjen e një kadastrë multifunksionale të tokës.




Deri më tani, duke përfshirë dhe vitin 2015, vetëm 16% e financimit në zbatim ose rreth 5 milion Euro, është disbursuar. Ky nivel i ulët vjen kryesisht prej faktit se projektet aktualisht në zbatim kanë filluar relativisht vonë, si dhe disbursimi i fondeve varet kryesisht nga arritja e disa targeteve të vendosura paraprakisht në bashkëpunim me donatorin, sipas formës së re të financimit, mbështetjes buxhetore (që është duke e aplikuar dhe BB së fundmi).



Ndër problematikat kryesore që rezulton nga të dhënat e mbledhura nga pyetsorët është mungesa e kapaciteteve të nevojshme të MIAP, dhe Agjencisë së re të krijuar për shërbimet publike (ADISA), kryesisht në lidhje me menaxhimin e projektit të shërbimeve publike.

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MCV)

Sektori i Decentralizimit dhe i Zhvillimit Rajonal përfitojnë aktualisht një financim me vlerë rreth 23.4 milion Euro, të alokuar në 9 projekte të ndryshme në zbatim. Financimi në tërësi është në formë granti, dhe donatori kryesor është Qeveria Zviceriane, e cila financon 61.5% të fondeve të huaja në sektor e ndjekur nga Kombet e Bashkuara (UN), Bashkimi Evropian dhe USAID.



Pjesa më e madhe e financimit në zbatim përdoret në **fushën e decentralizimit dhe zhvillimit rajonal** ku projektet kryesore janë:

- Projekti “Programi i decentralizimit dhe zhvillimit lokal”, me vlerë 7.5 milion Euro, finncuar Zvicra. Synimi i projektit është forcimi i kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore dhe komuniteteve në Shkodër dhe Lezhë duke kontribuar në përmirësimin e zhvillimit rajonal në Shqipërinë e Veriut dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar.
- Një tjetër projekt i rëndësishëm është “Qeverisja Lokale” e financuar nga Kombet e Bashkuara (UN) me një vlerë prej 5.2 milion Euro. Projekti pritet të përfundojë në dhjetor të 2016.


Në **fushën e antikorrupsionit**, Bashkimi Evropian ka kontribuar me një fond prej rreth 3.3 milion Euro në 4 projekte ku të përqëndruar në zhvillimin e partneritetit kundër korrupsionit, binjakëzimi specifik për anti-korrupsionin fokusuar në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit (DIACA) si dhe vazhdimi dhe zgjerimi i projektit të luftës kundër pastrimit të parave.

Planifikimi për vitet në vijim


Fondet totale të planifikuara për periudhën 2016-2019 janë rreth 18.8 milion Euro, të financuara kryesisht nga Qeveria Zviceriane dhe nga Bashkimi Evropian. Disa prej këtyre projekteve janë si më poshtë:

- “Programi i Zhvillimit Rajonal (faza e re)” me një financim prej rreth 2 milion Euro, e financuar nga Zvicra. Kjo ndërhyrje do të ndërtohet mbi rezultatet dhe arritjet e fazës së parë të këtij programi.

- “Mbështetja për Bashkitë”, me një fond prej 5.8 milion Euro e financuar nga Zvicra ku fokusi kryesor është mbështetja e qeverisjes lokale.
- “Projekti STAR II - Mbështetje e Reformës Territoriale” me në vlerë prej rreth 1 milion Euro e financuar nga Zvicra dhe rreth 1 milion Euro nga Suedia. Fokusi kryesor është mbështetja e reformës administrative dhe territoriale në Shqipëri.
- “Lufta kundër Kundër Korrupsionit” me një vlerë prej 10 milion Euro e financuar në formën e mbështetjes buxhetore nga Bashkimi Europian, ku përfshihet dhe një komponent për asistencë teknike. Projekti pritet të fillojë në janar të vitit 2018.



Niveli i disbursimit për këtë institucion arrin vlerën prej rreth 11.5 milion Euro, ose rreth 46% të financimit total në zbatim.



Nga informacioni i grumbulluar dhe analizuar nga pyetsorët e mbledhur rezulton se ky nivel i disbursimit ka ardhur dhe si pasojë e disa problematikave të hasura si menaxhim jo i mirë i fazave të projektit dhe dorëzimi me vonesë i produkteve që priteshin nga faza e parë në rastin e projektit STAR, ose vonesa të shkaktuara nga mungesa e kuadrit ligjor si në rastin e projektit “Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve”.

4.4. ANALIZA SWOT

Për të vlerësuar se çfarë potenciali dhe mundësie ka ndihma e huaj për të ndikuar në zhvillimin e sektorëve dhe të ekonomisë së vendit në përgjithësi dhe cilët janë rreziqet dhe të metat që mund të ndikojnë në uljen e efektivitetit të saj është kryer një analizë, që shërben për të parë se sa ndikim ka ndihma e huaj në zhvillimin e vëndit, cfarë duhet përmirësuar në mënyrë që të rritet efektiviteti i saj dhe deri në cfarë niveli duhet të mbahet kjo ndihmë në vitet në vijim.

Kjo analizë përbehet nga faktorët e brendshëm që janë fuqitë dhe dobësi dhe nga faktorët e jashtëm – mundësitë dhe rreziqet (potenciali natyror që posedojmë, politikat e caktuara ndërkombëtare si globalizimi etj).

Teknika apo analiza e ashtuquajtur SWOT është mjaft e përhapur dhe ka një përdorim shumë të gjerë (SWOT janë shkurtesa e marr nga anglishtja e që kane ketë kuptim: Strength – Fuqi; Weakness - Dobësi; Opportunity – Mundësi; Threat – Kërcënime apo rreziqet). Është me rëndësi të përcaktohet se secila nga këto instrumente; fuqi, dobësi, mundësi apo kërcënime janë të lidhura me një objektiv specifik strategjik i cili mund të adresohet.

Në tabelën më poshtë bëhet një paraqitje e përmbledhur e këtyre faktorëve në mënyrë që të krijohet një pasqyrë sa më realiste e fuqive dhe dobësive të vendit lidhur me absorbimin e ndihmës së huaj si dhe mundësitë për të përmirësuar efektivitetin e saj dhe rreziqet që duhen kapërcyer në këtë rrugëtim.

Fuqitë • Shqipëria ka hartur dhe miratuar SKZHI-në si dhe strategji sektoriale pothuaj për të gjithë sektorët të cilat shërbejnë si dokumente orientuese për ndihmën e huaj • Përqindja e Ndihmës së Huaj e reflektuar në buxhetin e shtetit është rritur ndjeshëm • Marrëdhëniet e qeverisë me donatorët kanë qënë gjithnjë të shkëlqyera	Dobësitë •Mungesë burimesh materiale dhe kapacitetesh njerëzore •Vështirësi në sigurimin e lejes së ndërtimit dhe probleme me shpronsimet •Mungesë aktesh ligjore apo probleme legjislacioni •Problematika ne prokurim •Vonesa në zbatim •Probleme me rimbursimin e TVSH-së
Mundësitë •Mekanizmi i ri për ofrimin e ndihmës, mbështetja buxhetore, shikohet si një mundësi për rritjen e efektivitetit të saj dhe mjaft donatorë të tjerë përvec BE-së janë duke filluar ta aplikojnë •Negocimi i fortë me donatorët strategjikë gjatë 3 viteve të fundit për të sjellë strategjitë e tyre në linjë me strategjitë e vëndit ka filluar të japë frytet e tij •Ndryshimi i qasjes nga “financimi i projekteve individuale” në “financimin e programeve madhore sektoriale”	Rreziqet •Marrëveshja me FMN kërkon një ulje të borxhit publik me 10 % deri në vitin 2018 gjë që ndikon në nivelin e kredive të buta për zhvillim •Vonesa në disbursim (nga donatori) •Procedurat e zbatimit realizohen kryesisht nga vetë donatori dhe menaxhimi i projektit dhe ka vonesa nga ana e tyre për instrumentat •Projekte me disa partnerë (multi beneficiary), shpesh partnerët janë jashtë Shqipërie, menaxhimi është i vështirë

Kapitulli i pestë

KONKLuzionet dhe REKOMANDIMET

Në këtë kapitull paraqiten përfundimet e nxjerra nga analiza e kryer në kapitujt më sipër duke listuar një sërë faktorësh që ndikojnë në performancën e institucioneve si dhe prezantohen disa rekomandime për të bërë të mundur rritjen e performacës së institucioneve përfituese të ndihmës së huaj si dhe rritjen e efektivitetit në ekonominë e vëndit.

Konkluzionet

Faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndihmës së huaj

Analiza e të dhënave parësore të studimit, 212 pyetsorët që sjellin informacion për 212 projekte në zbatim), evidenton:

- Institucioni që ka përfituar me shumë (duke marrë parasysh totalin prej 212 projekte) është FSHZH me afërsisht 23.6% të projekteve që kanë përfituar ndihmë të huaj. Ndërsa institucioni që ka përfituar më pak është Ministria e Drejtësisë me afërsisht 0.9% të projekteve që kanë përfituar ndihmë të huaj. Duhet përmendur këtu se këto shifra nuk janë në përputhje të plotë me analizën e kryer të databazës totale të të gjithë projekteve aktualisht në zbatim, pasi 212 pyetsorët e mbledhur reflektojnë vetëm një pjesë të numrit total të projekteve aktualisht në zbatim.
- Rreth 49% e të projekteve që kanë përfituar ndihmë të huaj (nga totali prej 212 projekte i marrë në shqyrtim) janë të fokusuar në asistencë teknike, 46% e projekteve janë të fokusuar në investime për ngritje infrastrukturë, dhe 5% në subvencione.
- Sektori që ka përfituar me shumë ndihmë të huaj ka qënë sektori i Transportit me afërsisht 23.5% të projekteve që kanë përfituar ndihmë të huaj.
- Nga të dhënat vihet re se 52% e projekteve që kanë marrë ndihmë të huaj po zbatohen apo janë zbatuar brenda kohezgjatjes së planifikuar ndërsa 48% e tyre kanë hasur problematikë dhe vonesa dhe si rrjedhojë e kanë tejkaluar kohezgjatjen e planifikuar.
- Vetëm 26% e projekteve kanë një plan të konsoliduar për zbatimin e projektit të ndarë në aktivitete konkrete të parashikuara në kohë.
- Vetëm 54% të projekteve të analizuar nga pyetsorët e mbledhur janë të përfshirë në Programin buxhetor afatmesëm (PBA), ndërsa 46% e tyre nuk janë të përfshirë aktualisht, ose mendohet se do të përfshihen në një moment të dytë. Kjo bën që mos të ekzistojë një pasqyrë e qartë e të gjithë financimeve të huaja në zbatim dhe si rrjedhojë shumë herë ndërmerren investime të reja që dublikojnë projekte që mbase janë duke u financuar aktualisht.
- Rezulton se rreth 36% e personave të pyetur mendojnë se burimet materiale dhe njerëzore nuk janë të mjaftueshme për zbatimin e projekteve brenda kohëzgjatjes së përcaktuar. Kjo është një nga problematikat më të mëdha që ka ndikuar në vonesën e zbatimit të mjaft projekteve.

- Rreth 25% e projekteve kanë hasur problematika me shpronësimet apo sigurimin e lejeve të ndërtimit, gjë që ka ndikuar shumë herë në shtyrjen e fillimit të zbatimit të projektit.
- Rreth 28% e projekteve kanë hasur problematika dhe vonesa gjatë fazës së prokurimit.
- Janë hasur vonesa në disbursimin e financimit nga donatori për rreth 19% të projekteve të analizuar nëpërmjet pyetsorëve.
- Për rreth 42% të projekteve nuk është planifikuar dhe rimbursuar në kohë TVSH-ja.
- Për rreth 31% të projekteve ka patur vonesa që në projektimin e projektit, kryesisht për shkak të mungesave të kapaciteteve projektuese në institucionet e ndryshme përfituese.
- Lidhur me impaktin e projektit (kryesisht të pritshëm pasi projektet e marra në shqyrtim janë ende në zbatim), rezulton se 49% e projekteve pritet të ndikojë pozitivisht në sektorin përkatës, rreth 24% të projekteve pritet të krijojnë vende të reja pune, rreth 68% pritet të kenë ndikim në rritjen e kapaciteteve njerëzore, dhe rreth 58% pritet të kenë ndikim në rritjen e investimeve të mëtejshme në sektorin ku zbatohen.

Verifikimi i hipotezave studimore tregoi se:

Hipoteza H^0_1 :

- Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës se huaj nëse ka reduktim të vonesave procedurale dhe nëse ka një rritje të kapaciteteve njerëzore dhe atyre materiale. Kjo do të thotë se rritja e kapaciteteve njerëzore dhe materiale dhe reduktimi i vonesave procedurale ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e performancës së ndihmës së huaj.

Hipoteza H^0_2 :

- Ekziston një dallim rëndësishëm statistikor midis sektorëve të ekonomisë, pra efektiviteti i ndihmës se huaj varet nga sektori të cilin ajo mbështet. Kjo do të thotë se performanca e ndihmës së huaj varet nga sektori i ekonomisë.

Hipoteza H^0_3 :

- Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i performancës së ndihmës se huaj nëse ka patur problematika/vonesa në fazën e prokurimit. Që do të thotë se vonesa dhe problematika të hasura në fazën e prokurimit ndikojnë drejtpërdrejtë në performancën e ndihmës së huaj.

Hipoteza H^0_4 :

- Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor i përfshirjes së financimit të projektit në PBA dhe planifikimit të projektit bazuar në aktivitete konkrete si dhe zbatimit të projektit brenda kohëzgjatjes së planifikuar. Kjo do të thotë që nëse financimi i huaj është i reflektuar në PBA, atëherë është më e mundur që të ekzistojë një plan me aktivitete konkrete të projektit të përcaktuara përcaktuara në kohë si dhe është më e lehtë që projekti t'i përmbahet këtij plani nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm e si rrjedhim të zbatohet sipas kohëzgjatjes së përcaktuar.

Perpunimi i të dhënave dytesore konfirmoi rezultatet e arritura në verifikimi i hipotezave studimore të dhëna me sipër.

Keto rezultate mundesojnë formulimin e perfundimeve të mëposhteme në lidhje me faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndihmës se huaj, në fazat e ndryshme të implementimit të projektit

FAZA I: Financimi dhe përgatitja për zbatim:

- Vonesa në negociim, hartim, ratifikim të marrëveshjeve (kryesisht ndihma përbëhet nga kredi zhvillimi që negocohen dhe ratifikohen në Parlament, pra kanë cikël më të gjatë dhe kompleks).

- Mungesa dhe probleme në fazën e përgatitjes së projekteve dhe procedurave për zbatim pasi nuk ka instrumenta të mjaftueshme (fonde, know-how projektimi) për hartimin e projekteve të zbatimit dhe jo gjithmonë ato planifikohen saktë në projekt, gjë që ndikon në nivelin e saktësisë teknike dhe shpejtësisë së hartimit të projekteve të zbatimit që vënë në ekzekutim investimet dhe si rrjedhim ndikon dhe në nivelin e ulët të përthithjes së fondeve.

FAZA II: Prokurimi dhe kontraktimi/menaxhimi i zbatimit:

Planifikimi financiar i tavaneve jo gjithmonë është korrekt, ndaj ka “mosrealizim” për shkak të mbi planifikimit ose planifikimit optimist:

- Nuk aplikohet apo nuk hartohet një Plan i Punimeve) me aktivitete konkrete si dhe një Vlerësim i Nevojave Financiare të projektit, që të vlerësohet saktë sa do të realizohet cdo vit, por parashikimi bëhet me përafërsi, pa konsideruar të gjitha faktorët që mund të cojnë në mosrealizim.
- Vështirësitë dhe vonesat procedurale në disbursimin dhe celjen e fondeve dhe llogarive si:
 - në rastin kur donatorët “vonojnë” disbursimet;
 - vonesa në procedurat me MF për hapjen e llogarive të posaçme në EURO për çdo projekt të veçantë;
 - planifikimi jo i saktë për kontributin apo financim nga buxheti i shtetit për koston lokale dhe TVSH, i cili vonon përdorimin e fondeve të huaja. Rimbursimi i TVSH-së vazhdon të mbetet problematikë pavarësisht masave të marra për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe përfshirjen me prioritet të këtyre detyrimeve në buxhet. Psh. Problematika janë konstatuar edhe lidhur me rimbursimin e TVSH-së për projektet e bashkëpunimit teknik me Gjermaninë, GIZ, IPA multibeneficiary etj.
- Tranferimi i disa fushave të përgjegjësisë nga një ministri në tjetrën kryesisht gjate vitit 2014 (për shkak të ardhjes së qeverisë së re) ka sjellë “vonesa” në transferimin e përgjegjësisë për zbatimin e projekteve si dhe në vetë zbatimin e tyre.
- Vonesa në prokurim: Projekte të rëndësishme si në infrastrukturë dhe financë si psh. Në rastin e projektit “Mbështetje për zgjerimin e sistemit të thesarit (SETS)” dhe projektit “e-Taxation” etj., kanë hasur vonesa kryesisht në prokurimin e pajisjeve hardëare nga Ministria e Financave.
- Ngjarjet e paparshikuara shpesh shkaktojnë vonesa përtej planit për financim që sjell mosrealizim. Ngjarje të tilla mund të jenë:
 - ankimet në procedura prokurimi;
 - lirimi i sheshit (gjykata);
 - specifikime teknike të larta që mund të cojë në anulim procedurash prokurimi
- Menaxhimi i zbatimit të projektit:
 - Në mjaft raste, procedurat e zbatimit të projekteve administrohen dhe zbatohen nga vetë donatorët ose forma të organizimit ad hoc (PIU etj) ndaj ndikimi i Ministrive në

realizimin e fondeve është më i vogël dhe menaxhimi më shumë palë i vështirë. Psh. IPA njihet si instrument i ngadaltë.

- Projekte me disa partnerë (multi beneficiary), shpesh partnerët janë jashtë Shqipërie, dhe si rrjedhim menaxhimi për projekte të tilla është mjaft i vështirë.
- Vonesat lidhur me përgatitjen e dokumentacionit (mungese stafi të specializuar) dhe të dhënies se lejeve të ndërtimit (pezullimi, AKPT etj).
- Vënia në dispozicion e sheshit të ndërtimit: Procesi mjaft i ngadaltë i shpronësimeve, prishjeve dhe lirimi i sheshit për punime, ose lidhjet/spostimi i lidhjeve nga OSHE etj. Kjo është vënë re psh në projektet madhore si: By-pass i Fierit, By-pass i Vlorës, Rruga Qukës Qaf-Plloçe, Ujësjellësi i Veliojës, By-Pass i Durrësit, Landfilli i Maliqit etj.

FAZA III: Zbatimi i punimeve

- Për projekte me blerje pajisjesh apo sistemesh, gjatë 6 muhorit të parë kryhen kryesisht procedurat e kontraktimit dhe blerjet kanë efekt në ekzekutimin e fondeve në 6 muhorin e dytë me lëvrim
- Për projektet e punimeve të ndërtimit: Shpejtësia e realizimit në terren të punimeve nga kontraktorët, sidomos në projektet e infrastrukturës është në raste jo e lartë (edhe për shkak të vonësës së pagesave). Shkak shpesh është kapaciteti jo i mjaftueshëm i kompanive dhe mospagesa në kohë e faturave, gjë që bën që ecuria faktike e punimeve dhe pagesa të kenë hendek dhe kjo ngadalëson punimet. Ka vend për përmirësime dhe të menaxhimit të kontratës përmes Ministrisë, supervisorëve etj.
- Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare zbatuese të institucioneve ka sjellë vonesa në zbatimin e projekteve. Shpesh zbatimi i projekteve nuk është “i qendëruar” si psh në Drejtoritë e Intgimit, dhe shumë herë nevoja më dytësore financohen me ndihmë të huaj, Poashtu, nuk ka një menaxher projekti të dedikuar dhe të fokusuar.

FAZA IV: Vënia në zbatim e veprës

- Mungojnë shpesh mekanizmat institucionale për të marrë dhe vënë në zbatim projektin e përfunduar, kryesisht për projektet e infrastrukturës rajonale;
- Mungon parashikimi i shpenzimeve për vënien në zbatim të projektit;
- Lidhja më energjinë në shumë raste nuk programohet, dhe projekti megjithëse i përfunduar nuk mund të vihet në zbatim.

Nga analiza e rezultateve dhe informacioneve të mbledhura, vërehet një rënie e ndjeshme e financimit të planifikuar për shkak të limiteve të huamarrjes si dhe përthithjes së ngadaltë të financimit aktualisht në zbatim.

Poashtu, duhet patur parasysh që analiza e kryer nuk është ndikuar nga rezultatet e vitit 2014/2015, pasi ishte vit i negocimit të Protokolleve të reja të Bashkëpunimit Teknik dhe të Ndihmës për 4/7 vitet që vine me BE, BB, Gjermani, Itali etj, dhe fillimi i hartimit të projekteve të reja, ndaj konsiderohet si *fazë përgatitore* me më pak mundësi përthithje dhe realizimi.

Për projektet e punimeve të ndërtimit: Shpejtësia e realizimit në terren të punimeve nga kontraktorët, sidomos në projektet e infrastrukturës është në raste jo e lartë (edhe për shkak të vonësës së pagesave). Shkak shpesh është kapaciteti i kompanive dhe mospagesa në kohë e faturave, gjë që bën që ecuria faktike e punimeve dhe pagesa të kenë hendek dhe kjo ngadalëson punimet.

Mbështetja buxhetore është një instrument i ri i dhenies së NH i cili iu vjen në ndihmë vëndeve të cilat ndodhen në procesin e para-adarimit, duke i ndihmuar në zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike në kuadër të qasjes sektoriale. Pra, mbështetja buxhetore rekomandohet si një zgjidhje efikase për rritjen e përthithjes së ndihmës së huaj, efektivitetin e saj dhe orientimin e finanimeve të huaja drejt prioriteteve të vendit duke u bërë pjesë organike e buxhetit të shtetit e duke mos u konsideruar më si një financim i jashtëm për zbatimin e disa projekteve të vecuara. Me përmbushjen e kriterëve të vendosura, Shqipërisë i ofrohet mundësia të përfitojë fonde të huaja direkt në buxhetin e shtetit e t'i përdorë sipas nevojave të saj për zbatimin e politikave që vendi konsideron si prioritare.

Rekomandimet

Rekomandimet trajtojnë probleme që lidhen me përmirësimin e bashkërendimit të planifikimit, menaxhimit dhe vlerësimit midis të dyja palëve, asaj të donatorëve dhe të qeverisë.

Per te rritur efektivitetin e Instrumentave që Ndikojnë në Rritjen e Performacës së Institucioneve: Është e nevojshme të punohet për të rritur me tej nivelin e qasjes efektive të donatorëve me përjasje sektoriale (IPMG) dhe programesh (Programme Based Approach), përdorimi sa i më gjerë i sistemeve qeveritare dhe integrimi i ndihmës së huaj në buxhetin afatmesëm.

Mbështetja buxhetore:

Mbështetja buxhetore është një modalitet i ri i ofrimit të ndihmës së huaj i aplikuar nga BE, i cili bazohet në një qasje sektoriale. Ky modalitet i ri konsiderohet si një mjet për të rritur efektivitetin e ndihmës së para-anëtarësimit (IPA) dhe për të arritur rezultate më të qëndrueshme.

Qeveria shqiptare dhe Institucionet përfituese nga ndihma e huaj duhet të mbajnë përherë parasysh se, sipas BE:

Transferimi i burimeve financiare nga një institucion/agjensi e jashtme financimi në Thesarin Kombëtar të një vendi partner, pas kësaj i fundit ka respektuar kushtet e rëna dakord për pagesën. Kjo transfertë financiare nuk është një çek i bardhë. Duhet të përmbushen një set i përbërë prej kriterëve të përshtatshmërisë si dhe kushtet e disbursimit në mënyrë që transferta të bëhet e mundur (European Commission, 2015).

Qeveria shqiptare dhe institucionet përfituese duhet të mbajnë parasysh se, në kuadër të IPA II (2014-2020), Bashkimi Europian paraqet një qasje të re për shtetet në kuadër të paraanëtarësimit. Një nga risitë e ndërmarra është edhe qasja sektoriale (sectoral approach). Asistenca financiare e Bashkimit Europian tashmë do të jetë e lokalizuar në sektorët më të rëndësishëm të vendit me

qëllim harmonizimin e politikave dhe krijimin e standardeve të nevojshme që nevojiten për ta çuar progresin në një tjetër stad.

Per te rritur mundësite e disbursimit te fondeve është e rëndësishme të bëhet dallimi midis mbështetjes buxhetore si modalitet ndihmues dhe fondeve të mbështetjes buxhetore që ka të bëjë vetëm me transferimin e burimeve financiare në vëndin përfitues.

Institucionet perfituese nevojitet te angazhohen per te plotesuar, ne sasi dhe cilesi kushtet si me poshte, me qëllim përfitimin e mbështetjes buxhetore:

1. Klimë e favorshme dhe e qëndrueshme makro-ekonomike
2. Manaxhim efikas i financave publike
3. Transparenca dhe mbikqyrja e buxhetit
4. Reforma te ndermarr në politikat sektoriale.

Duhe theksuar se eshte domosdoshme puna per ngritjen e një sistem efektiv për monitorimin e progresit dhe performancës. Poashtu, mbeshtetur ne kriteret e percaktuara nga donatorete, rekomandohet si nevojte aktuale investimi institucional per rritjen e kapaciteteve te nevojshme per plotesimin e kerkesave per pranueshmërinë:

(i) *Vlerësimin gjatë përgatitjes së programit*, e cila përfshin një angazhim të gjërë referuar rëndësisë dhe besueshmërisë së politikave sektoriale të vëndit përfitues. Kriteri i rëndësisë i referohet shkallës në të cilën kufizimet dhe dobësitë kryesore janë duke u drejtuar/adresuar nga strategjia e qeverisë me qëllim fianlizimin me sukses të objektivave të vendosura, ndërsa kriteri i kredibilitetit kërkon një angazhim të fortë politik me qëllim realizimin me sukses të reformave.

(ii) *Vlerësimi gjatë zbatimit të programit* me qëllim analizimin e progresit të bërë.

Per te perfituar mbështetje buxhetore eshte e nevojshme te punohet per te mundesuar përputhshmërinë me politikën e zgjerimit të BE-së si dhe përputhshmërinë me politikat, prioritetet dhe objektivat e vendit me kusht që këto të jenë në përputhje me politikën e zgjerimit të BE-së.

Perfituesit e ndihmes, qeveria dhe institucionet eshte e nevojshme te punojne per hartimin e nje plani të përshtatshëm të reformës sektoriale të lidhur me agjendën e zgjerimit, ku te përfshihen objektiva ambicioze, por SMART (specifike, të matshme, të dakorduara, reale dhe të arritshme brenda një intervali kohor të caktuar).

Per te arritur sukses ne efektivitetin e synuar te ndihmes se huaj eshte e nevojeshme:

- Zbatimi rigoroz i kriterëve të pranueshmërisë (me përfshirjen e partnerëve ndërkombëtarë me përvojë dhe të besueshëm në vlerësim)
- Lidhje e qartë në Dokumentin Strategjik të Vëndit dhe prioritetet
- Axxhenda e reformës të jetë e përcaktuar mirë, realiste dhe e qëndrueshme
- Përcaktimi i qartë i kushteve për disbursimin e transheve të mbështetjes buxhetore (bazuar në objektiva dhe tregues të matshëm)

- Të mbahet parasysh se Mbështetja Buxhetore konsiston në mbështetje buxhetore sektoriale dhe jo në mbështetje të përgjithshme të buxhetit
- Ekzistenca e një sistemi të monitorimit të orientuar sipas rezultateve

Vlerësimi dhe rishikimi i programeve të donatoreve

Një mënyrë tjetër për rritjen e efektivitetit të ndihmës së huaj është dhe bashkërendimi i programeve dhe politikave vendase me programet apo strategjitë për zhvillim të donatorëve. Në këtë kuadër, vlerësimet e bëra nga donatorët janë një burim i rëndësishëm informacioni për të kuptuar impaktin e ndihmës së huaj dhe për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për të përmirësuar planifikim e mëtejshëm të saj. Deri tani janë bërë një sërë vlerësimesh nga ana e donatorëve, dhe disa prej tyre përmbledhen si më poshtë:

BB. Vlerësimi i Programit të Bankës Botërore në Shqipëri (2015). Programi i BB ka arritur në përgjithësi rezultate të mira por qëndrueshmëri dhe impakt institucional të dobët, veçanërisht në shëndetësi, arsim, qeverisje dhe në klimën e investimeve. Vlerësimi tregon se programet kanë qenë më të suksesshme atëherë kur: a) janë shoqëruar me reforma sektoriale të miratuara dhe mbështetura nga Qeveria; b) janë mbështetur nga analizat dhe strategjitë sektoriale; c) kanë qenë të përbëra nga një seri projektsh fazat e të cilave janë përgatitur me kujdes dhe të cilat janë të lidhura me procesin; d) të hartuara për të ngritur institucione lokale; si dhe e) kanë qenë pjesë e perpjekjeve të donatorëve, të koordinuara nga qëllime të qarta. Programimi për vitet në vijim i BB 2015-2020 ka objektiva të qarta dhe është në linjë të plotë me prioritetet e qeverisë, i përqendruar në infrastrukturë, shëndetësi dhe arsim.

Gjermania: Vlerësimi i Programit të mbështetjes së vendit. Ndihma e huaj gjermane ka qenë e menaxhuar mirë dhe e suksesshme në arritjen e rezultateve të pritura. Në përgjithësi, aktivitetet kanë qenë në përputhje me nevojat e vendit, kryesisht ato infrastrukturore, në fushën e ujësjellës kanalizimeve. Pavarësisht kësaj, projektet kanë qenë të fragmentuara, koordinimi strategjik dhe përfshirja e Qeverisë në programim dhe në reforma në lidhje me projektet ka qenë e kufizuar. Si rrjedhim, në vitet e fundit është punuar intensivisht për një përqendrim më i madh tematik në përputhje me politikat dhe institucionet vendase.

SIDA: Vlerësimi i Rezultateve. Projektet e mbështetura nga Suedia kanë qenë kryesisht në përputhje me prioritetet e vendit. Shumë nga projektet i kanë arritur rezultatet e pritura me gjithë vonesat e fillimit, shpesh këto të shoqëruara me reforma institucionale. Rritja e kapaciteteve ishte një ndër fokuset më të rëndësishëm, por qëndrueshmëria dhe ngritja e institucioneve ka qenë e brishtë. Përpjekja për të vazhduar me projekte me përqasje me bazë sektoriale ka qenë mikse: disa nga nënsektorët kanë qenë një përzierje e mirë e projekteve dhe kjo është një arritje e suksesshme; megjithatë, nuk ka një programim sektorial të rregullt dhe lidhja midis strategjive sektoriale dhe identifikimit të projekteve është akoma e dobët dhe shumë nga projektet janë akoma të izoluar. Efikasiteti dhe menaxhimi i projekteve ka qenë i ndryshueshëm.

Ka disa nota të përbashkëta në vlerësimet e mësipërme. Së pari, ndihma e huaj është përputhur me nevojat dhe në shumicën e rasteve janë arritur rezultatet e projektit. Së dyti, është vënë theksi tek

rëndësia e vendosjes së një përputhshmërie midis strategjive, programeve dhe projekteve në programet e reja të donatorëve. Së treti, vlera në përqëndrimin e programeve të donatorëve në një numër të kufizuar sektorësh dhe nënsektorësh. Së katërti, rëndësia e fokusimit në ngritjen e institucioneve dhe vështirësitë për të arritur këtë.

Si rezultat, rekomandohet inkurajimi i donatorëve për të ndërmarre më shumë vlerësime të përbashketa në partneritet me Qeverinë. Vlerësimet e tyre shërbejnë si pjesë e iniciativave qeveritare për përmirësimin e vlerësimit të politikave publike. Keto vlerësime mund të përgatiten çdo vit në periudhën nëntor-dhjetor përpara fillimit të procesit të buxhetit një vlerësim i efektivitetit të financimeve të huaja. Kjo do të mbulonte si efikasitetin e vlerësimit (përfshirjen e kapaciteteve absorbuese) ashtu dhe impaktin.

Rekomandohet, gjithashtu, menaxhimi i bazuar në rezultate dhe përgjegjësia e dyanshme në mënyrë që donatorët dhe vendet partnere të menaxhojnë burimet, përmirësojnë vendimmarrjen, dhe të janë përgjegjës për rezultatet e zhvillimit.

Lidhja me buxhetin - Programimi dhe Buxheti

Ndihma e huaj përbën rreth 66% të investimeve të buxhetit të shtetit (2015). Megjithëse këtu vlen të përmendet se jo e gjithë ndihma e huaj është e përfshirë në shifrat e buxhetit. Kjo përbën dhe një nga problematikat që duhen adresuar. Në këtë kuadër, rekomandohet që donatorëve t'u kërkohej që ta shikojnë me prioritet rëndësinë e rregjistrimit të ndihmës së huaj në buxhet. Kjo mund të arrihet nëse donatorët do të punojnë ngushtësisht me ministrinë përkatëse të linjës si dhe me MF.

Dokumentet e programimit strategjik të donatorëve zakonisht mbulojnë një periudhë tre vjeçare. Tabela e mëposhtme është një përpyetje për të përputhur prioritetet e donatorëve me vlerësimin që Qeveria i ka bërë nevojave të Shqipërisë, si dhe orienton ata donatorë që janë në fazën e rishikimit të prioritetëve të tyre. Në këtë kuadër së fundmi është ndërmarrë një nisëm nga qeveria për ngritjen e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP).

GMIP ofron një strukturë menaxhimi të nivelit të lartë për të siguruar përgatitjen, implementimin, monitorimin dhe rregullimin e integruar të politikave dhe veprimeve sektoriale nëpërmjet përgatitjes dhe menaxhimit të koordinuar të Programit Kombëtar Sektorial (PKS). Ai siguron instrumentin transparent dhe të koordinuar për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të politikave në sektorët prioritarë. Poashtu, siguron mekanizmin e duhur për të orientuar fondet e nevojshme nga buxheti i shtetit ose nga burime të huaja për zbatimin e masave të politikave.

Deri tani janë ngritur dhe operojnë 4 GMIP në sektorët si më poshtë:

- Sektori i Punësimit, Aftësimin dhe Politikat Sociale
- Sektori i Menaxhimit të Integruar të Ujit
- Sektori i Konkureshmërisë dhe Inovacionit
- Sektori i Mirëqeverisjes dhe Reformës në Administratën Publike

Përdorimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të donatorëve nga ana e DZHFNH dhe MF, së bashku me raportin vjetor të dokumentit të ndihmës së huaj, do të bënte të mundur që informacioni për ndihmën e huaj të përfshihet në diskutimet e buxhetit.

Gjithashtu, rekomandohet që qeveria të bëjë pjesë të përgatitjes së ciklit buxhetor Ndhimën e Huaj. Gjatë gjithë ciklit buxhetor (PBA), ministritë raportojnë për kërkesa për fonde shtesë të cilat konsiderohen duke pasur parasysh të gjithë programet në vazhdimësi dhe të planifikuar me fonde nga ndihma e huaj. Rekomandohet që e gjithë ndihma e huaj të merret në konsideratë në këtë proces duke vazhduar përpjekjet për të klasifikuar gjithë fondet e ndihmës së huaj kundrejt një ose disa programeve përkatëse të buxhetit. Rekomandohet që donatorët të inkurajohen që të marrin në konsideratë këto procese kur programojnë dhe raportojnë ndihmën e huaj. Nëse projektet do të menaxhoheshin sipas programit të buxhetit, do arrihej të bëhej dhe lidhja e tyre me ministrinë përkatëse, por edhe me departamentin dhe programin buxhetor përkatës brenda ministrisë.

Mund të konkludohet se për të tejkaluar problematikat e listuara në analizën e kryer më sipër dhe për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së huaj është e nevojshme të përcaktohen dhe të vendosen disa objektiva për t'u arritur, si më poshtë:

- Nxitja e donatorëve që të bazojnë mbështetjen e tyre financiare në strategjitë kombëtare për zhvillim si dhe institucionet dhe procedurat kombëtare.
- Përmirësimi i përthithjes së angazhimeve në vazhdim në mënyrë që të përmirësohen realizimet e fondeve dhe më pas të shpenzohen energji për angazhimet e reja.
- Prezantimi i një mekanizmi financimi bazuar në rezultate dhe performancë për të rialokuar ndihmën nga sektorë që nuk përformojnë në të rinj, me qëllim uljen e riskut të mosrealizimit dhe të shpërndarjes më të mirë të tavaneve, duke "thyer" konceptin e "përfituesve tradicional" por që nuk arrijnë të përthithin mbështetjen që iu jepet, sepse mund të jenë edhe të "mbingopur" dhe në mungesë kapacitetesh për të zbatuar ndihmën.
- Përqasja e ndihmës së huaj duke u bazuar në programe që përfshijnë disa projekte me impakt të përbashkët në një sektor të caktuar, e jo më në projekte individuale.
- Lidhja e ndihmës së huaj me programet e buxhetit nëpërmjet reflektimit të cdo financimi të huaj, qoftë grant po kredi, në PBA.
- Përmirësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar Publik dhe të prokurimit publik, me qëllim që përdorimi i buxhetit të shtetit nga ana e donatorëve të jetë sa më efektiv.
- Zbatimi i një sistemi informatik të raportimit të financimeve të huaja të lidhur me buxhetin dhe thesarin ku të gjithë përfituesit janë të lidhur online dhe kanë akses për të hedhur apo për të marrë informacion lidhur me financimet e huaja.

Vendosja dhe arritja e objektivave të tilla do të kishin një ndikim të konsiderueshëm në kapërcimin e problematikave ekzistuese dhe në rritjen e efektivitetit të ndihmës së huaj në vitet në vijim.

BIBLIOGRAFIA - REFERENCAT

1. Aid Dependence and the Quality of Governance: Cross-Country Empirical Tests, Stephen Knack, Southern Economic Journal, Vol. 68, No. 2 (Oct., 2001), faqet. 310-329
2. Aid and institutions in transition economies, European Journal of Political Economy, Volume 38, Qershor 2015, Faqet 55–70
3. Askarov, Z 2015. *Aid and institutions in transition economies*, European Journal of Political Economy, Volume 38, Pages 55–70. Website: <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0176268015000026>. [27 janar, 2016].
4. Autoriteti i komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Raporti Vjetor 2011. Website: http://www.akep.al/images/stories/AKEP/raporte/Akep_Raporti_2011.pdf. [Data e aksesit: 27 Janar, 2016].
5. Banka Botërore. IFC. *Doing Business 2012: Doing Business in a more transparent world*. Website: <http://www.doingbusiness.org/~media/fpdkm/doing%20business/documents/profiles/country/ALB.pdf>. [Data e aksesit: 4 Shkurt, 2016].
6. Banka Botërore. *Country Data Report for Albania, 1996-2011*. Worldwide Governance Indicators. Website: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c6.pdf>. [Data e aksesit: 4 Maj, 2016]
7. Banka e Shqipërisë. Raporti Vjetor 2011. Qershor 2012. Website: http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_Vjetor_2011_6417_1.php. [Data e aksesit: 20 Janar, 2016].
8. Banka Botërore, 2015, *Modernizimi i ofrimit të shërbimeve publike rrit transparencën dhe përmirëson qeverisjen në Shqipëri*, WB News, Aksesuar në: <http://www.worldbank.org/sq/news/press-release/2015/08/25/modern-public-service-delivery-to-increase-transparency-and-reduce-corruption-in-albania>. [2 shkurt 2016].
9. Banka Botërore. IFC. *Doing Business 2015: Doing Business in a more transparent world*. Website: <http://www.doingbusiness.org/~media/fpdkm/doing%20business/documents/profiles/country/ALB.pdf>. [Data e aksesit: 10 Nëntor, 2016].
10. Banka Botërore. *Country Data Report for Albania, 1996-2011*. Worldwide Governance Indicators. Website: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c6.pdf>. [Data e aksesit: 10 Nëntor, 2016].
11. Banka Botërore, 2015, *Modernizimi i ofrimit të shërbimeve publike rrit transparencën dhe përmirëson qeverisjen në Shqipëri*, WB News, Aksesuar në: <http://www.worldbank.org/sq/news/press-release/2015/08/25/modern-public-service-delivery-to-increase-transparency-and-reduce-corruption-in-albania>. [2 shkurt 2016].
12. Banka Botërore, 2015. Partnership Program Snapshot. Albania. Prill 2015. Website: <https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania-Snapshot.pdf>. [22 dhjetor 2015].
13. Banka Botërore, 2012. Raporti "Rritja e artë: Rikthimi i shkëlqimit të Evropës". Website: http://siteresources.worldbank.org/ECAEXT/Resources/258598-1284061150155/7383639-1323888814015/8319788-1326139457715/fulltext_contents.pdf. [3 mars 2016].
14. Banka Botërore, 2015. *Country Partnership Framework for Albania 2015-2019*. Website: <http://documents.worldbank.org/curated/en/602151467991993190/pdf/98254-CAS-P147570-PUBLIC-Box393168B.pdf>. [13 dhjetor 2015].
15. Bigsten, A and Tengstam, S 2015, *International Coordination and the Effectiveness of Aid*, Aid Policy and the Macroeconomic Management of Aid, Volume 69, Pages 75–85, World Development.

- Website: <<http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0305750X13003057>>. [27 shkurt, 2016].
16. Black Sea Trade and Development Bank. *Albania Country Strategy 2011-2014*. Prill, 2011. Thessaloniki. BoD Approved.
Website:http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/bstadb_albania_country_strategy[Data e aksesit: 20 Maj, 2016]
 17. Brautigam, D., & Knack, S., 2004. *Foreign aid, institutions and governance in Sub-Saharan Africa*. Economic Development and Cultural Change, 52(2), 256–285
 18. Choong Young Ahn & Joo-Moon Kim, 1995. *Aid and growth: What does the cross-country evidence really show?*. Review of Economics and Statistics, 90(4), 330
 19. Clemens, M. & Moss, T., 2005. *Ghost of 0.7%: Origins and relevance of the international aid target*. Working Paper Number 68, September 2005. Washington, DC: Center for Global Development.
 20. Cooperazione Italiana allo Sviluppo. Ministero Affari Esteri. *Cooperation Agreements*. Development Cooperation Office. Italian government. Website: <http://www.italcoopalbania.org/mat.php?idr=5&idm=9&l=e>. [Data e aksesit: 5 Tetor, 2015]
 21. Dalgaard, C. J., & Hansen, H. (2001). On aid, growth, and good policies. *Journal of Development Studies*, 37(6), fq. 17–41.
 22. Deklarata e Parisit dhe Agjenda e Akas. Website: <<http://www.oecd.org/dac/effectiveness/parisdeclarationandaccraagendaforaction.htm>> [4 shkurt 2016].
 23. Delegation of the European Union to Albania. Political & Economic relations. Website: http://eeas.europa.eu/delegations/albania/eu_albania/political_relations/index_en.htm. [Data e aksesit: 10 Maj, 2016].
 24. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, Zyra e Kryeministrit. Databaza e Donatorëve, Versioni Draft. Gusht 2015.
 25. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2011, *Progres Raporti i Ndhmës së Huaj në Shqipëri 2009-2010*. Publikuar nga Këshilli i Ministrave.2011.
 26. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2012. *Analizë e performancës së Ndhmës së Huaj 2011-2012*. Publikuar nga Këshilli i Ministrave.2012.
 27. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2016, *Intervistë e strukturuar me stafin e Njësisë së Financimeve dhe Ndhmës së Huaj. Janar 2016*.
 28. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2016. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Maj 2016*.
 29. Departamenti i Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, 2015, Kryeministria, *Databaza e Donatorëve*, përditësuar në korrik 2015.
 30. Departamenti i Statistikave, 2015, *Fluksi i investimeve të huaja direkte në Shqipëri sipas aktivitetit ekonomik* Statistika, Banka e Shqipërisë.
Aksesuar në: <https://www.bankofalbania.org/web/Statistika_230_1.php>. [2 shkurt 2016].
 31. Doucouliagos, H., & Paldam, M., 2009. The aid effectiveness literature: The sad results of 40 years of research. *Journal of Economic Surveys*, 23(3), Fq. 433–461.
 32. Dreher, A., Sturm, J. A., & Vreeland, J., 2009. *Development aid and international politics: Does membership on the UN security council influence World Bank decisions?*. *Journal of Development Economics*, 88(1), 1–18.
 33. Easterly, W., 2001. *Can foreign aid buy Growth?*. *Journal of Economic Perspectives*, 17(3), Fq. 23–

34. European Commission. *A strategy for smart, sustainable and inclusive growth: Europe 2020*. Brussels, 3.3.2010 . Com(2010) 2020 final. Communication from the Commission. Website: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>. [Data e aksesit: 10 Maj, 2016]
35. European Commission. Enterprise Europe Network (EEN). Website: <http://een.ec.europa.eu/about/mission>. [Data e aksesit: 9 Maj, 2016]
36. European Commision. DG Enlargement. *Sector Budget Support Guidelines*. January 2014. Website: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/methodology-budget-support-guidelines-201409_en_2.pdf [Data e aksesit: 10 Prill, 2016]
37. European Commision. Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II). Indicative Strategy Paper for Albania 2014-2020. Adopted on 18.08.2014. Website: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-albania.pdf [Data e aksesit: 10 Maj, 2016]
38. Eurostat. *New Cronos database: PPP domain/ 13.12.2011*. Website: <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes>. [Data e aksesit: 24 Shtator, 2015].
39. FMN, 2015. Vjetari Statistikor te Bilancit te Pagesave te FMN per vitin 2014. Website: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/bop/2014/ar/bopcom14.pdf>. [3 shkurt 2016].
40. Forumi i Katërt të Nivelit të Lartë për Efektivitetin e Ndhmës së Huaj, 2011, Partneriteti i Busanit. Website: <http://www.oecd.org/dac/effectiveness/busanpartnership.htm> [22 shkurt 2016].
41. Global Partnership for Effective Cooperation (GPEC), 2011, *Busan Partnership For Effective Development Cooperation*. Website: http://effectivecooperation.org/files/OUTCOME_DOCUMENT_FINAL_EN.pdf [4 shkurt, 2016].
42. Grupi i përkohshëm për standardet e përbashkëta, 2012, ‘Çfarë është standardi i përbashkët për informacionin e ndihmës së huaj?’ Paris: OECD. Mars 2016
43. Heritage Fondation. *2013 Index of Economic Freedom: Albania*. Wall Street Journal Report. Website: <http://www.heritage.org/index/country/albania>. [Data e aksesit: 29 shkurt 2015].
44. International Coordination and the Effectiveness of Aid, World Development , Volume 69, May 2015, faqet 75–85, Aid Policy and the Macroeconomic Management of Aid.
45. International Monetary Fund. *Country Report No. 13/7- Albania 2012*. Article IV Consultation- January
46. 2013. Website: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2013/cr1307.pdf>. [Data e aksesit: 25 Nëntor, 2015].
47. INSTAT. *Informacion ekonomik për ndërmarrjet*. Website: www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet.aspx. [Data e aksesit: 27 Janar, 2016].
48. INSTAT 2015, *Anketa Tremujore e Forcave të Punës, Tremujori III 2015*, Aksesuar në: http://www.instat.gov.al/media/318434/atfp_t3_2015.pdf. [3 shkurt 2016].
49. Këshilli i Ministrave. *Vendim Nr. 1. Datë 23.1.2013 Për “Miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për Periudhën 2014 - 2016”*. Ministria e Financave. Website:
50. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/kuadri_makroekonomik_e_fiskal_per_periudhen_2014_2016_date_23_1_4440_1.pdf. [Data e aksesit: 20 Nëntor, 2015].
51. Kilby, C. (2009). *The political economy of conditionality: An empirical analysis of World Bank loan disbursements*. Journal of Development Economics, 89(1), 51–61.

52. Klaus Schwab, World Economic Forum. *The Global Competitiveness Report 2012–2013*. Full data edition. Website:
53. http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2012-13.pdf. [Data e aksesit: 27 Mars, 2016].
54. Knack, S 2001, *Aid Dependence and the Quality of Governance: Cross-Country Empirical Tests*, Southern Economic Journal, Vol. 68, No. 2 (Oct., 2001), Faqet 310-329. Website: <<http://www.jstor.org/stable/1061596>>. [5 shkurt, 2016].
55. Komisioni i Bashkimit Evropian. Bruksel. *Think Small First: A Small Business Act for Europe*. 25.6.2008. Com(2008) 394 final. Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Website: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2008:0394>: [Data e aksesit: 25 shkurt, 2016].
56. Komisioni i Bashkimit Evropian, 2016. *Vleresimi I indeksit te politikave te ndermarrjeve te vogla e te mesme ne Ballkanin Perendimor dhe Turqi*. Drejtoria e Përgjithshme për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen dhe SME-të. Website: <<http://eurospeak.al/ekonomia/390-vleresimi-i-indeksit-te-politikave-te-ndermarrjeve-te-vogla-e-te-mesme-ne-ballkanin-perendimor-dhe-turqi>>. [5 korrik, 2016].
57. Kryeministria 2014, *Mbështetje të plotë për investuesit në bujqësi*, Aksesuar në: <<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/mbeshtetje-te-plote-per-investuesit-ne-bujqesi&page=50>>. [4 shkurt 2016].
58. Kurani, E 2015, *Albanian government offers guarantees for farmers' loans and pays the interest rates*, Independent Balkan News Agency, Aksesuar në: <<http://www.balkaneu.com/albanian-government-offers-guarantees-farmers-loans-pays-interest-rates/>>. [28 Janar 2016]
59. Kwang Suk Kim, 1994. Effective aid: How democracy allows development aid to improve the quality of life. *World Development* 347-348
60. Ligj nr. 160/2014 'Për Buxhetin e Vitit 2015', Datë 27.11.2014, Ministria e Financave, Aksesuar në: <<http://www.financa.gov.al/al/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015>>. [1 shkurt 2016]
61. Ligj nr. 147/2015 'Për Buxhetin e Vitit 2016', Ministria e Financave, Aksesuar në: <<http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2016>>. [1 shkurt 2016].
62. Melohina, V 2016, *EBRD boosts support to Albania's agribusiness sector*, EBRD News. Aksesuar në: <<http://www.ebrd.com/news/2016/ebrd-boosts-support-to-albanias-agribusiness-sector.html>>. [4 shkurt 2016].
63. Ministria e Financës. Njoftime. Zyra e shtypit. Website: http://www.minfin.gov.al/minfin/Zyra_e_Shtypit.php. [Data e aksesit: 25 shkurt, 2016].
64. Ministria e Financave 2014, *Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020*. Website: <http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Raportimet/Albanian_PFM_strategy_2014-2020.pdf>. [20 Janar, 2016].
65. Ministria e Integrimit Evropian. *The Minister of European Integration Ms Klajda Gjosha reports to the parliamentary Committee on European Integration about the 2015 draft budget*. November 11, 2014. Website: <http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-gjosha-per-here-te-pare-shqiperia-merr-40-milione-euro-mbeshtetje-buxhetore-nga-bashkimi-evropian&page=5> [25 shkurt, 2016].

66. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisw dhe Sipermarjes. *Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2013-2020*. Website: < <http://www.ekonomia.gov.al/>>. [12 shkurt 2016].
67. Mulley, S, 2011, Kufijtë e rinj të asistencës së donatorëve në transparencë dhe përgjegjshmëri, Londër: T/A I. Mars 2016.
68. Nika, A 2015, *Banka Botërore: Finalizimi i reformave, kusht për rritje ekonomike* – Interviste me Menaxheren e Bankës Botërore në Shqipëri, Tahseen Sayed, Agroweb.org. Aksesuar në: <<http://agroweb.org/?id=10&l=714&ln=sq&url=banka-boterore-finalizimi-i-reformave-kusht-per-ritje-ekonomike#sthash.GRIXF8ZX.pbf6SjgB.dpuf>>. [28 Janar 2016].
69. OECD, the European Commission, the European Training Foundation and the European Investment Bank. *SME Policy Index. Western Balkans and Turkey 2012*. Progress in the Implementation of the Small Business Act For Europe. Website: <http://www.oecd.org/daf/psd/SMEWBalkansTurkey.pdf>. [Data e aksesit: 15 Dhjetor, 2015].
70. OECD 2005, *Paris Declaration and Accra Agenda for Action*, Website: <<http://www.oecd.org/dac/effectiveness/parisdeclarationandaccraagendaforaction.htm>>. [3 shkurt, 2016].
71. OECD 2011, *Aid Effectiveness 2011. Progress in Implementing the Paris Declaration*. Website: <<http://www.oecd.org/dac/effectiveness/>>. [3 shkurt, 2016].
72. OECD DAC., 2009. DAC Glossary of Key Terms and Concepts. Website: <http://www.oecd.org/document/32/0,3343,en_2649_33721_42632800> [28 Korrik 2016]
73. OECD, EC & EBRD, 2016. Indeksi i Politikave të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme. Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016. Vlerësimi i Zbatimit të Aktit për Biznesin e Vogël në Evropë. Website: http://www.keepeek.com/Digital-Asset-Management/oecd/development/sme-policy-index-western-balkans-and-turkey-2016_9789264254473-en#.V_F6tqKu9zU [3 korrik 2016].
74. Ovaska, T and Cato J, 2003, The Failure of Development Aid, HeinOnline. Website: <<http://heinonline.org/HOL/LandingPage?handle=hein.journals/catoj23&div=24&id=&page=>>>. [15 janar, 2016].
75. Peleshi, N 2014, *Skema e re e qeverisë, financim deri në 50% fermerëve*, Fjala e mbajtur në Konferencën kombëtare: Nga bujqësi e mbijetesës, në bujqësi të zhvillimit, 22 Prill 2014, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Aksesuar në: <<http://www.bujqesia.gov.al/al/lajme/njoftime-per-shtyp/konference-kombetare-nga-bujqesi-e-mbijeteses-ne-bujqesi-te-zhvillimit&page=15>>. [4 shkurt 2016].
76. Project Preparation Facility in Albania Website: <http://ppf.integrimi.gov.al/>. [Access Date: May 10, 2016].
77. Qendra Kombëtare e Licensave. *Historiku*. Website: <http://www.qkl.gov.al/History.aspx>. [Data e aksesit: 24 shkurt, 2016].
78. Qendra Kombëtare e Rregjistrimit. QKR. *Informacion*. Website: http://www.qkr.gov.al/nrc/NRC_Information.aspx. [Data e aksesit: 25 Janar, 2016].
79. Re-examining the relationship between domestic investment and foreign aid: does political stability matter?, Nabamita Duttaa, Deepraj Mukherjee & Sanjukta Roy, International Review of Applied Economics, Volumi 29, Botimi 3, 2015, faqet 259-286
80. Roodman, D., 2007. The anarchy of numbers: Aid, development, and cross-country empirics. World Bank Economic Review, 21(2), Fq. 255–277.
81. Sachs, J., 2006. The end of poverty: Economic possibilities for our time. New York, NY: Penguin Books, Fq. 122-135.
82. Simone Juhasz Silva, 2012. *“Does aid Cause Trade? – Evidence From an Asymetric Gravity Model*

– Tulone u’’. Website:

<https://books.google.al/books?id=SqNqOnekjrYC&pg=PA2&Ipg=PA2&dq=Morrissey,Wagner,Lloyd+about+foreign+aid&ie=utf-8&oe=L> <http://www.qkl.gov.al/History.aspx>. [24 shkurt, 2016].

83. Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the One Part, and the Republic of Albania, of the Other Part. Council of the European Union. Brussels, 22 May 2006. Website:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf. [Data e aksesit: 20 Maj, 2016].

84. Stone, R. W., 2004. The political economy of IMF lending in Africa. *American Political Science Review*, 98(4), Fq. 577–591.

85. Tierney J. M., 2011. *More Dollars than Sense: Refining Our Knowledge of Development Finance Using AidData*. *World Development* Vol. 23, No. 4, fq. 4-8.

86. Udhëzimi Skemat Kombëtare 2015. ‘Për Procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural’, Fletorja Zyrtare për Vitin 2015, Aksesuar në: <<http://www.qbz.gov.al/botime/botimetf15.htm>>. [3 shkurt 2016].

87. UNCTAD, 1999. *World Investment Report. Foreign Direct Investment and the Challenge of Development* United Nations Conference on Trade and Development. United Nations. New York & Geneva. Website: < http://unctad.org/en/Docs/wir1999_en.pdf>. [21 qershor 2016].

88. United Nations Conference on Trade and Development (UNCTAD). *World Investment Report (WIR): Non-Equity Modes Of International Production And Development*. 2011. Website: <http://www.unctad-docs.org/files/UNCTAD-WIR2011-Full-en.pdf>. [Data e aksesit: 29 shkurt, 2016].

89. United Nations Development Program (UNDP) Albania. United Nations UNCTAD. *Report on Foreign Direct Investments in Albania*”, 2011 - May 2012. Website: http://www.mete.gov.al/doc/web_fdi_report_english.pdf. [Data e aksesit: 25 Nëntor, 2016].

90. USAID. Millennium Challenge Albania Threshold Agreement (MCATA). Website:

91. http://albania.usaid.gov/gj2/41/category/MCC_Albania_Threshold_Agreement.html. [Data e aksesit: 26, shkurt 2016].

92. VKM Nr. 775, datë 24.09.2010. ‘Për menaxhimin e financimeve të huaja në republikën e Shqipërisë’, Fletorja zyrtare 2010, Qendra për Publikimet Zyrtare. Website: <<http://www.qbz.gov.al/botime/botimetf15.htm>>. [8 shkurt, 2016].

93. VKM Nr.52, Datë 21.01.2015 ‘Për Përcaktimin e Kriteve Bazë të Sektorëve që do të Mbështeten dhe të Masës së Përfitimit nga Fondi I Programit Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për Vitin 2015’, Fletorja Zyrtare për Vitin 2015, Aksesuar në: <<http://www.qbz.gov.al/botime/botimetf15.htm>>. [3 shkurt 2016].

94. Xhajanka, E 2015, *Grantet e BE-së për bujqësinë shqiptare – Thirrja për aplikim brenda 6-mujorit të parë 2016*, Ekonomi, Biznes dhe Finance, Lajme Nga Vendi, Agjensia Telegrafike Shqiptare. Aksesuar në: <<http://www.ata.gov.al/grantet-e-be-se-per-bujqesine-shqiptare-thirrja-per-aplikim-brenda-6-mujorit-te-pare-2016-317750.html>>. [2 shkurt 2016].

Aneks: Pyetsori i përdorur për mbledhjen e të dhënave

PYETSOR

KY PYETSOR KA PER QELLIM TE ZBULOJE PROBLEMATIKAT DHE FAKTORET QE NDIKOJNE NE PERTHITHJEN E NDIHMES SE HUAJ NGA INSTITUCIONET PERFITUESE

Ploteso te dhenat:

Emri I projektit:

Donatori:

Vlera e financuar (specifiko nese eshte grant apo kredi):

Institucioni perfitues:

Miratuar në : (data e miratimit/nënshkrimit të projektit)

Hyrja në fuqi:

Data e planifikuar e përfundimit:

Te pergjithshme. Ploteso duke qarkuar:

1.1. Projekti konsiston ne: 1. Investim ne ngritje infrastrukture 2. Asistence teknike 3. Subvencion

1.2 Projekti I perket sektorit ekonomik: 1. Finance 2. Bujqesi 3. Arsim 4. Shendetsi 5. Sociale 6. Zhv. Ekonomik 7. Transport 8. Ujesjelles-Kanalizime 9. Mjedis

1.3 Kohezgjatja e planifikuar: 1. 2-3 vjet 2. 3-5 vjet 3. 5-7 vjet

1.4 Projekti po zbatohet/eshte zbatuar brenda kohezgjatjes se planifikuar 1. Po 2. Jo

1.5. Projekti menaxhohet nga 1. Donatori ne menyre te centralizuar 2. Institucioni perfitues ne menyre te decentralizuar

1.6. Ekziston nje plan per zbatimin e projektit I ndare ne aktivitete konkrete te parashikuara ne kohe?
1. Po 2. Jo

1.7 Perfshihet financimi I projektit ne PBA? 1. Po 2. Jo

1. Problematikat e hasura. Ploteso duke qarkuar:

2.1 Ka patur ristrukturim/zgjatje afati te projektit gjate zbatimit te tij? 1. Po 2. Jo

2.2, Burimet materiale dhe njerezore per menaxhimin e projektit kane qene: 1-Aspak te mjaftueshme 2-Pak te mjaftueshme 3-Normale 4-Mjaftueshem 5-Shume te mjaftueshme

2.3. Jane hasur probleme me shpronesime apo sigurimin e lejeve te ndertimit ne fillim apo gjate zbatimit te projektit? 1. Po 2. Jo

2.4. Ka patur mungese aktesh ligjore apo probleme legjislacioni qe kane penguar apo ngadalsuar zbatimin e projektit? 1. Po 2. Jo

2.5. Ka patur problematika/vonesa ne fazen e prokurimit? 1. Po 2. Jo

2.6. Keni hasur vonesa ne disbursimin e financimit nga donatori? 1. Po 2. Jo

2.7. Keni patur vonesa ne hapjen e llogarive

1. Po 2. Jo

2.8 Keni patur vonesa ne moskryerje ne kohe e pagesave ne bankat e nivelit te dyte?

1. Po 2. Jo

2.9. Eshte planifikuar dhe rimbursuar TVSH-ja ne kohe? 1. Po 2. Jo

2.10. Ka patur vonesa ne projektimin e projektit? 1. Po 2. Jo

2.11. Ka patur shkurtime buxheti 1. Po 2. Jo

2.12 Ka patur ndryshim te destinacionit te financimit gjate zbatimit te projektit?

1. Po 2. Jo

Impakti I projektit. Ploteso duke qarkuar.

3.1. Projekti ka patur/ pritet te kete impakt te ndjeshem dhe lehtesisht te matshem ne sektorin ku eshte zbatuar. 1. Po 2. Jo

3.2. Projekti ka ndikuar/pritet te ndikojne ne rritjen e te ardhurave te sektorit perkates. 1. Po 2. Jo

3.3 Projekti ka krijuar / pritet te krijojne vende te reja pune 1. Po 2. Jo

3.4. Projekti ka ndikuar ne rritjen e kapaciteteve njerezore. 1. Po 2. Jo

3.5 Projekti ka luajtur rol kyc ne rritjen e investimeve ne zonen ku eshte zbatuar? 1. Po 2. Jo

3.6. Sa banore kane perfituar apo pritet te perfitojne nga zbatimi I projektit? 1. 0-5000 2. 5000-50000 3. 50000 – 100000 4. Mbi 100000

Rekomandimet tuaja. Lutem shkruani rekomandime te cilat mund te permiresojne zbatimin ne kohe te projektit dhe thithjen e fondeve

.....
.....